



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

**RAPORTI VJETOR I DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË ELBASAN**

**MBI PUNËN E BËRË NË PROKURORI DHE
GJENDJEN E KRIMINALITETIT NË
QARKUN E ELBASANIT
PËR VITIN 2021**



Elbasan, shkurt 2022

PËRMBAJTJA

I. Drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit në vitin 2021.....	5
➤ Të dhëna për realizimin e objektivave prioritare të prokurorisë.....	5
➤ Rritja e rolit aktiv të prokurorit dhe hetimet proaktive.....	7
➤ Informacion mbi zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm..	8
➤ Informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dhe Planit të Veprimit në zbatim të saj.....	13
➤ Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave dhe ullaimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.....	14
➤ Respektimi i të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve në procesin penal.....	21
➤ Të miturit dhe grupet vulnerabël, të pandehur dhe viktime.....	22
➤ Bashkëpunimi ndërinstitucional.....	29
➤ Bashkëpunimi ndërkombëtar.....	35
➤ Të dhëna lidhur me trajnimet e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.....	36
II. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së prokurorisë.....	36
➤ Volumi i punës në hetim.....	36
➤ Çështje të përfaqësuara në gjykatë.....	46
➤ Treguesit kryesorë të punës së prokurorisë.....	48
➤ Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale.....	50
➤ Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror.....	51
➤ Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.....	56
➤ Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale.....	60
➤ Kriminaliteti sipas përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre.....	61
➤ Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal (krime-kundërvajtje).....	62
III. Treguesit statistikorë 2 vjeçarë të veprave penale sipas strukturës së Kodit Penal.....	63
➤ Në vitin 2021.....	66
➤ Në vitin 2020.....	67
IV. Analiza e treguesve të efektivitetit të punës së prokurorisë.....	68
➤ Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe dënimin e të pandehurve.....	68

➤ Të dhëna për gjykimet e posaçme.....	70
➤ Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve.....	72
➤ Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehuri.....	72
➤ Të dhëna për të pandehurit e mitur.....	74
➤ Të dhëna për pasojat e veprave penale.....	77
V. Të dhëna lidhur me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.....	78
➤ <i>Ekstradime, Letërporosi, Transferime procedimesh, Transferime te dënuarish, Shpalljet/Heqjet nga kërkimi ndërkombëtar.....</i>	<i>78</i>
VI. Të dhëna për ngarkesën e punës për çdo prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore.....	78
VII. Informacion mbi administrimin e Prokurorisë.....	80
➤ <i>Raporti financiar.....</i>	<i>80</i>
➤ <i>Organizimi dhe Funksionimi i Prokurorisë.....</i>	<i>86</i>
➤ <i>Informacion mbi Regjistrat.....</i>	<i>86</i>
➤ <i>Inspektime të kryera nga institucione në prokurori.....</i>	<i>90</i>
➤ <i>Kërkesa drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme.....</i>	<i>93</i>
➤ <i>Kërkesa të tjera.....</i>	<i>103</i>
➤ <i>Veprime të tjera të kryera në insitucion.....</i>	<i>105</i>
➤ <i>Organizim i brendshëm.....</i>	<i>107</i>
➤ <i>Procedura e emërimit të Zëvendës Drejtuesit.....</i>	<i>111</i>
VIII. Informacion për marrëdhëniet me publikun dhe mediat.....	112
IX. Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021. Rekomandime.....	113



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

Pak histori :

Që nga fillesat e sistemit demokratik në vendin tonë, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, e kanë drejtuar prokurorët Neshat Fana, Arben Vasili, Vangjel Tanku, Dashnor Sula, Niko Duro, Luan Kaloçi, Durim Bedini, Elvin Gokaj, Gentjan Osmani, Eugen Beçi, Besnik Cani, Ardian Nezha, Enkeleda Millonai dhe Kreshnik Ajazi.

Falenderim :

Në hartimin e këtij raporti punuan dhe dhanë kontributin e tyre Zv.Drejtuasi i Prokurorisë Gentian Habazaj, kancelare Alketa Kurmaku, prokurori Mustafa Turku, dhe punonjësit e administratës Lindita Shopi, Elida Kasa, Armida Halili, Dionis Durbaku, Fjoralba Salla, Xhoana Koci, Rozalina Terziu, Pamela Hoxha dhe Klajva Xheka. Falenderim dhe mirënjohje për punën e bërë prej tyre.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

RAPORTI VJETOR I DREJTUESIT TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN MBI ECURINË E PUNËS NË PROKURORI PER VITIN 2021

I. Drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit në vitin 2021

➤ Të dhëna për realizimin e objektivave prioritare të prokurorisë

Në zbatim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 97, datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, në Kodin Penal, në Kodin e Drejtësisë për të Mitur”, në “Kodin Penal ushtarak”, në “Kodin e Procedurës Penale”, Rezolutës së dt.14.06.2021 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2020”, si dhe Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.78 dt. 09.07.2021 “Për zbatimin e rezolutës së Kuvendit datë 14.06.2021 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2020”, të Rekomandimeve Prioritare “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr 326 datë 02.06.2021, Udhëzimit nr 4 datë 09.07.2021 “ Për rekomandimet prioritare të këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokurorië e juridiksionit të përgjithshëm” si dhe Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.79 dt. 09.07.2021 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021”, si dhe në mbështetje të kuadrit ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, duke pasur parasysh edhe praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2021, është fokusuar në punën e saj duke i dhënë prioritet në punën e saj këtyre drejtimeve kryesore:

- Rritja e efikasitetit në luftën kundër krimit të organizuar dhe forcimin e koordinimit me Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
- Rritja e efikasitetit në luftën kundër pastrimit të produkteve të veprës penale dhe krimit financiar;
- Rritja e efikasitetit në respektimin e të drejtave të njeriut dhe në luftën ndaj veprave penale të dhunës në familje, kundër fëmijëve dhe grave,krimeve me motive të urrejtjes,si dhe masat e marra për trajtimin dhe mbrojtjen e viktimave për këto vepra penale;
- Rritja e bashkëpunimit ndërinstytucional.
- Garantimi i pavarësisë dhe i përgjegjshmërisë së prokurorit;
- Lufta kundër korrupsionit;
- rritja e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion te shtimit te hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë,
- zhvillimi i aktivitete të përbashkëta trajnuese me institucione/agjenci ligjzbatuese të pë r veprat penale të të pastrimit te parave
- rritja e efijencës së në veprimtarinë administrative të prokurorisë dhe të veprimtarisë së prokurorëve dhe Policisë Gjyqësore në ushtrimin e funksioneve të tyre
- mirëfunksionimin e punës në prokurori dhe shpërndatjen e drejtë të çështjeve, mbi bazën e kriterëve transparente të percaktuara nga Prokurori i Përgjithshëm
- rritja e trajnimeve në lidhje me ndjekjen penale ndaj grupveprave të trafikimit dhe shfrytëzimit të qenieve njerëzore, si dhe për mbrojtjen e viktimave dhe në vecanti gratë dhe fëmijët.
- Përmirësimi, mbajtja dhe plotesimi me korrektesi i të dhënave statistikore lidhur me viktimat, të miturit dhe të dhënat socio-demografike.
- Identifikimi i problemeve dhe masat konkrete për përmirësimin e sistemii menaxhimit të çështjeve” (CAMS).

Krahas këtyre prioritetëve, gjatë vitit 2021 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është punuar, pa lënë mënjane, edhe në lidhje me ndjekjen penale dhe përfaqësimin në gjykim të çështjeve penale në lidhje me veprat penale kundër shëndetit dhe jetës, në fushën e krimit ekonomik, kundër autoritetit të shtetit të kryer nga shtetas, veprave penale që çenojnë lirinë e zgjedhjeve, mbrojtjen e regjimit juridik të tokës, vepra penale kundër mjedisit apo veprave të tjera penale të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin Penal ushtarak.

Gjithashtu gjatë vitit 2021 nga prokurorët e kësaj prokurorie i është kushtuar rëndësi dhe përdorimit më efektiv të instituteve procedurale si urdhri penal, marrëveshja e fajësisë, gjykimi i drejtpërdrejtë, duke qartësuar kuptimin dhe zbatimin në praktikë të kuadrit ligjor përkatës.

Gjithashtu është punuar për hartimin dhe nxjerrjen e rregullave standard për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë që sigurojnë efikasitet në organizimin, drejtimin dhe kontrollin e punës, si dhe rritjen e pavarësisë së prokurorëve dhe forcimin e kuptimit më të mirë të përgjegjësisë nga çdo prokuror.

Në kuadër të funksionit drejtues është rritur kontrolli prokurorit ndaj policisë gjyqësore, në seksionin dhe shërbimet e policisë gjyqësore.

Është përmirësuar organizimi, drejtimit dhe kontrollit të punës brenda organit, me qëllim për t’iu përgjigjur më mirë kërkesave për rritjen e cilësisë së punës.

Është pasur në vëmendje respektimi nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore i detyrimeve të ligjit procedural penal, urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm dhe atyre të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Po kështu në vëmendje ka qenë dhe rritja e profesionalizimit të prokurorëve në hetimin paraprak, në marrjen e vendimeve përfundimtare, në paraqitjen e kërkesave para gjyqtarit të seancës paraprake dhe në mbrojtjen e akuzës në gjykim si dhe ruajtjen e etikës dhe disiplinës në punë.

Administrimi i sistemit elektronik e-tracking PRESTO, për hedhjen e të dhenave të përditësuara për çështjet e regjistruara për vitin 2021 e në vijim dhe çështjet e mbartura me 1 janar 2021 e në vijim, për veprat penale të pastrimit të parave në zbatim të urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr.92 datë 30.07.2021 "Për përdorimin e regjistrit elektronik dhe përfitimin e statistikave për çështje të pastrimit të parave në Prokuroritë e Shkallës së Parë me juridiksion të përgjithshëm (e-tracking, PRESTO "dhe në përmbushje të planit të veprimit ICRG/FATF, në kuadrin e integritetit evropian të vendit kryhet nga vetë prokurorët e Seksionit të Posaçëm Kundër Pastrimit të Parave, Krimeve Financiare, Financimin e Terrorizmit dhe Hetimet Pasurore. Gjatë përdorimit të sistemit elektronik, prokurorët kanë vërejtur vonesa në përpunimin e të dhënave si dhe volume të konsiderueshëm detajesh të cilat ekspozojnë hetimin.

➤ Ritja e rolit aktiv të prokurorit dhe hetimet proaktive

Nga ana e prokurorëve të Prokurorisë Elbasan, në varësi të natyrës së veprës penale, janë zhvilluar hetime proaktive, disa prej të cilave kanë rezultuar të suksesshme. Kryesisht, janë zhvilluar hetime proaktive për hetimin e veprave penale kundër veprave të rënda ndaj jetës në fushën e korrupsionit, narkotikëve, duke përdorur kryesisht metodat hetimore të përgjimit telefonik dhe vëzhgimit ambjental. Nga të dhënat statistikore rezulton se për vitin 2021 janë regjistruar 24 procedime për të cilët janë zhvilluar hetime proaktive.

Lidhur ngushtë dhe me hetimet proaktive që janë zhvilluar, si mjete për kërkimin e provës janë përdorur dhe:

- Kontrollat, parashikuar nga nenet 202-207 të K.Pr.Penale.
- Përgjimet, ku përfshihen përgjimet telefonike dhe ambjentale, përgjimi i fshehtë fotografik, filmik ose me video i personave në vende publike dhe përdorimi i pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes, mjete këto të parashikuara dhe në Seksionin IV të K.Pr.Penale, neni 222 e vijues të këtij kodi.
- Veprime simuluese, të parashikuar nga neni 294/a i K.Pr.Penale.

KONTROLLET:

Gjatë vitit 2021 nga Prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan janë bërë në gjykatë 6 kërkesa për kontrolle vendesh, kërkesa këto të miratuara edhe nga gjykata.

PËRGJIMET:

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, mbahet regjistri i posaçëm ku regjistrohen të dhënat për përgjimet, sipas treguesve të regjistrit.

Nga të dhënat e deritanishme ,referuar edhe të dhënave të marra në gjykatë, rezultojnë se janë regjistruar 223 vendime lejim përgjimi, ku përfshihen si ato ambjentale,ashtu dhe ato telefonike, për zgjatje afatit të përgjimeve.

Megjithëse ka rezultuar që hetimet për procedimet penale në të cilat janë përdorur këto mjete të kërkimit të provës, kanë qenë duke u kryer edhe për më tepër se një vepër penale, rezulton se si përgjimet telefonike ashtu dhe ato ambjentale janë kryer më shumë për krime kundër jetës,paskësaj për veprat penale në fushën e narkotikëve,si dhe paskësaj në lidhje me veprat penale dhënien ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit.

VEPRIMET SIMULUESE:

Veprime simuluese rezultojnë të jenë përdorur në 5 raste në lidhje me procedime penale të regjistruara për veprat penale të parashikuar nga nenet 143/3, 109/b , 283 të K.Penal .

Veprimet simuluese, mbeten të pakta për qarkun e Elbasanit. Veprimet simuluese kërkojnë angazhim dhe nga struktura të tjera të policisë së shtetit, përveç atyre vendore, për shkak se në vende të vogla, policia gjyqësore e ka të pamundur realizimin e veprimeve simuluese për shkak të njohjes së tyre prej qytetarëve si dhe qytetarët jo në çdo rast tregohen bashkëpunues.

➤ *Informacion mbi zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm*

Me qëllim zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë Elbasan janë hartuar, përveç masave konkrete të marra për zbatimin e tyre, si mbledhja e prokurorëve dhe diskutimi tyre, udhëzimet dhe urdhrat e mëposhtëm:

- **Urdhër Nr.7, dt.21.01.2021 “Për organizimin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”** në mbështetje të udhëzimit nr.2, dt.29.12.2016 “Për organizimin dhe koordinimin e punës në prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe Udhëzimit të Përgjithshëm nr.10 dt.17.07.2020 “Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimin e terrorizmit dhe në hetimet pasurore në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” të Prokurorit të Përgjithshëm.
- **Urdhër Nr.8, datë 21.01.2021 “Për miratimin e “Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”** në mbështetje të Urdhërit nr.164 datë 18.12.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e rregulloreve standart të organizimit dhe funksionimit të të Prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apeleve të juridiksionit të përgjithshëm”.
- **Urdhër Nr.9, datë 05.02.2021 “Për caktimin e prokurorëve përgjegjës dhe kryerjen e trajnimit praktik profesional si pjesë e trajnimit fillestar në**

Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan të personave të përzgjedhur si oficerë të policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë” në mbështetje të shkresës nr.1506/152/ex20, dt.02.02.2021 të Prokurorit të Përgjithshëm.

- **Urdhër Nr.10, datë 09.02.2021 “ Për fillimin e procedurës së emërimit të Zëvendës Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”** në mbështetje të Rregullores për emërimin e Zëvendës Drejtuesit të Prokurorisë në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm miratuar me Urdhërin nr.101, dt.12.06.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm.
- **Urdhër Nr.11, datë 15.02.2021 “Për krijimin e “Regjistrin të njoftimeve të viktimave akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elementë të veprës penale” dhe “Regjistrin të çështjeve të tjera”** në mbështetje të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.15 datë 30.10.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për trajtimin e njoftimeve të viktimave akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë element të veprës penale”.
- **Urdhër Nr.12, datë 22.02.2021 " Për emërimin e zëvendës drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë”**, në mbështetje të Rregullores për emërimin e Zëvendës Drejtuesit të Prokurorisë në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm miratuar me Urdhërin nr.101, dt.12.06.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm.
- **Udhëzim Nr.13, datë.24.02.2021 “ Për çështje konkrete”.**
- **Urdhër Nr.14, datë 25.02.2021 “Për organizimin e brendshëm administrativ të punës në prokurori”.**
- **Urdhër Nr.15, datë 25.02.2021 “ Për krijimin e grupit të punës për miratimin e Programit të Transparencës dhe krijimin e Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”.**
- **Urdhër Nr.17, dt.02.03.2021 “Për miratimin e formularit për pjesëmarrjen e prokurorit në gjykimet e çështjeve për të cilat prokurori ka ngritur padi, thirret si person i tretë, ndiqen me kërkesë në gjykatë dhe rishikimit, si dhe mënyrën e administrimit e ruajtjes së dokumentacionit në lidhje me këto lloj gjykimesh”.**
- **Urdhër Nr.18, datë 02.03.2021 “Për mënyrën e lëvizjes, administrimit dhe arkivimit të dosjeve të procedimeve penale, njohjeve të vendimeve penale të huaja, ekstradimeve dhe gjykimeve të çështjeve për të cilat prokurori ka ngritur padi, thirret si person i tretë, ndiqen me kërkesë në gjykatë dhe rishikimit, apo raportimet e policisë së shtetit, lidhur me veprat penale të parashikuara nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale, qëndiqen me kërkesë në gjykate nga viktimat akuzuese apo për referime që dukshëm nuk përmbajnë elementë të ndonjë vepre penale”.**

- **Udhëzim i Përgjithshëm Nr.19, datë 03.03.2021** “Mbi ekzekutimin, zbatimin dhe mbikqyrjen e masave të sigurimit “arrest në shtëpi” si dhe mbi rregullat për njoftimin dhe shoqërimin e personave nën hetim/pandehur me masa sigurimi “arrest në shtëpi” me qëllim kryerjen e veprimeve hetimore”.
- **Urdhër Nr.23, dt.16.03.2021** “Mbi procedurat e dorëzimit të dokumentacionit dhe bazës materiale nga prokurori Bledar Mustafaraj”, **bazuar në Urdhërin nr.25, dt.11.02.2019** “Për dorëzimin e dokumentacionit dhe ambjenteve” të Prokurorit të Përgjithshëm.
- **Urdhër Nr. 25, datë 24.03.2021** “Për delegimin e firmës”.
- **Urdhër Nr. 26, datë 24.03.2021** “Mbi disiplinimin e hyrjeve dhe daljeve në Prokurorinë Elbasan”
- **Urdhër Nr. 28, datë 25.03.2021** “Për delegimin e kompetencave dhe firmës” .
- **Urdhër Nr.30, dt.30.03.2021** “Mbi procedurat e dorëzimit të dokumentacionit dhe bazës materiale nga prokurori Neritan Hoxha”.
- **Urdhër Nr. 32, datë 31.03.2021** “Për miratimin e programit të transparencës për vitin 2021 dhe akteve bashkëlidhur tij,në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë”.
- **Urdhër Nr.35, datë 14.04.2021** ”Mbi organizimin e shërbimit të gadishmërisë së përforcuar së prokurorëve, oficerëve të seksionit të policisë gjyqësore dhe punonjëve të administratës së Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për periudhën zgjedhore nga 21.04.2021 deri më dt.30.04.2021” bazuar në Udhëzimin e Përgjithshëm Nr.03 datë 21.06.2019 “Mbi masat administrative dhe proceduriale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe paszgjedhore”, të ndryshuar, të Prokurorit të Përgjithshëm.
- **Udhëzim i Përgjithshëm Nr.44, datë 27.05.2021** “Për hetimin, ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës mbi bazë gjinore, ndaj të miturve dhe dhunës në familje” në mbështetje të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.17 dt.13.12.2020 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave,dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtje” të Prokurorit të Përgjithshëm.
- **Tërheqje Vëmëndje Nr. 51, datë 16.06.2021.**
- **Urdhër Nr.54, dt.30.06.2021** “Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me Znj.Marie Peci me detyrë në pozicionin administrativ “Sekretare pranë prokurorëve” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Elbasan”
- **Urdhër Nr.55, dt.01.07.2021** “Për dhënie lejesh” në mbështetje të urdhrit Nr. 02, datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për organizimin dhe koordinimin e punës në Prokurori”.

- Urdhër Nr.56, dt.01.07.2021 “Mbi procedurat e punësimit të 1 (një) vendi vakant në pozicionin administrativ “Sekretar pranë prokurorit”.
- Urdhër Nr.59, datë 12.07.2021 “Për regjistrimin dhe qarkullimin e materialeve të para hetimore ose kallëzimeve penale në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”.
- Tërheqje Vëmëndje_Nr. 62, datë 14.07.2021.
- Tërheqje Vëmëndje_Nr. 63, datë 15.07.2021.
- Urdhër Nr. 65, datë 21.07.2021 “Për miratimin e planit të veprimit për masat administrative dhe procedural në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së pare për zbatimin e rezolutës së kuvendit datë 14.06.2021 “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2020” në mbështetje të Urdhërit nr.78 dt. 09.07.2021 “Për zbatimin e rezolutës së Kuvendit datë 14.06.2021 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2020” të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Urdhër Nr.66, datë 21.07.2021 “Për miratimin e planit të veprimit për masat administrative dhe procedural në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së pare për zbatimin e rezolutës së kuvendit datë 14.06.2021 “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2020” në mbështetje të Urdhërit nr.79 dt. 09.07.2021 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.326, datë 02.06.2021, “Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021” të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Udhëzim Nr.67, dt.22.07.2021 “Për çështje konkrete”.
- Urdhër Nr.68, datë 27.07.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e punës,delegimin e kompetencave,si dhe dhënien e lejeve të zakonshme në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan gjatë pushimeve vjetore nga data 01 Gusht 2021 deri më datë 03 Shtator 2021” në mbështetje të urdhrit Nr. 02, datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për organizimin dhe koordinimin e punës në Prokurori”.
- Udhëzim Nr.69, dt.27.07.2021 “Për çështje konkrete”.
- Udhëzim Nr.70, dt.29.07.2021 “Për çështje konkrete.
- Udhëzim Nr.71, dt.29.07.2021 “Për çështje konkrete”.
- Urdhër Nr.72, datë 30.07.2021 “Mbi Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur”.
- Urdhër Nr.73, dt.30.07.2021 “Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me Z.Illir Gërdani me detyrë në pozicionin administrative “Sekretar pranë prokurorëve” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Elbasan”.
- Tërheqje Vëmëndje Nr. 74, datë 01.09.2021.
- Urdhër Nr.75, dt.01.09.2021 “Mbi procedurat e punësimit të 1 (një) vendi vakant në pozicionin administrativ “Sekretar pranë prokurorit”.

- Urdhër Nr.79, datë 10.09.2021 “Për disa ndryshime në urdhërin nr.7, datë 21.01.2021 “Për organizimin e seksioneve në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë” (i ndryshuar) në mbështetje të Urdhërit nr.164 datë 18.12.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e rregulloreve standart të organizimit dhe funksionimit të të Prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apeleve të juridiksionit të përgjithshëm”.
- Thirrje për mbledhjen e prokurorëve Nr. 80, datë 10.09.2021.
- Tërheqje Vëmëndje Nr. 81, datë 13.09.2021
- Urdhër Nr.85, datë 14.09.2021 “Për hapjen e zyrës dhe marrje në dorëzim të dosjeve të Erida Kokonozi”
- Urdhër Nr.87, datë 15.09.2021 “Për ngritjen e komisionit të ekspertizës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”.
- Urdhër Nr. 92, datë 22.09.2021 “Për një ndryshim në urdhërin nr.25, datë 24.03.2021 të drejtuesit të prokurorisë “Për delegimin e firmës”.
- Urdhër Nr.93, dt.23.09.2021 “Mbi procedurat e dorëzimit të dokumentacionit dhe bazës materiale nga prokurori Alfred Shehu”.
- Urdhër Nr.95, datë 23.09.2021 “ Për fillimin e procedurës së emërimit të Zëvendës Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”.
- Urdhër Nr.99, dt.30.09.2021 “Mbi përsëritjen e procedurave të punësimit për 1 (një) vend vakant në pozicionin administrativ “Sekretar pranë prokurorit”.
- Urdhër Nr.101, datë 11.10.2021 “Për kontrollin e regjistrave dhe librave në prokurori” bazuar në urdhëra dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm “Për mbajtjen e regjistrave”.
- Vendim Nr.103, dt.11.10.2021 “Për lejimin e ushtrimit të veprimtarisë jashtë funksionit (mësimdhënie)” bazuar në urdhrin Nr.02, datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për organizimin dhe koordinimin e punës në Prokurori”.
- Urdhër Nr.104, datë 11.10.2021 " Për emërimin e zëvendës drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë”.
- Urdhër Nr. 108, datë 26.10.2021 “Për një ndryshim në urdhërin nr.25, datë 24.03.2021 të drejtuesit të prokurorisë “Për delegimin e firmës”(i ndryshuar).
- Urdhër Nr.109, datë 27.10.2021 “Për përdorimin e rrjetit elektrik në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”.

- Urdhër Nr.111, datë 28.10.2021 “Mbi caktimin e personit përgjegjës të prokurorisë në sekretariatën teknik të KVSP-në”.
- Urdhër Nr.112, datë 28.10.2021 “Për miratimin e planit të përdorimit dhe shpërndarjes së ambjenteve të brendshme” .
- Kërkesë për informacion dhe dorëzim aktesh Nr. 114, datë 04.11.2021.
- Urdhër Nr.115, datë 08.11.2021 “Për një ndryshim në Urdhërin Nr. 12, datë 04.02.2020 “Për shërbimet e marrëdhënieve me publikun dhe median në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”
- Urdhër Nr.116, datë 08.11.2021 ”Për një ndryshim në Urdhërin Nr. 25, datë 30.03.2020 “Mbi mënyrën e administrimit të regjistrit dhe të materialeve të klasifikuara “Sekret shtetëror” dhe në Urdhërin Nr.47, datë 23.09.2020 “Mbi shpërndarjen e bazës materiale”.
- Urdhër Nr. 120, datë 18.11.2021 “Për delegimin e kompetencave dhe firmës” .
- Urdhër Nr. 121, datë 25.11.2021 “Për shfuqizimin e urdhërit Nr.120, datë 18.11.2021 “Për delegimin e kompetencave dhe firmës”.
- Urdhër Nr.123, datë 25.11.2021 “Për caktimin e prokurorëve përgjegjës dhe kryerjen e trajnimit praktik profesional si pjesë e trajnimit fillestar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan të personave të përzgjedhur si oficerë të policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë” referuar shkresës nr.1284/162, dt.22.11.2021 të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Tërheqje vëmëndje Nr.125, datë 26.11.2021.
- Vendim Nr.127, dt.01.12.2021 “Për lejimin e ushtrimit të veprimtarisë jashtë funksionit (mësimdhënie)”.
- Tërheqje Vëmëndje Nr. 133, datë 20.12.2021.
- Thirrje për mbledhjen e prokurorëve Nr. 141, datë 28.12.2021
- Kërkesë për dorëzim fashikujsh për arkivim Nr. 144, datë 29.12.2021

➤ *Informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dhe Planit të Veprimit në zbatim të saj*

Në zbatim të Rezolutës së dt.14.06.2021 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2020”, si dhe Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.78 dt. 09.07.2021 “Për zbatimin e rezolutës së Kuvendit datë 14.06.2021 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2020”, nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan janë nxjerrë urdhëri nr.65 datë 21.07.2021 “Për miratimin e planit të veprimit për masat administrative dhe proceduriale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për zbatimin e rezolutës së Kuvendit datë 14.06.2021 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për viti 2020”.

Në kuadër të rezolutës së mësipërme, vlerësoj se një pjesë e konsiderueshme e kërkesave të parashtruara në rezolutën e Kuvendit janë përmbushur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan në përputhje me juridiksionin e saj dhe kompetencën lëndore e territoriale. Disa prej kërkesave të rezolutës janë faktikisht rubrika dhe gjetje më vete të këtij raporti siç është:

- kryerja e hetimeve proaktive nëpërmjet metodave speciale të hetimit me fokus veprat penale në fushën e korrupsionit,
- forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë dhe policisë gjyqësore,
- rritja e bashkëpunimit me organet vendore e qendrore,
- rritja dhe konsolidimi i bashkëpunimit me autoritetet e huaja gjyqësore, bashkëpunim ky që realizohet me ndihmën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Drejtësisë,
- ashpërsimi i politikës së dënimit në rastet e veprave penale të dhunës në familje, krimin ekonomik e financiar, personave përsëritës etj,
- ndjekja e një politike dënimi më të butë për kategoritë si gratë, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit etj;
- aplikimi i instituteve proceduralë si gjykimi me marrëveshje dhe urdhri penal etj.

Pavarësisht se konstatojmë që veprimtaria e Prokurorisë ka qenë në përputhje me kërkesat e mësipërme, vlerësojmë se ka vend ende për përmirësimin e treguesve të mësipërm, qëllim ky i cili arrihet jo vetëm me punën e Prokurorisë, por edhe me vullnetin e organeve të tjera shtetërore si Kuvendi, organet e pushtetit ekzekutiv, ministrinë dhe institucionet të varësi të tyre, institucionet e tjera të pavarura si KLSH, ILDKPKI etj.

➤ *Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm*

Në zbatim të Rekomandimeve Prioritare “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr 326 datë 02.06.2021, Udhëzimit nr 4 datë 09.07.2021 “Për rekomandimet prioritare të këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokurorië e juridiksionit të përgjithshëm ” si dhe Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.79 dt. 09.07.2021 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021” , është nxjerrë urdhëri nr 66 datë 21.07.2021 “Për miratimin e planit të veprimit për masat administrative dhe proceduriale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Elbasan për zbatimin e VKM nr 326 datë 02.06.2021 “Për miratim e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021”.

Në kuadër të rekomandimeve të Këshillit të Ministrave vlerësoj se jemi përpjekur për përmbushjen e prioriteteve të parashikuara në rekomandimet e Këshillit të Ministrave. Në këto të fundit, ndër prioritetet janë lufta ndaj korrupsionit dhe krimin të organizuar, respektimi i të drejtave të njeriut dhe bashkëpunimi ndër-institucional.

Garantimi i pavarësisë dhe i përgjegjshmërisë së prokurorit;

Gjatë vitit 2021 në këtë prokurori ka rezultuar se prokurorët në punën e tyre kanë qenë të pavarur dhe pavarësisht largimit të disa prokurorëve tek prokurorët e tjerë kjo gjë ka ndikuar negativisht në rritjen e ngarkesës së punës, por jo papërgjegjshmëri në kryerjen e detyrave të tyre funksionale, pasi pavarësia e prokurorit në ushtrimin e funksioneve procedurale në kryerjen e hetimeve, përfaqësimin e akuzës dhe/ose çështjes në gjyq dhe urdhërimin ose mbikqyerjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale, duhet të lidhet ngushtë me detyrueshmërinë e ndjekjes penale dhe zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e prokurorisë.

Theksojmë se gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021 në këtë prokurori, sipas të dhënave statistikore, rezulton janë hetuar 3385 çështje penale (të mbartuara nga viti 2020, të regjistruara të reja apo të ardhura me transferim), si dhe njëkohësisht është marrë pjesë në gjykimin e 822 çështjeve penale themeli me të pandehur, si dhe në shumë çështje të tjera penale administrative-penale, apo me të dëmtuar akuzues.

Pavarësisht ngarkesës tepër të madhe në punë nga prokurorët e kësaj prokurorie në kuadër të bashkëpunimit me policinë e shtetit janë ndjekur hetimet proaktive.

Prokurorët janë zëvendësuar vetëm në respektim të kriterëve dhe kushteve që përcakton ligji procedural penal.

Nga prokurorët duhet të kuptohet qartë se pavarësia e prokurorit është pavarësia dhe autonomia e tij për marrjen e vendimeve në kryerjen e hetimeve, ndjekjen penale, përfaqësimin në gjyq të çështjeve dhe/ose akuzave penale dhe urdhërimin ose mbikqyerjen e ekzekutimit të vendimeve penale, pavarësisht ndikimit të paligjshëm të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, të brendshëm apo të jashtëm nga cdo autoritet publik, privat ose palë e interesuar në procesin e ndjekjes penale.

Prokurorët duhet të kuptojnë qartë se ndjekja penale është një detyrim kushtetues dhe ligjor i tyre.

Gjatë vitit 2021 nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë nxjerrë **144 akte administrative të brendshme**, nga të cilat **5 udhëzime jodetyruese për çështje konkrete** dhe **2 udhëzime të përgjithshme**. Asnjë prej këtyre akteve nuk rezulton të jetë ankimuar pranë KLP.

Lufta kundër korrupsionit:

Në punën e prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, pas ndryshimeve të bëra në K.Penal me ligjin nr.43/2021 dhe K.Pr.Penale me ligjin nr.41/2021, ku një pjesë e veprave penale në lidhje me korrupsionin dhe ushtrimin e ndikimit të paligjshëm ka kaluar në kompetencë të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, ka rezultuar se për veprat në fushën e korrupsionit gjatë vitit 2021 janë regjistruar: 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 244/1 i K.Penal “Korrupsioni aktiv personave që ushtrojnë funksione publike”, me 1 të pandehur me masë arrest në burg i cili është dërguar në gjykim dhe një procedim penal i cili është ende në fazën e hetimit;

Lufta kundër krimit të organizuar

Prioritetet në luftë kundër krimit të organizuar në punën e prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, gjatë vitit 2021 kanë qenë:

-Përmirësimi i cilësisë së hetimeve nëpërmjet rritjes të numrit të procedimeve penale/të pandehurve të dërguar në gjykatë dhe numrit të pandehurve të dënuar me vendim të formës së prerë, veçanërisht për veprat penale të trafiqeve të kundraligjshme, ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit, prodhimi dhe shitja e narkotikëve, trafikimi i narkotikëve dhe kultivimi i bimëve narkotike.

-Rritja e numrit të hetimeve proaktive në lidhje me veprat penale të sipër përmendura;

-Forcimi i bashkëpunimit me organet dhe agjencitë ligjzbatuese kombëtare dhe ndërkombëtare në rastet e pastrimit të produkteve që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale;

Vlen për të përmendur hetimi **për veprat penale të rënda të vrasjes** i dy procedimeve penale **Nr.1150 viti 2020 me 5 persona nën hetim** dhe procedimi penal **Nr.1121 viti 2012 me 5 persona nën hetim**, të cilët janë kualifikuar si grupe të strukturuar kriminale dhe kanë kaluar për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Pra në thelb nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan janë goditur përgjatë vitit 2021 dy struktura të organizuara kriminale të përfshirë në ngjarje të rënda kriminale dhe për shumë vite të proceduar.

Lufta kundër trafikimit të shtetasve:

Gjatë vitit 2021 është mbartur vetëm 1 çështje penale për veprën penale të “Trafikimi i të miturve” parashikuar nga neni 128/b/ i Kodit penal, e cila aktualisht është në hetim.

Lufta kundër trafikimit të mjeteve motorrike:

Gjatë vitit 2021 për veprën penale “Trafikim i mjeteve motorrike” të parashikuar nga neni 141/a i K.Penal rezulton se regjistruar gjithsej 5 procedime penale dhe mbartur 4 procedime penale me një person nën hetim dhe 1 të pandehur, hetuar gjithsej 10 procedime penale me 1 person nën hetim, 1 të pandehur dhe të arrestuar.

Në lidhje me këtë veprë penale rezulton se është kërkuar pushimi i çështjes për 1 çështje penale, 2 procedime penale janë pezulluar dhe një procedim penal është dërguar për kompetencë në një prokurori tjetër.

Lufta kundër kultivimit të bimëve narkotike, prodhimit, shitjes, transportimit, mbajtjes apo trafikimit të lëndëve narkotike:

Gjatë vitit 2021, hetimi dhe përfundimi i çështjeve penale në lidhje me veprat penale kundër narkotikëve që përfshijnë prodhimin dhe shitjen e narkotikëve, trafikimin e narkotikëve dhe kultivimin e narkotikëve ka qenë një nga prioritetet ku është fokusuar lufta kundër krimit të organizuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Në lidhje me veprën penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve” parashikuar nga neni 283 i K.Penal rezulton se është vendosur mosfillimi për 1 material hetimor;

Janë hetuar 135 çështje penale me 69 persona nën hetim/ 36 të pandehur, prej të cilëve 49 të arrestuar, prej të cilave 73 çështje me 56 persona nën hetim/11 të pandehur prej të cilëve 34 të arrestuar janë regjistruar gjatë këtij viti dhe mbaertur nga viti i kaluar.

Është kërkuar pushimi për 17 çështje penale 28 persona nën hetim;

Janë pezulluar hetimet për 27 çështje penale;

Tranferuar 1 çështje penale me një person nën hetim dhe të arrestuar

Janë dërguar për gjykim 25 çështje penale me 36 të pandehur dhe 21 të arrestuar;

Kanë mbetur në hetim 65 çështje penale me 40 persona nën hetim prej të cilëve 26 të arrestuar;

Janë gjykuar (çështje të mbartura në gjykim nga 2020 dhe ato të dërguara në gjyq gjatë vitit 2021) gjithsej 21 çështje penale me 36 të pandehur prej të cilëve 31 të arrestuar.

Në lidhje me çështjet e gjykuara rezulton se nga prokurorët është kërkuar dënimi me burgim për 34 të pandehur, si dhe zbatimi i nenit 59 të K.Penal për 2 të pandehur, si dhe nga gjykata janë dhënë 31 dënime me burgim, zbatimi i nenit 59 të K.Penal për 5 të pandehur,

Në lidhje me veprën penale “Trafikim i narkotikëve” parashikuar nga neni 283/a i K.Penal rezulton se janë mbartur 6 çështje penale nga të cilat vazhdojnë 5 procedime penale të jenë në fazën e hetimit dhe një i pezulluar.

Në lidhje me veprën penale “Kultivim i bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284 i K.Penal rezulton se:

Janë hetuar 62 çështje penale me 21 persona nën hetim/16 të pandehur, prej të cilëve 14 të arrestuar, (të mbartura dhe të regjistruara për viti 2021).

Është kërkuar pushimi për 3 procedime penale;

Është pezulluar hetimet për 11 çështje penale;

Janë dërguar për gjykim 5 çështje penale me 16 të pandehur prej të cilëve 12 të arrestuar;

Kanë mbetur në hetim 43 çështje penale me 21 persona nën hetim prej të cilëve 2 të arrestuar;

Janë gjykuar (çështje të mbartura në gjykim nga 2020 dhe ato të dërguara në gjyq gjatë viti 2021) gjithsej 5 çështje penale me 14 të pandehur prej të cilëve 11 të arrestuar.

Në lidhje me çështjet e gjykuara rezulton se nga prokurorët është kërkuar dënimi me burgim për 12 të pandehur, si dhe zbatimi i nenit 59 të K.Penal për 2 të pandehur, si dhe nga gjykata janë dhënë 5 dënime me burgim, zbatimi i nenit 59 të K.Penal për 9 të pandehur.

Lufta kundër dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit:

Gjatë vitit 2021, në lidhje me veprën penale të “Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit” të parashikuar nga neni 298 i K.Penal rezulton se:

Janë hetuar 31 çështje penale me 17 persona nën hetim, 29 të pandehur prej të cilëve 24 të arrestuar, Është kërkuar pushimi për 3 person nën hetim;

Janë pezulluar hetimet për 2 çështje penale;

Transferuar 2 procedime penale me 3 personan nën hetim dhe 3 të arrestuar;

Dërguar për gjykim 14 procedime penale 29 të pandehur dhe 21 të arrestuar;

Kanë mbetur në hetim 13 çështje penale me 10 persona nën hetim;

Janë gjykuar 11 çështje penale me 14 të pandehur për të cilin nga prokurorët është kërkuar dënimi me burgim për 9 të pandehur dhe për 5 aplikim i nenit 59 si dhe nga gjykata është dënimi me burgim për 8 te pandehur dhe 6 aplikim i nenit 59.

Lufta kundër pastrimit të produkteve të veprës penale :

Gjatë vitit 2021, në lidhje me veprën penale të “Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 i K.Penal rezulton se:

Janë hetuar 53 çështje penale të mbartura nga viti 2020, si dhe të filluara gjatë vitit 2021

Është kërkuar pushimi për 11 çështje penale;

Pezulluar 8 procedime penale;

Rifilluar 4 procedime penale;

Kanë mbetur në hetim 38 çështje penale me 2 persona nën hetim;

Në lidhje me fazën e gjykimit rezulton se është gjykuar 1 çështje penale.

Hetimet pasurore, sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale sipas ligjit nr. 10192/2009 i ndryshuar “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”;

Gjatë kësaj peridhure kohore rezulton se në këtë prokurori janë regjistruar vetëm 30 hetime pasurore.

Deri në këto momente nuk ka patur raste sekuestrimesh apo konfiskimesh në lidhje me hetimet pasurore të filluara.

Në kuadër të zbatimit të memorandumit të bashkëpunimit dhe Udhëzimit të Përgjithshëm nr.10/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për masat administrative dhe proceduriale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe

në hetimet pasurore ...”, rezulton se në këtë prokurori ka vazhduar të funksionojë seksioni kundër pastrimit të parave, krimeve financiare,

Me urdhërin nr.124 datë 26.11.2021 është caktuar drejtues i këtij seksioni prokuror Artur Ismailukaj pasi drejtuesja e seksionit është dorëhequr nga funksioni.

Janë organizuar dy trajnime nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Organizatat Ndërkombtare në kuadër të veprave të përmendura më lart.

Është e nevojshme organizimi i trajnimeve të tjera duke marrë pjesë dhe institucione të tjera.

Në zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.17/2020 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje...”, nga prokurorët e kësaj prokurorie në vazhdimësi është treguar një kujdes i vecantë në trajtimin e rasteve **të dhunës së ushtruar ndaj grave apo cfarëdolloj diskriminimi ndaj tyre**, ku në shumicën e rasteve nga prokurorët është kërkuar në gjykatë caktimi i masës së sigurimit arrest në burg për autorët e veprave penale.

Gjatë vitit 2021:

- në lidhje me krimet seksuale të parashikuara nga nenet 100-108/a të K.Penal, ku viktimat kanë mbetur femrat rezulton se në total janë regjistruar 23 procedime penale të reja, me 6 persona nën hetim 5 të pandehur, prej të cilëve 5 të arrestuar (të mbartura dhe të regjistruara për vitin 2021).
- në lidhje me veprat penale të dhunës në familje të parashikuara nga neni 130/a të K.Penal, ku viktimat kanë mbetur femrat rezulton se në total janë regjistruar 167 procedime penale me 11 persona nën hetim 89 të pandehur, prej të cilëve 33 të arrestuar;
- në lidhje me veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit të parashikuara nga nenet 113-123 të K.Penal, ku viktimat kanë mbetur femrat rezulton se në total janë regjistruar 52 procedime penale të reja, me 6 persona nën hetim 5 të pandehur, prej të cilëve 2 të arrestuar (të mbartura dhe të regjistruara për vitin 2021).

Përsa i përket të miturve rezulton se gjatë vitit 2021:

- numri i përgjithshëm i çështjeve me të mitur në konflikt me ligjin është 71 çështje me 66 autorë të mitur, prej të cilëve 62 meshkuj dhe 4 femra;
- Numri i çështjeve me të mitur viktimat është 66 çështje me 72 të mitur viktimat;

Problem në lidhje me hetimin e çështjeve me të mitur në konflikt me ligjin apo me viktimat të mitur mbetet mungesa e instancave të tjera përveç njësisë së mbrojtjes së fëmijëve në Bashkinë Elbasan, ku mund të bëhet referimi i rasteve të tyre për t'i pasur nën mbikqyrje.

Për çështjet me të mitur vazhdon të jetë seksioni i të miturve i përbërë prej 4 prokurorëve,

Lidhur me rritjen e efektivitetit në luftën ndaj trafikimit dhe shfrytëzimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave në vecanti grave dhe fëmijëve, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka lidhur marrëveshje me shoqata dhe OJF që operojnë në qytetin e Elbasanit me anë të të cilave i ofrojmë mbështetje dhe ndihmë sipas specifikave të cdo rasti.

Marrëveshja e bashkëpunimit është lidhur më datë 13.10.2020 dhe në kuadër të marrëveshjes lidhur ndërmjet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe qendrës Tjetër Vizion dhe Shoqatës Forumi i Gruas Elbasan, deri më tani janë referuar 29 raste për mbështetje.

Nga 29 raste të referuara, në 15 prej tyre është kërkuar ndihmë për gratë viktime të dhunës në familje bashkë me fëmijët e tyre, 2 raste për të mitura për të cilat është kërkuar strehim si dhe 12 raste janë referuar me objekt “rehabilitim dhunuesi”.

Gjithashtu janë referuar dhe u është ofruar ndihmë dy vajzave të mitura të cilat janë strehuar në shelter.

Gjatë takimeve të ndryshme është diskutuar rreth sfidave që kemi hasur duke u përpjekur më pas ti përmirësojmë ato në të ardhmen.

Ne ndjekim në mënyre sistematike trajnimet lidhur me këto target-grupe dhe gjithashtu jemi pjesë e takimeve me çdo institucion qeveritar dhe jo-qeveritar të cilët kanë fokus trajtimin e rasteve të përmendura për lart.

Bashkëpunimi me Prokurorinë e Posaçme ka qenë dhe vazhdon të jetë i vazhdueshëm. Për vitin 2021 është dërguar për kompetencë nga ana jonë një procedim penal në Prokurorinë e Posaçme.

Përsa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar rezulton se gjatë kësaj periudhë kohore janë dërguar gjithsej 28 letërporosi nga të cilat 18 për veprën penale parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Kanë ardhur nga jashtë gjithsej 43 leterporosi.

Nuk kemi raste të vendosjes së sekuestros apo konfiskime.

Në projekt buxhetin afat mesem të viti 2022-2024 kemi kërkuar shtetasë fuqie punëtore (punonjës mirembajtje, sekretare pranë prokurorit dhe arkiviste).

Është i domosdoshëm trajnimi i punonjësve të administratës lidhur me proceset e punës si psh arshiva, protokollit, prokurimi publik, zyra e regjistrimit etj.

Në kuadër të udhëzimeve të përgjithshme, unifikimit të veprimtarisë administrative e funksionale dhe performancës së prokurorisë, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan janë nxjerrë një tërësi urdhërash dhe udhëzimesh si më poshtë vijon:

Urdhër Nr.115, datë 08.11.2021 për një ndryshim në Urdhërin Nr. 12, datë 04.02.2020 “Për shërbimet e marrëdhënieve me publikun dhe median në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”.

Urdhër Nr.124, datë 26.11.2021 për disa ndryshime në urdhërin nr.7, datë 21.01.2021 “për organizimin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” (i ndryshuar).

➤ Respektimi i të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve në procesin penal

Në lidhje me këtë çështje objektivat e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan kanë qenë:

-Rritje e numrit të rasteve të zbatimit të urdhrit penal, marrëveshjes dhe gjykimit të drejtpërdrejtë, me synim përmirësimin e efikasitetit të hetimit dhe uljes së normës së kohëzgjatjes mesatare të hetimit të çështjeve;

-Rritje të kërkesave për dhënien e dënimeve alternative për autorë dhe vepra penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore;

-Rritje të numrit të masave alternative që synojnë shmangien e të miturit autor të veprës penale nga procedimi penal;

-Kërkesa për masën e sigurimit “arrest në burg” për të miturit, të jetë rast përjashtimor, dhe në rastet kur ajo vendoset, duhet që hetimet të përfundojnë në kohën më shkurtër të mundshme;

-Hetime të shpejta dhe respektim të të drejtave dhe garancive procedurale për rastet me të mitur dëshmitar dhe viktima të veprës penale;

-Ashpërsim të masave të sigurimit dhe masës së dënimit për veprat me natyrë gjinore dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit të fëmijëve;

-Hetime të shpejta, efektive, dhe ashpërsim të dënimit për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve;

-Përmirësimi i aftësive profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve me fokus specializimin dhe krijimin e profesionistëve që administrojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur.

Politika që ka ndjekur kjo prokurori për vitin 2021, ka pasur në fokus kryesor, viktimat vulnerabël, ato që pësojnë çënime në të drejtat dhe liritë e tyre, për shkak të gjinisë së tyre si dhe të miturit.

Si autoritet përgjegjës për garantimin e të drejtave të të pandehurve dhe të viktimës gjatë fazës së hetimeve paraprake, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë treguar kujdes në njohjen e tyre, me të drejtat që ata gëzojnë, mbështetur në dispozitat procedurale penale dhe angazhimin pozitiv, për të mundësuar realizimin e këtyre të drejtave.

Viktimat dhe të pandehurit janë njohur me të drejtat e tyre, të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, si dhe në përfundim të hetimeve gjithashtu u është vënë në dispozicion kopje e akteve vendimmarrëse duke i bërë të ditur të drejtën e ankimit. Në rastet kur viktima ka ndërruar jetë, janë bërë përpjekje për të gjetur dhe njoftuar trashëgimtarët e tyre.

Në rastet që qytetarët apo subjektet e tjera, kanë parashtruar kërkesa për zëvendësimin e prokurorit, apo edhe kur vetë prokurorët kanë parashtruar kërkesa për zëvendësimin e tyre, nga ushtrimi i ndjekjes penale në çështje të caktuara, nga Drejtuesi i kësaj prokurorie, është proceduar me marrjen e vendimeve përkatëse, në respektim të dispozitave procedurale penale, neni 16 e në vijim i Kodit të Procedurës Penale.

Përgjithësisht nga ana e viktimave apo edhe të pandehurve, të drejtat që janë ushtruar kanë pasur të bëjnë me kërkesat që i kanë drejtuar organit procedues për të marrë informacion në lidhje me procedimet penale ku janë të përfshirë si palë, për të kërkuar kryerje veprimesh hetimore shtesë e të tjera. Nga ana e prokurorëve është ndjekur praktika e dhënies përgjigje në mënyrë të vazhdueshme, kërkesave të parashtruara, duke u marrë edhe vendimet përkatëse mbi kërkesat e palëve.

Në respektim edhe të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, qytetarëve apo subjekteve të ndryshme, iu është dhënë përgjigje në mënyrë të vazhdueshme, kërkesave të tyre. Në dhënien e informacioneve, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është mbajtur parasysh ruajtja e sekretit hetimor apo atij shtetëror. Për realizimin e këtyre momenteve, ka qenë e rëndësishme koordinimi i punës mes zyrës së marrëdhënieve me publikun, me prokurorin e çështjes.

Gjatë këtij procesi nga ana e kësaj prokurorie, janë respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut, duke ruajtur të dhënat personale, duke pasur parasysh të drejtën për jetë private.

Sipas librit të korrespondencës për të drejtën e informimit, rezultojnë të jenë trajtuar për vitin 2021 gjithsej 14 kërkesa, të kryera në mbështetje të këtij ligji, në krahasim me 12 kërkesa të trajtuara gjatë vitit 2020.

Përsa i përket pretendimeve të ndryshme nga qytetarët në letra të shkruara prej tyre, përgjithësisht është ndjekur si procedurë, thirrja e qytetarëve në rastet kur prej tyre ka pasur pretendime për ekzistencën e ndonjë veprë penale, dhe marrja e kallzimit penal nga oficeri i policisë gjyqësore sipas grafikut të gatishmërisë, në ditët e ardhjes së letrës apo në rast ngarkese të këtij të fundit, kallzimi penal është marrë nga një oficer tjetër i policisë gjyqësore i kësaj prokurorie. Thirrja e qytetarëve për të parashtruar pretendimet e veta në formën e kallzimit kur kanë pasur pretendime për vepra penale, është bërë mbështetur në respektimin e dispozitave procedurale penale, neni 283 e në vijim i Kodit të Procedurës Penale.

➤ *Të miturit dhe grupet vulnerabël, të pandehur dhe viktima*

Politika që ka ndjekur Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për vitin 2021, ka pasur në fokus kryesor, viktimat vulnerabël, ato që pësojnë çënime në të drejtat dhe liritë e tyre për shkak të gjinisë së tyre si dhe të miturit.

Në lidhje me veprat penale me objekt dhunën me bazë gjinore, gjatë vitit 2021 ka vazhduar funksionimi i Seksionit për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale me të

pandehur dhe viktima të mitura, si dhe për ekzekutimin e vendimeve penale dhe marrëdhëniet juridiksionale me jashtë.

Prokurorët e caktuar në këto seksione, përgjatë vitit 2021 kanë marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës apo institucione të tjera me objekt dhunën në bazë gjinore, si dhe njohuritë e përfutuara në këtë drejtim, janë munduar t'i zbatojnë në punën e tyre të përditshme dhe rritjen e bashkëpunimit të mëtejshëm me organizmat e ndryshëm shtetërorë, lokale, qendrore apo shoqatat jo fitim prurëse.

Në mbështetje të VKM nr. 334 datë 17.02.2011 *``Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij`*, në këtë Prokurori kanë vazhduar të zbatohen Marrëveshjet me objekt koordinimi dhe bashkëpunimi për referimin e rasteve të dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore ,të miturit në konflikt me ligjin dhe të miturit viktima.

Objekti i këtyre marrëveshjeve është koordinimi i punës dhe bashkëpunimi midis institucioneve, për të adresuar rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, përmes një mekanizmi referimi.

Në zbatim të Urdhërit nr. 53 prot datë 05.07.2018 *``Për caktimin e personit të kontaktit për komunikimet me organizmat e ndryshme në lidhje me rastet e dhunës me bazë gjinore si dhe të specialistit që do të jetë pjesë e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor``*, mbështetur në VKM nr. 334 datë 17.02.2011 *``Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij`*, në kuadër edhe të marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura si më sipër, vazhdon punën personi i caktuar si person kontakti, të cilit i drejtohen të gjitha komunikimet qofshin me gojë apo të shkruara, si elektronike ashtu edhe të shtypura, si dhe përgjegjës për dhënien rrugë përgjigjeve të nevojshme, si pikë kontakti në Ekipin Teknik Ndërdisciplinor.

Gjatë vitit 2021 ka vazhduar të ushtrijë kompetencat e saj edhe Koordinatorja për subjektet me status të posaçëm, roli i së cilës ka në fokus të miturit në konflikt me ligjin, viktimat e mitur, subjektet e dhunës me bazë gjinore,si dhe personat me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike. Në kuadër të funksionimit të marrëveshjes dhe të ushtrimit të detyrave të Koordinatorit për Subjektet me Status të Posaçëm gjatë vitit 2021 dhe në kuadër të marrëveshjes lidhur ndërmjet Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe qendrës Tjetër Vizion dhe Shoqatës Forumi i Gruas Elbasan, gjatë vitit 2021 janë referuar 26 raste për mbështetje. Ka pasur referime të shumta nga ne si organ procedues, ku një fokus të madh përveç viktimave të dhunës i është dhënë dhënë dhe burrave dhunues duke qenë se është një target grupi i cili ka nevojë për shumë ndërhyrje. Nga 26 raste të referuara, në 12 prej tyre është kërkuar ndihmë për gratë viktima të dhunës në familje bashkë me fëmijët e tyre, 2 rast për të mitura si dhe 16 raste janë referuar me objekt "rehabilitim dhunuesi". Dy të miturat janë strehuar në shelter,

nga të cilat njëra prej tyre është rikthyer në shtëpi ndërsa e mitura tjetër është në proces për heqje kujdestarie të prindit. Gjatë takimeve të ndryshme është diskutuar rreth sfidave që kemi hasur duke u përpjekur më pas ti përmirësojmë ato.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi kemi pasur kontakte lidhur me rastet për mbështetje psikologjike, sociale dhe edukative, seanca këshillimi, strehime në shelter, ndjekja e kurseve profesionale, ndihmë ligjore falas, bonuse qeraje, mundësi punësimi, etj. Komunikimi me qendrat me të cilat është nënshkruar marrëveshja është i vazhdueshëm jo vetëm për raste të cilat ne kemi referuar për mbështetje por dhe për çdo shkëmbim informacioni i cili ka qenë i nevojshëm për mbarëvajtjen e punës në lidhje me rastet e dhunës në familje apo të miturve viktime.

Kontakte të vazhdueshme kemi pasur me Koordinatorin Vendore të Dhunës në Familje dhe Nënpunësen Gjimore në Drejtorinë e Shërbimit Social në Bashkinë Elbasan apo dhe Drejtorinë e Shërbimit të kujdesit Social dhe Komunitar për raste më specifike që kanë pasur nevojë për mbështetjen. Kemi bërë referime dhe në drejtoritë e 6 shkollave që ndjekin të miturit të cilët kanë qenë viktime të veprave të ndryshme penale, në mënyrë që të marrin mbështetje psikologjike nga psikologjia e shkollës. Kontakte të vazhdueshme janë më Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve, më së shumti me specialitetin e NjMF Cerrik dhe Prrenjas për tre të mitura të cilat janë prekur nga vepra si penale 130/a dhe 100/2 e Kodit Penal.

Prokuroria Elbasan është pjesë e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) në Bashkinë Elbasan ku është bërë ngritja e sekretariatit teknik për trekëndëshin Polici – Prokurori – Bashki, të cilët janë ndër aktorët kryesorë, për rritjen e transparencës, por edhe nxitjen e urave lidhëse të komunikimit midis të gjithë aktorëve, për të kontribuar në përpjekjet e "të gjithë shoqërisë" për të identifikuar, kuptuar dhe lehtësuar parandalimin e sjelljeve kriminale në komunitetet e tyre, si edhe në procesin e riintegrit të të dënuarve, pasi ata kanë kryer dënimin, apo në raste të tjera kur ata kthehen nga zonat e konfliktit. Pjesë e këtyre takimeve është vetë Drejtuesi ose personi tjetër përgjegjës i caktuar prej tij. Prokuroria merr pjesë në mënyrë të vazhdueshme në takimet e ekipit teknik ndërdisiplinar me anëtarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, ku diskutohen raste specifike dhe ndihma që mund tu ofrohet, dhe është treguar gjithmonë e hapur për bashkëpunim.

Dhe në vetë si Prokurori kemi organizuar takime ndër të cilat një tryezë të rrumbullakët në kuadër të një vjetorit të lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit midis Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan – Shoqatës Forumi i Gruas Elbasan dhe Qendrës "Tjetër Vizion". Fokusi i këtij takimi ishte diskutimi i rasteve të cilat janë referuar nga Prokuroria për të marrë shërbim, sukseset që janë arritur gjatë këtij viti, sfidat që janë hasur dhe se si mund të përmirësojmë bashkëpunimin në të ardhmen.

Gjithashtu aktiviteti "Ditës së Hapur" në institucionin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Elbasan në bashkëpunim me Organizatën "Në familje për familjen. Qëllimi i këtij

aktiviteti ishte njohja e të rinjve me punën dhe rolin e institucionit të Prokurorisë në lidhje me sigurinë publike.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan Gjithashtu në ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore ka realizuar një video ndërgjegjësuese që femrat të denoncojnë dhunën dhe ku pasqyrohet ndihma që u ofrohet atyre. Gjithashtu kemi qenë pjesë e një takimi ndërgjegjësuës në një gjimnaz ku u është dhënë informacion rreth sjelljeve që nxisin kryerjen e veprat penale.

Në funksion të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 37/2017 “*Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur*”. Për qarkun e Elbasanit, janë caktuar dy psikologe vlerësuese dhe asistuese dhe dy psikologe asistuese. Duke pasur parasysh numrin e çështjeve, ku përveç pranisë së detyrueshme në rastet me të dëmtuar apo autorë të mitur, vlerësohet prania e psikologut edhe në çështjet e dhunës me bazë gjinore, si dhe shtrirjes territoriale që ka qarku i Elbasanit, do të ishte me vend rritja e numrit të psikologëve. Puna që kryen kjo prokurori, në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive të tyre, ka si fokus kryesor shmangien e riviktimizimit apo viktimizimit të përsëritur dhe bashkërendimin me gjithë aktorët e tjerë, me qëllim sigurimin e mundësive viktimave për të venë në vend të drejtat e tyre dhe për t’u rehabilituar.

Të dhënat për të pandehurit e mitur trajtohen në pikën përkatëse të këtij raporti.

Viktimat e mitur nga veprat penale:

Përsa i përket grupit të të miturve viktimat të veprave penale rezultojnë se gjatë vitit 2021 janë trajtuar 64 procedime penale me 70 të viktimat të mitur, prej të cilëve 34 femra dhe 36 meshkuj. Në lidhje me pasojat në shëndet rezultojnë se janë plagosur lehtë 18 viktimat të mitur.

Në lidhje me viktimat të plagosur lehtë 11 të mitur kanë qenë viktimat të veprës penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, e parashikuar nga neni 290 i K.Penal.

Në lidhje me viktimat të plagosur rëndë 3 të mitur kanë qenë viktimat të veprës penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, e parashikuar nga neni 290 i K.Penal.

Viktimat femra nga vepra penale:

Përsa i përket grupit viktimave të veprave penale të gjinisë femërore rezultojnë se gjatë vitit 2021 janë trajtuar mjaft procedime penale ku numri total i viktimave femra ka qenë 171, prej të cilave 18 të mitura, ku pjesa më e madhe e tyre kanë qenë viktimat të veprave penale “Dhunë në familje” të parashikuar nga neni 130/a i K.Penal, gjithsej 64 femra.

Të dhëna për viktimat femra nga veprat penale gjatë vitit 2021

Veprat penale sipas K.Penal	Numri i viktimave femra
N.79	2
N.89	13
N. 99	5
N. 100-108/a	8
N.130/a	64
Vepra të tjera penale	79
Totali	171

Veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës, të parashikuara në seksionin XI Kreu II i K.Penal (nenet 124-130/a të K.Penal) gjatë vitit 2021:

Përsa i përket burimeve të referimit të materialeve hetimore apo kallëzimeve , se pjesa kryesore e materialeve hetimore është referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Komisariateve të Policisë në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.


Është për tu theksuar fakti se në pjesën më të madhe të referimeve të ardhura nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore vepra më e përhapur ka qenë ajo e “Dhunës në familje” e parashikuar nga neni 130/a i K.Penal dhe konkretisht 106 referime.

Në krahasim me vitin 2020 ku ka pasur 144 referime, gjatë vitit 2021 për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i K.Penal janë referuar 38 materiale hetimore më pak.


Gjatë vitit 2021, në lidhje me veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës, nga prokurorët e kësaj prokurorie janë hetuar në total 178 procedime penale me 143 persona nën hetim/të pandehur, prej të cilëve 33 të arrestuar, procedime nga të cilat:

- 67 procedime penale me 41 persona nën hetim/të pandehur, prej të cilëve 4 të arrestuar ishin procedime të mbartura në hetim nga viti 2020;
- 111 procedime penale me 61 persona nën hetim/të pandehur, prej të cilëve 29 të arrestuar ishin procedime penale të regjistruara të reja për vitin 2021;
- 24 kanë qenë mosfillime

Mosfillime dhe çështje të regjistruara të vitit 2021



Çështje të regjistruara gjatë vitit 2021 për nenin 130/a të K.Penal krahasuar me veprat e tjera penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës



Nga prokurorët, gjatë vitit 2021 janë kërkuar masa sigurimi vetëm për persona të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Dhuna në familje” të parashikuar nga neni 130/a i K.Penal dhe konkretisht është kërkuar masa e sigurimit “arrest në burg” për 48 persona.

Në lidhje me personat e hetuar për veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës gjatë vitit 2021 rezulton se nga 138 persona/të pandehur të hetuar:

- të gjithë personat kanë qenë mbi 18 vjeç;
 - 14 kanë qenë femra dhe 124 kanë qenë meshkuj;
- pjesa më madhe të papunë apo të punësuar në subjekte private.

Gjatë vitit 2021 në lidhje me veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës nga prokurorët e kësaj prokurorie:

është kërkuar pushimi i çështjes/akuzës penale për 34 procedime penal me 9 persona nën hetim/pandehur, prej të cilëve asnjë i arrestuar.


janë pezulluar hetimet për 4 procedime penale, për shkak të letërporosive.

- është shpallur moskompetenca për 1 procedim penal .

është kërkuar dërgimi i çështjes për gjykim për 76 procedime penale me 91 të pandehur, 27 me masë sigurimi “Arrest në burg”.

janë mbartur për tu hetuar për vitin 2022 gjithsej 67 procedime penale me 2 persona nën hetim/pandehur, dhe 5 me masë sigurimi “Arrest në burg”

Çështje të përfunduara gjatë vitit 2021 dhe të mbetura në hetim për veprat penale kundër fëmijëve, familjes e martesës



■ Pushuar ■ Moskompetencë ■ Dërgim në Gjyq ■ Nën hetim

Në lidhje me mënyrën e përfundimit të procedimeve penale për veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës, rezulton se gjykimi i drejtpërdrejtë, zbatimi i urdhërit penal dhe

marrëveshjet e pranimit të fajësisë vijojnë të mbeten një nga llojet e gjykimeve më pak të kërkuara nga organi i prokurorisë.

➤ Bashkëpunimi ndërinstitucional

Gjatë vitit 2021 janë mbajtur raporte korrekte me institucione të tjera, në zbatim të ligjit procedural, ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e organeve përkatëse dhe atij organik për Prokurorinë Shqiptare. Në këto marrëdhënie rolin kryesor e zënë ato që lidhen me:

- ❖ Prokurorinë e Përgjithshme dhe me Këshillin e Lartë të Prokurorisë
- ❖ Strukturat e policisë së shtetit dhe institucionet e tjera që kanë shërbime të policisë gjyqësore, për bashkëpunimin që lidhet me fazën e hetimit paraprak të procedimeve,
- ❖ Me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për fazën që lidhet me përfaqësimin e akuzës në gjykim, me paraqitjet në seancat paraprake si në rastet e kërkesave për pushim, ashtu edhe në ato për gjykim.
- ❖ Me Prokurorinë dhe Gjykatën e Apelit Durrës, për fazën që lidhet me përfaqësimin e akuzës në çështjet e ankimuara, me njoftimin e vendimeve apo akteve të cilat kanë ekzekutim të menjëhershëm.
- ❖ Me institucione të tjera në nivel qendror dhe lokal.

Gjatë gjithë vitit 2021, ka patur një marrëdhënie shumë të ngushtë bashkëpunimi me të gjitha drejtoritë dhe sektoret e Prokurorisë së Përgjithshme dhe me Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Gjatë vitit 2021, përveç respektimit me rigorozitet të detyrimeve ligjore dhe në funksion të rritjes së cilësisë së hetimit paraprak, është synuar edhe krijimi i një raporti të ngushtë bashkëpunimi me të gjitha strukturat e policisë së shtetit që veprojnë në qarkun e Elbasanit, si Drejtoria e Policisë së Qarkut dhe Komisarariatet e Policisë Elbasan, Gramsh, Peqin, Librazhd, si dhe strukturat e policisë rrugore. Rritjes së bashkëpunimit i ka shërbyer edhe institucionalizimi i takimeve të përbashkëta periodike ndërmjet drejtuesit të kësaj Prokurorie dhe drejtuesve të efektivave policore që disponojnë shërbimet e policisë gjyqësore.

Lidhur me raportet e Prokurorisë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, vlerësoj se kanë qenë korrekte dhe ligjore, si në kërkesat që lidhen me fazën e hetimit paraprak, ashtu dhe atë të seancave paraprake, të gjyqimit të procedimeve dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq. Prokurorëve u është kërkuar respektimi me korrektesë i pjesëmarrjes së tyre në gjykim, çka realisht është përmbushur në mënyrë konkrete.

Gjatë vitit 2021 ka vijuar komunikimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me Prokurorinë e Apelit Durrës, në funksion të përfaqësimit sa më cilësor të akuzës në çështjet e ankimuara dhe me njoftimin e vendimeve apo akteve të cilat kanë ekzekutim të menjëhershëm, apo ato akte të cilat kanë karakter ngutshëm.

Nga ana e Prokurorisë Elbasan është treguar gatishmëri e plotë për të bashkëpunuar edhe me institucione të tjera si Prefekti i Qarkut Elbasan, Bashkitë e qarkut të Elbasan (Elbasan, Gramsh, Belsh, Cërrik, Peqin, Prrenjas, Librazhd), në aktivitete që i shërbejnë parandalimit të përhapjes së veprave penale, sikurse janë ato në fushën e ndërtimeve pa leje, kultivimit të lëndëve narkotike,

dhunës në familje, etj. Përgjithësisht, raportet me institucionet e tjera qendrore e vendore kanë qenë korrekte dhe institucionale.

Gjatë vitit 2021 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore, janë regjistruar kryesisht, janë regjistruar mbi bazën e kallëzimeve penale të institucioneve të tjera publike, si dhe janë regjistruar mbi bazën e kallëzimeve penale të shtetasve apo subjekteve fizikë apo juridikë gjithsej 2859 materiale hetimore, ndërkohë që në vitin 2020 ishin regjistruar 3005 materiale hetimore.

Sa më sipër rezulton se në vitin 2021 janë regjistruar 146 materiale hetimore më pak se në vitin 2020.

Nga statistikat e prokurorisë për vitin 2021 konstatohet se:

- Gjatë vitit 2021 janë referuara nga shërbimet e policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan dhe shërbimet e policisë gjyqësore të Komisariateve të Policisë që mbulojnë Qarkun e Elbasanit, **2236** materiale hetimore të regjistruara.

Ndërkohë në vitin 2020 ishin referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan dhe shërbimet e policisë gjyqësore të Komisariateve të Policisë që mbulojnë Qarkun e Elbasanit gjithsej **2603** materiale hetimore të regjistruara.

Siç shihet gjatë vitit 2021 janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan dhe shërbimet e policisë gjyqësore të Komisariateve të Policisë që mbulojnë Qarkun e Elbasanit **367** materiale hetimore më pak se viti 2020.

- Gjatë vitit 2021 janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesave në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, drejtori të tjera policie apo në Ministrinë e Brendshme, **5** materiale hetimore të regjistruara.

Ndërkohë nga kjo strukturë e shërbimeve të policisë gjyqësore ishin referuar 4 materiale hetimore të regjistruara.

Siç shihet gjatë vitit 2021 janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesave në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, drejtori të tjera policie apo në Ministrinë e Brendshme **1** material hetimor më shumë se viti 2020.

Gjatë vitit 2021 janë referuar nga shërbimi i policisë gjyqësore në Drejtorinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve **32** materiale hetimore të regjistruara.

-Gjatë vitit 2020 janë referuar nga shërbimi i policisë gjyqësore në Drejtorinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve **31** materiale hetimore të regjistruara.

Siç shihet gjatë vitit 2021 janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore në Drejtorinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, **1** material hetimor më shumë se viti 2020.

- Gjatë vitit 2021 janë referuar nga shërbimi i policisë gjyqësore në Policinë Ushtarake **2** materiale hetimore të regjistruara, ndërkohë që në vitin 2020 nga kjo polici është referuar 1 material hetimor.

- Gjatë vitit 2021 janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të hetimit tatimor (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve) **2** material hetimor të regjistruara.

Ndërkohë në vitin 2020 ishin referuar nga ky shërbim i policisë gjyqësore **4** materiale hetimore të regjistruara;

Siç shihet gjatë vitit 2021 janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të hetimit tatimor (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve), **2** materiale hetimore më pak se viti 2020.

- Gjatë vitit 2021 nuk është referuar asnjë material hetimor nga shërbimet e policisë gjyqësore të hetimit doganor(Drejtoria e Përgjithshme e Doganave),ndërkohë që në vitin 2020 nga ky shërbim i policisë gjyqësore ishin referuar vetëm **2** materiale hetimore të regjistruara;

Gjatë vitit 2021 janë referuar nga oficerët e Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për ngjarje dhe kallëzime penale të marra nga shtetasit,gjithsej **84** materiale hetimore të regjistruara.

Ndërkohë nga kjo strukturë e policisë gjyqësore gjatë vitit 2020 ishin referuar gjithsej **101** materiale hetimore të regjistruara.

Siç shihet gjatë vitit 2020 janë referuar nga oficerët e Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, **17** materiale hetimore më pak se viti 2020.

- Gjatë vitit 2021 janë regjistruar në prokurori **30** kallëzime penale të depozituara nga vetë shtetasit. Ndërkohë mbi bazën e kallëzimit të shtetasve të depozituar në prokurori për vitin 2020 ishin regjistruar **29** kallëzime penale të regjistruara.

Siç shihet gjatë vitit 2021 janë regjistruar në prokurori **1** kallëzim penal më shumë në krahasim me vitin 2020.

- Gjatë vitit 2021 janë regjistruar kryesisht nga prokurorët e kësaj prokurorie **2** materiale hetimore të regjistruara.

Ndërkohë gjatë vitit 2020 ishin regjistruar kryesisht **2** materiale hetimore të regjistruara.

Siç shihet gjatë vitit 2021 janë regjistruar kryesisht i njëjti numër në krahasim me vitin 2020.

- Gjatë vitit 2021 rezulton se si të ardhura për kompetencë nga Prokuroritë e tjera apo Prokuroria e Përgjithshme janë regjistruar **9** procedime penale të regjistruara.

Ndërkohë gjatë vitin 2020 si të tilla ishin regjistruar **5** procedime penale .

Siç shihet gjatë vitit 2021 mbi materiale e çështje të ardhura me moskompetencë janë regjistruar më shumë **4** materiale hetimore me vitin 2020.

- Gjatë vitit 2021 nuk janë regjistruar kallëzime të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Gjykatës së Apelit Durrës , gjithashtu dhe ne vitin 2019 nuk kishin regjistrime të tilla.

- Gjatë vitit 2021 mbi bazën e kallëzimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ose institucioneve në vartësi të saj, në këtë prokurori janë regjistruar **2** materiale hetimore të regjistruara, ndërkohë që në vitin 2020 nga ky institucion janë bërë 6 kallëzime penale.

- Gjatë vitit 2021 rezulton se nuk është regjistruar asnjë material hetimor i ardhur me kallëzim penal nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, dhe në vitin 2020 nuk është regjistruar asnjë material hetimor.

- Gjatë vitit 2021 janë regjistruar 7 kallëzime të Bashkisë Elbasan (vetë bashkisë ose inspektoriateve të saj). Ndërkohë nga ky institucion gjatë vitit 2020 ishin bërë) gjithsej **12** kallëzime penale.

Siç shihet gjatë vitit 2021 mbi bazën e kallëzimit të Bashkisë Elbasan janë regjistruar më pak **5** materiale hetimore në krahasim me vitin 2020.

- Gjatë vitit 2021 janë regjistruar kallëzime të Bashkisë Cërrik (vetë bashkisë ose inspektoriateve të saj) gjithsej **1** kallëzim penal, ndërkohë që në vitin 2020 ishte bërë gjithsej **3** kallëzime penale.

- Gjatë vitit 2021 mbi bazën e kallëzimit të Inspektoriatit Shtetëror të Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit Dega Elbasan dhe Agjensia Rajonale e shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan, në këtë prokurori nuk janë regjistruar asnjë material hetimor, ndërkohë që dhe në vitin 2020 nga institucione të tilla ishte bërë vetëm **2** kallëzime penale.

Përveç referimeve nga policia e shtetit, numri i referime të tjera vijon të jetë i ulët.

Në punën e Prokurorëve të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan gjatë vitit 2021 bashkëpunimi me oficerët e policisë gjyqësore dhe përfshirja e tyre në hetim, është bërë me qëllimin e rritjes së efektivitetit të burimeve njerëzore, realizimit të hetimeve të plota dhe të gjithanshme, si dhe finalizim me sukses të çështjeve të regjistruara, duke shmangur referimet fiktive dhe hetime të dështuara me pasojë moshetimin dhe vënien para përgjegjësisë penale të elementëve të rrezikshëm kriminalë.

Bashkëpunimi me policinë e shtetit, është një bashkëpunim, që ka një rol kryesor dhe domethënës në luftën ndaj kriminalitetit.

Përgjithësisht është pikërisht policia e shtetit, që gjendet e para në vendngjarje, që referon materialet në prokurori dhe gjithashtu nën drejtimin dhe udhëzimet e prokurorit, kryen hetime.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, bashkëpunimi me Drejtorinë e Policisë Vendore Elbasan si dhe me Komisaritatet përkatëse të shtrira në gjithë territorin ku kjo prokurori ushtron kompetencën territoriale, ka qenë i ngushtë, për t'u vlerësuar dhe përgjithësisht frytdhënës.

Janë kryer analiza të përbashkëta, me përfaqësues të policisë së shtetit, jo vetëm të qarkut por edhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për çështje të natyrës së veçantë (pra referuar procedimeve penale konkrete) apo edhe të natyrës së përgjithshme (ritjen e bashkëpunimit, në drejtim të zbardhjes së ngjarjeve, shkëmbimit të informacionit sa më shpejt dhe në mënyrë sa më frutdhënëse, mundësitë që u ofrohen oficerëve të policisë së shtetit për trajnim) etj.

Në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, është analizuar mundësia dhe ka nisur puna për studimin e dosjeve të pezulluara ndër vite, me qëllim rifillimin e tyre, pa u plotësuar afatet e parashkrimit, për të shfrytëzuar të gjitha planet hetimore, që mund të bëhen të realizueshme sot për shkak të mundësive të shfrytëzimit të mjeteve të reja të kërkimit të provës.

Gjithashtu një bashkëpunim i ngushtë gjatë vitit 2020 ka qenë edhe me shërbimet e policisë gjyqësore të Shërbimit për Cështjet e Brendshme dhe Ankesat si në Ministrinë e Brendshme, ashtu dhe në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, gjë që ka sjellë si pasojë hetimin dhe vënien para përgjegjësisë penale të disa rasteve të veprimeve të kundraligjshme të punonjësve të policisë së shtetit në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, ku përfshihen dhe punonjës policie të Komisariateve të Policisë në varësi të kësaj Drejtorie.

Sipas të dhënave të sipër cituar vlen të theksohet dhe bashkëpunimi me Drejtorinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, për evidentimin e rasteve të futjes së sendeve të palejueshme nëpër burgje, si dhe veprimeve të kundraligjshme të kryera nga funksionarë apo punonjës të Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale me Burgim dhe policisë së burgjeve.

Në lidhje me materialet hetimore të referuara nga këto shërbime të policisë gjyqësore, vlen të theksohet se duhet të punohet më shumë me oficerët e policisë gjyqësore për ngritjen e tyre profesionale, pasi realisht lë për të dëshiruar përgatija e materialeve të para hetimore, si dhe më pas hetimi me cilësi i procedimeve penale të regjistruara.

Siç është pasqyruar më lart, rastet e hetimeve të filluara kryesisht nga prokurorët, mbeten të ulëta. Ky fakt lidhet shpesh me punën e policisë gjyqësore, e cila referon menjëherë materialin sapo merr dijëni për kryerjen e veprës penale. Në rastet kur prokurorët kanë konstatuar vetë fakte penale nuk kanë hezituar të fillojnë çështje kryesisht, çështje të cilat janë rregjistruar kryesisht pasi është marrë informacion nga media apo kanë rezultuar fakte të reja në lidhje me vepra të tjera penale, gjatë hetimeve të çështjeve në ndjekje.

Në lidhje më një pjesë të çështjeve penale të hetuara për vitin 2021, ato u janë deleguar për veprime hetimore dhe janë hetuar nga oficerë të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe konkretisht 859 procedime penale të hetuara (të reja dhe të mbartura nga viti 2020) në këtë prokurori.

Ndërsa 2526 procedime penale është hetuar nga oficerë të shërbimeve të policive të tjera gjyqësore, ku pjesën më të madhe e zënë shërbimet e policisë gjyqësore në vartësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.

Institucione të tjera ligjzbatuese me të cilat kjo prokurori ka pasur bashkëpunim të ngushtë, është Shërbimi Informativ i Shtetit, ku për shkak të specifikës së punës së këtij shërbimi, në cdo rast informacionet e ardhura nga ky shërbim, u kanë kaluar menjëherë shërbimeve të policisë gjyqësore, për tu bërë më pas e mundur referimi i materialeve hetimore dhe kryerja e hetimeve sa

më të shpejta dhe cilësore për sqarimin e informacioneve dhe përcaktimin e ekzistencës së veprave penale dhe vënien para përgjegjësish penale të personave përgjegjës.

Në këtë analizë vlen të përmendim, se sa i përket bashkëpunimit me agjensitë e ndryshme ligjzbatuese, nga këto agjensi duhet të bëhen përpjekje maksimale që të rriten referimet për kryerje veprash penale.

Nga puna e bërë rezulton se në shumë raste agjensitë e hetimit tatimor apo doganor janë mjaftuar vetëm me njoftimin pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan apo Komisaritetet përkatëse të Policisë në varësi të kësaj Drejtorie, për konstatimin e rasteve të veprave penale në fushën e tatimeve apo doganave, duke mos plotësuar vetë tërë dokumentacionin përkatës dhe më pas bërjen e kallëzimeve penale në bazë të legjislacionit përkatës që rregullon fushën e veprimtarisë së tyre sic janë ligjet mbi procedurat tatimore, ligjet mbi akcizat, apo Kodi Doganor. Në këtë mënyrë ngarkohet me veprime hetimore policia e shtetit, ndërkohë që në këto raste ajo duhet të ishte vetëm mbështetëse e veprimtarisë së këtyre agjensive ligjzbatuese.

Gjithashtu në funksion të hetimeve të shpejta dhe forcimit të masave ndëshkuese nga prokuroria për veprat penale në fushën e mjedisit, me qëllim shmangien e katastrofave mjedisore dhe parandalimin e dëmtimit të mjedisit, gjatë vitit 2021 duhet të rritet bashkëpunimi me drejtues të Inspektorateve të ndryshme shtetërore, për të bërë të mundur zbardhjen e fakteve penale në fushën e mjedisit dhe parandalimin e dëmtimeve në mjedis.

Në këtë prokurori, sic u përmend edhe në pjesët e më sipërme të kësaj analize, është treguar impenjimi maksimal për bashkëpunimin me aktorë të ndryshëm përsa i përket luftës ndaj dhunës me bazë gjinore, apo sigurimin e të drejtave më të përforcuara ndaj të miturve.

Përfaqësues të kësaj prokurorie kanë marrë pjesë vazhdimisht në mbledhjet e grupeve të punës me aktorë të tjerë institucionalë ose jo institucionalë të krijuara në kuadër të planeve kombëtare në luftën kundër dhunës me bazë gjinore, apo në luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike.

Në punën e tyre, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, shfrytëzojnë në maksimum bashkëpunimin me agjensitë e tjera ligjzbatuese, me institucionet e ndryshme shtetërore, siç janë për t'u theksuar Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Inspektoriatet përkatëse të Mjedisit, të Ndërtimit, Ministrinë përkatëse etj.

Një bashkëpunim i ngushtë ka qenë dhe me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, institucione këto ku janë transmetuar nga ana jonë shqetësimet në punën tonë në zbatim të ligjit, si dhe njohja me/dhe zbatimi i Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, zbatimin e vendimeve të KLP-së, si dhe raportimi në kohë dhe sa më i saktë i të dhënave statistikore apo informacioneve të kërkuara.

Bashkëpunim i ngushtë është mbajtur edhe me Prokurorinë e Apelit Durrës ku nga prokurorët e Prokurorisë së Apelit janë dërguar sa më shpejt që është e mundur njoftimet në lidhje me

përfundimin e gjykimeve në apel dhe sidomos në lidhje me kërkesat e prokurorëve në fazën e hetimeve paraprake.

Gjithashtu nga secili prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, si verbalisht, ashtu dhe në mënyrë shkresore ,ju është dhënë në kohë informacioni prokurorëve të apelit në lidhje me problematikat e hasura gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Durrës të ankimeve të bëra nga prokurorët e shkallës së parë.

Nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është treguar një kujdes i vecantë në lidhje me kthimin e përgjigjeve , dërgimin e informacioneve dhe dokumentacioneve të kërkuara nga organet e krijuara në kuadër të Reformës në Drejtësi për zbatimin e procesit të vlerësimit kalimtar që janë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Komisioni i Pavarur i Apelit.

Sipas parashikimit të legjislacionit përkatës procedural penal, si dhe ligjeve përkatë për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të prokurorisë dhe gjykatës një bashkëpunim i vecantë është mbajtur dhe me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, përse i përket gjykimit në kohë të kërkesave të prokurorëve gjatë fazës së hetimit paraprak, konstatimit të problematikave të ndryshme në lidhje me pjesmarrjen e prokurorëve në seanca gjyqësore dhe respektimin e solemnitetit në këto seanca gjyqësore.

Një bashkëpunim i ngushtë gjatë vitit 2021 ka qenë dhe me Shkollën e Magjistraturës, ku nga prokurorët në vazhdimësi është ndjekur procesi i trajnimit vazhdues për rritjen profesionale dhe specializimin e prokurorëve për njohje dhe zbatim të legjislacionit penal dhe praktikat më të mira gjyqësore kombëtare apo ndërkombëtare.

Në rastin kur agjensi të tjera dërgojnë ftesa që lidhen me çështje të vecanta, janë propozuar fillimisht të shkojnë prokurorët apo oficerët e policisë gjyqësore të caktuar pikërisht në seksionet përkatëse dhe në rast pamundësie objektive të tyre, kanë shkuar prokurorët apo oficerët e tjerë të policisë gjyqësore.

➤ *Bashkëpunimi ndërkombëtar*

Me qëllim bashkëpunimin e efektshëm në ushtrimin e ndjekjes penale apo marrjen e masave dhe kryerjen e veprimeve të ndryshme procedurale, lidhur me veprat penale që kanë kryer shtetasit shqiptarë jashtë shtetit, apo shtetasit e huaj në qarkun e Elbasanit, nga ana e Prokurorisë Elbasan janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, si dy organet kompetente që mundësojnë ndërmjetësimin e bashkëpunimit me autoritetet e huaja.

Bashkëpunimi ndërkombëtar, shkëmbimi i informacionit dhe i përvojës, organizimi i operacioneve të përbashkëta dhe mbështetja logjistike dhe financiare nga partnerët ndërkombëtarë është po aq i rëndësishëm në suksesin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Përsa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar, konstatohet se ekziston një bashkëpunim i frytshëm, specifikisht nga pala shqiptare në drejtim të kërkesave për ndihmë juridike të sjella nga shtetet e huaja.

Gjatë vitit 2021 në kuadër të ekzekutimit të një letërporosie, në muajin prill, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan erdhi një grup hetimor i autoriteteve belge të drejtësisë penale i përbërë nga gjyqtar hetues, prokuror dhe dy hetues. Ky grup hetimor, së bashku me autoritetet tona të hetimit në prokurori dhe polici kreu veprime hetimore të lejuara me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan veprimet u koordinuan nga Drejtuesi i Prokurorisë.

Të dhënat statistikore pasqyrohen në pikën përkatëse të këtij raporti.

➤ *Të dhëna lidhur me trajnimet e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore*

Për shkak të ngarkesës tejet të lartë të prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka qenë e pamundur ndjekja e vazhdueshme e trajnimeve në kuadër të trajnimeve të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Trajnimet që janë ndjekur kanë qenë ato të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria e Përgjithshme dhe partnerët si Euralius, Opdat etj. Prokurorët e prokurorisë Elbasan gjatë vitit 2021 kanë marrë pjesë për trajnimet me tema, “Mbi sistemin e-tracking PRESTO”, “Kundër Rrëmbimit apo heqjes së paligjshme të lirisë së personave dhe zhvatjes” “Korrupsioni si vepër penale në sektorin publik dhe privat”, “Pameca”, “Masat e sigurimit ndaj të miturit në konflikt me ligjin”, “Administrimi i prokurorisë dhe statistikave si mjete strategjike për përmirësimin e performancës”, “Pavlefshmeria e akteve të procedurës penale dhe reforma e procedurës penale”, Kontrohet dhe sekuestrimet si mjete të kërkimit të provës”, Kufijtë e veprimtarisë/kopetencat e gjyqtarit të hetimit paraprak”, “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive”, “Rishikimi i vendimeve penale, risitë”, Llojet e masave të shmangjes ndaj të miturit”, “Afatet e paraburgimit, etj”, “Prova skencore në procesin penal, vlerësimi i provës”, “Regjistrimi i procedimit penal, urdheri për regjistrimin e emrit, etj”. Po kështu oficerët e Policisë Gjyqësore kanë marrë pjesë në trajnime sipas tematikave përkatëse nga Shkolla e Magjistraturës.

II. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së prokurorisë

➤ *Volumi i punës në hetim*

Përgjatë vitit 2021, nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është vendosur mosfillimi i procedimit ,si dhe është ushtruar ndjekja penale në lidhje me procedime penale të mbartura nga viti 2020,procedime penale të regjistruara të reja,si dhe procedime të rifilluara e të hetuara gjatë vitit 2021,si dhe ato të ardhura me moskompetencë si më poshtë vijon:

- Është punuar për vlerësim për **890** materiale hetimore për të cilat më pas është vendosur mosfillimi, kanë kaluar aktet prokurorive të tjera për kompetencë ose janë mbartur për verifikim për vitin 2022;

- Janë hetuar në total **3385** procedime penale penale të mbartura nga viti 2020, procedime penale të regjistruara të reja (ku përfshihen dhe çështjet e ndara), procedime të rifilluara e të hetuara gjatë vitit 2021, si dhe ato të ardhura me moskompetencë prej të cilave:

- Janë hetuar **1970** procedime penale të regjistruar të reja, ku **1** procedim penal është regjistruar për veprë penale të parashikuar nga K.P.Ushtarak, si dhe gjithashtu janë përfshirë dhe çështjet e ndara gjatë vitit 2021;

- Janë hetuar **1392** procedime penale të mbartura nga viti 2020;

- Janë hetuar **24** procedime penale të rifilluara gjatë vitit 2021;

- Janë hetuar **9** procedime penale të ardhura me moskompetencë;

Ndërkohë të dhënat e vitit 2020 tregojnë se nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është vendosur mosfillimi i procedimit, si dhe është ushtruar ndjekja penale në lidhje me procedime penale penale të mbartura nga viti 2019, procedime penale të regjistruara të reja, si dhe procedime të rifilluara e të hetuara gjatë vitit 2020, si dhe ato të ardhura me moskompetencë si më poshtë vijon:

- Ishin punuar për vlerësim për **862** materiale hetimore për të cilat më pas është vendosur mosfillimi, kanë kaluar aktet prokurorive të tjera për kompetencë ose janë mbartur për verifikim për vitin 2021;

- Ishin hetuar në total **3792** procedime penale penale të mbartura nga viti 2019, procedime penale të regjistruara të reja (ku përfshihen dhe çështjet e ndara), procedime të rifilluara e të hetuara gjatë vitit 2020, si dhe ato të ardhura me moskompetencë prej të cilave:


- Ishin hetuar **2143** procedime penale të regjistruar të reja, ku **1** procedim penal është regjistruar për veprë penale të parashikuar nga K.P.Ushtarak, si dhe gjithashtu janë përfshirë dhe çështjet e ndara gjatë vitit 2020;

- Ishin hetuar **1631** procedime penale të mbartura nga viti 2019;


- Ishin hetuar **12** procedime penale të rifilluara gjatë vitit 2020;

- Ishin hetuar **5** procedime penale të ardhura me moskompetencë;

Volumi i materialeve+hetim viti 2021




Volumi i materiale+hetim viti 2020



Sa më sipër rezulton se volumi çështjeve mosfillim-hetim për vitin **2021** është **4000** ,ndërsa për vitin **2020** ka qenë **4542**.

Gjatë vitit **2021** janë trajtuar **542** çështje (mosfillim-hetim) më pak në vitin **2020**.


Volumi i çështjeve materiale-hetim viti 2021 e 2020 i krahasuar



Përsa i përket numrit të procedimeve të hetuara rezulton se si gjatë vitit **2021** janë hetuar **3385** procedime, si dhe gjatë vitit 2020 janë hetuar **3791** procedime.

Në këtë aspekt, vlerësohet se në zbatim të nenit 291 të K.Pr.Penale ,duke ju lënë prokurorit një afat 15 ditor që të vendosë për fillimin apo mosfillimin e procedimit penal, ka sjellë rritjen e numrit të procedimeve penale të regjistruara për vitin 2021, pasi një afat i tillë nuk mund të bëjë të mundur që prokurori të administrojë në kohë të gjitha aktet dhe informacionet në kuadër të vlerësimit të materialit hetimor.

Volumi i procedimeve viti 2021 e 2020 i krahasuar



Në lidhje më një pjesë të çështjeve penale të hetuara për vitin 2021 ,ato u janë deleguar për veprime hetimore dhe janë hetuar nga oficerë të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe konkretisht 859 procedime penale ,nga totali prej 3385 procedimesh penale të hetuara në total në këtë prokurori.

Ndërsa 2526 procedime penale është hetuar nga oficerë të shërbimeve të policive të tjera gjyqësore, ku pjesën më të madhe e zënë shërbimet e policisë gjyqësore në vartësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.

Në vitin 2020 nga oficerët e seksionit të policisë gjyqësore të Prokurorisë ishin hetuar 878 procedime (23%), ndërsa 2914 procedime (77%) ishte hetuar nga oficerë të shërbimeve të policive të tjera gjyqësore, ku pjesën më të madhe e zënë shërbimet e policisë gjyqësore në vartësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.


Sic shihet në krahasim me vitin 2020 rezulton se gjatë vitit 2021 nga oficerët e seksionit të policisë gjyqësore të Prokurorisë janë hetuar 19 çështje më pak.

Gjithashtu është për tu theksuar fakti se në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, gjatë vitit 2021 janë hetuar edhe 1930 procedime penale të rifilluara për arsye parashkrimi të ndjekjes penale, për të cilat është proceduar me vendime pushimi nga prokurorët ose me kërkesa për pushim në gjykatë, numër procedimesh ky i cili nuk është futur në të dhënat e më sipërme dhe ato statistikore. Kjo tregon për një ngarkesë pune të prokurorëve.

1.REFERIMET:

Gjatë vitit 2021 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore, janë regjistruar kryesisht, janë regjistruar mbi bazën e kallëzimeve penale të institucioneve të tjera publike, si dhe janë regjistruar mbi bazën e kallëzimeve penale të shtetasve apo subjekteve fizikë apo juridikë gjithsej 2859 materiale hetimore, ndërkohë që në vitin 2020 ishin regjistruar 3005 materiale hetimore.

Sa më sipër rezulton se në vitin 2021 janë regjistruar 145 materiale hetimore më pak se në vitin 2020.



Në lidhje me 2859 materiale hetimore të regjistruara gjatë vitit 2021, në 615 raste është vendosur mosfillimi i procedimit penal, në 1969 raste janë regjistruar procedime të reja penale, në 5 raste kanë kaluar aktet e para hetimore për kompetencë në Prokurori të tjera, si dhe 265 materiale hetimore kanë mbetur për verifikim për vitin 2022.

Ndërkohë në vitin 2020, në lidhje me 3005 materiale hetimore të regjistruara në 751 raste ishte vendosur mosfillimi i procedimit penal, në 2143 raste ishin regjistruar procedime të reja penale, në 5 raste kishin kaluar aktet e para hetimore për kompetencë në Prokurori të tjera, si dhe 106 materiale hetimore kishin mbetur për verifikim për vitin 2021.

Nga statistikat e prokurorisë konstatohet se:

Nga statistikat e prokurorisë për vitin 2021 konstatohet se:

Gjatë vitit 2021 janë referuara nga shërbimet e policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan dhe shërbimet e policisë gjyqësore të Komisariateve të Policisë që mbulojnë Qarkun e Elbasanit, **2236** materiale hetimore të regjistruara.

Ndërkohë në vitin 2020 ishin referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan dhe shërbimet e policisë gjyqësore të Komisariateve të Policisë që mbulojnë Qarkun e Elbasanit gjithsej **2603** materiale hetimore të regjistruara.

Siç shihet gjatë vitit 2021 janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan dhe shërbimet e policisë gjyqësore të Komisariateve të Policisë që mbulojnë Qarkun e Elbasanit **367** materiale hetimore më pak se viti 2020.

2.MOSFILLIMET:

Gjatë vitit 2021 është vendosur mosfillimi i procedimit penal 615 materiale hetimore, ku pjesa më e madhe e mosfillimeve është bërë për arsye se faktet nuk parashikohen nga ligji si vepra penale, ose për vepra penale të cilat ndiqen mbi bazën e ankimit të viktimës së dëmtuar nga vepra penale.

Gjatë vitit 2021 për 5 ankime që i është bërë vendimit të mosfillimit të prokurorëve, nga gjykata është vendosur shfuqizimi i vendimit të mosfillimit dhe nga prokurori është vendosur regjistrimi i procedimit penal.

3. PROCEDIMET E HETUARA

a) PUSHIMET:

Gjatë vitit 2021 nga prokurorët e kësaj prokurorie është vendosur pushimi i çështje ose është kërkuar në gjykatë pushimi i çështjes në total për 555 procedime penale me 154 persona, prej të cilëve 4 të arrestuar.

Siç shihet nga të dhënat statistikore rezulton se pjesa më e madhe e çështjeve të pushuara janë çështje të cilat janë ndjekur mbi bazën e ankimit (Nenet 84,89 e 275 të K.Penal), si dhe shumica e tyre është pushuar për shkak të heqjes dorë nga ankimi.


b) Kërkesat për pushimin e çështjes penale:

Gjatë vitit 2021 ,në lidhje me procedimet penale të përfunduara, 425 procedime, me 132 persona/pandehur në hetim, prej të cilëve 4 të arrestuar janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushimin e çështjes:

Vendim marrja e gjykatës në lidhje me kërkesat për pushimin e çështjeve:

Në lidhje me kërkesat për pushim të bëra nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë vitit 2021 ,duke u përfshirë dhe ato të dërguara me kërkesë pushimi para vitit 2021 dhe që kishin mbetur për tu gjykuar gjatë vitit 2021, rezulton se në gjykatë gjatë vitit 2021 janë zhvilluar gjykimet gjithsej për 204 kërkesa pushimi, si dhe në lidhje me këto kërkesa rezulton se nga gjykata janë pranuar 425 kërkesa, janë kthyer aktet për hetim për 5 procedime, si dhe kanë mbetur në gjykim në seancë paraprake për vitin 2021 ,gjithsej 221 kërkesa pushimi .

Të dhëna për vendim marrjen e gjykatës për kërkesat për pushim



Siç është theksuar edhe më lart, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ,gjatë vitit 2020 janë hetuar edhe 1930 procedime penale të rifilluara për arësye parashkrimi të ndjekjes penale, për të cilat është proceduar me vendime pushimi nga prokurorët ose me kërkesa për

pushim në gjykatë,numër procedimesh ky i cili nuk është futur në të dhënat e më sipërme dhe ato statistikore.

Të dhëna për personat nën hetim të arrestuar për të cilët është kërkuar pushimi i çështjes:

Gjatë vitit 2021 është kërkuar në gjykatë pushimi i çështjes për 138 persona, prej të cilëve 2 kanë qenë të arrestuar.


- Është kërkuar pushim në bazë të nenit 328/dh e 329/a të K.Pr.Penale, për procedimin penal nr.518 të vitit 2021 në ngarkim të shtetasin S.I me masë sigurimi arrest në burg për nenin 130/a/4 të Kodit Penal.
- Procedimi penal Nr.486 viti 2021 për nenin 134/1 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit G.A, nga ku është bërë kërkesë për pushim për mjekim të detyrueshëm në një institucion mjekësorë .
- Procedimi penal Nr.2153 viti 2020 për nenin 283/1 të Kodit Penal për shtetasin R.P.
- Procedimi penal Nr.59 viti 2021 për nenin 237 të Kodit Penal për shtetasin SH.A nga ku është bërë kërkesë për pushim për mjekim të detyrueshëm në një institucion mjekësorë.

Shkaqet e pushimit të çështjeve (pushim+kërkesa për pushim):

Duke ju referuar të dhënave statistikore të vitit 2021 rezultojnë se pushimi i çështjes është vendosur apo kërkuar për 3 procedime penale për mungesë fakti;

Pushimi i çështjes është vendosur apo kërkuar për 5 procedime penale për mungesë provash.


Pushimi i çështjes është vendosur apo kërkuar për 547 procedime penale me 154 persona nën hetim për shkaqe të tjera.



b) PEZULLIMET.

Gjatë vitit 2021 nga prokurorët e kësaj prokurorie janë pezulluar hetimet për 637 procedime penale, për arsye të moszbulimit të autorëve të veprës penale.

Të dhëna për çështjet e pezulluara




Sic shihet nga të dhënat statistoke për veprën penale të “Vjedhje” e parashikuar nga neni 134 i K.Penal zbulueshmëria e autorëve të veprës penale lë shumë për të dëshiruar, duke patur parasysh edhe faktin se kjo është dhe vepra penale më e përhapur në Qarkun e Elbasanit.

c) MOSKOMPETENCAT:

Gjatë vitit 2021 nga prokurorët e kësaj prokurorie është shpallur moskompetenca tokësore apo ajo lëndore për 23 procedime me 7 persona nën hetim, prej të cilëve 4 të arrestuar.

Të dhëna për moskompetencat




c) URDHËRA PENAL


Gjatë vitit 2021 nga prokurorët e kësaj prokurorie janë dërguar gjithsej 10 kërkesa miratim urdhëri penal për 10 të pandehur, si dhe nga gjykata janë miratuar urdhëra penale për 8 çështje me 8 të pandehur, është refuzuar urdhëri penal për 2 çështje me 2 të pandehur.

Në rastin kur është refuzuar urdhëri penal i prokurorit për 2 të pandehurit nga prokurori më pas çështja ka shkuar për gjykim.

Cështje



Të pandehur




d) MARRËVESHJE PRANIM FAJËSIE

Nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan gjatë vitit 2021 është arritur dhe është kërkuar miratimi i marrëveshjes së pranimit të fajësisë për 28 çështje me 30 të pandehur.

Ndërkohë në gjykim janë prokurorët kanë marrë pjesë në gjykimin marrëveshjeve të pranimit të fajësisë të mbetura në gjykim para vitit 2021, si dhe atyre të dërguara për gjykim gjatë vitit 2021, ku nga gjykata janë pranuar 30 marrëveshje pranim fajësie, janë refuzuar dhe kthyer aktet për 4 marrëveshje pranim fajësie.

- Është refuzuar marrëveshja e pranimit të për 2 proçedime penale për veprën penale të parashikuar nga ne ni 199/a i Kodit Penal
- Është refuzuar marrëveshja e pranimit të për 2 proçedime penale për veprën penale të parashikuar nga ne ni 190 i Kodit Penal

Të dhëna për vendim marrjen e gjykatës për kërkesat për miratim marrëveshje pranim fajësie



dh) KËRKESA PËR DËRGIMIN E ÇËSHTJEVE PËR GJYKIM


Gjatë vitit 2021, nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan janë dërguar me kërkesa për gjykim të drejtëpërdrejtë ose me kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq 756 procedime penale me 893 të pandehur, prej të cilëve 165 të arrestuar.

Janë dërguar në gjykim me kërkesë për gjykim të drejtëpërdrejtë gjithsej 11 procedime me 11 të pandehur, prej të cilëve 5 të arrestuar, si dhe nga gjykata në të gjitha rastet është pranuar kërkesa e prokurorit për gjykim të drejtëpërdrejtë.

Pjesën më madhe të dërguara me kërkesë për gjykim të drejtëpërdrejtë e zënë çështjet e regjistruara në ngarkim të të pandehurve të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Drejtimit i automjeteve në mënyrë të parregullt” të parashikuar nga neni 291 i K.Penal, gjithsej 8 procedime penale me 8 të pandehur.

Janë dërguar në gjykim me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjykim gjithsej 756 procedime me 893 të pandehur, prej të cilëve 165 të arrestuar, si dhe nga gjykata në seanca paraprake është vendosur kthimi i akteve për 7 procedime me 7 të pandehur, si dhe kanë mbetur për tu gjykuar për 454 procedime me 557 të pandehur prej të cilëve 80 të arrestuar.

Të dhëna për vendim marrjen e gjykatës për kërkesat për dërgim cështje në gjyq



➤ Cështje të përfaqësuara në gjykatë

Gjatë vitit 2021 Prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, kanë përfaqësuar në gjykime themeli 1277 çështje me 1506 të pandehur, prej të cilëve 260 të arrestuar, cështje këto ku përfshihen ato të mbartura në gjykim themeli nga viti 2020 dhe ato të dërguar për gjykim në vitin 2021 (përfshirë të dhënat për K.Penal Ushtarak).


Gjatë vitit 2021 kanë përfunduar gjykimet e themelit për 822 çështje me 948 të pandehur, prej të cilëve 178 të arrestuar.

Gjithashtu për vitin 2021 janë mbartur në gjykime themeli 520 çështje me 612 të pandehur, prej të cilëve 93 të arrestuar.


Ndërkohë gjatë vitit 2020 Prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, kanë përfaqësuar në gjykim themeli 1211 çështje me 1414 të pandehur, prej të cilëve 241 të arrestuar, prej të cilëve .

Gjatë vitit 2020 kishte përfunduar gjykimi për 692 çështje penale me 772 të pandehur, prej të cilëve 145 të pandehur të arrestuar, si dhe ishin mbartur në gjykim për vitin 2021 gjithsej 519 çështje me 642 të pandehur, prej të cilëve 96 të arrestuar.


Të dhëna krahasuese për cështjet e përfaqësuara në gjykime themeli për vitet 2020-2021




Të dhëna krahasuese për gjykimet e themelit të përfunduara për vitet 2020-2021




Të dhëna krahasuese gjykime themeli të mbartura nga vitet 2020-2021, për vitet pasardhëse



Të dhëna krahasuese për gjykimet e themelit për të pandehurit për vitet 2020-2021



Të dhëna krahasuese gjykimet e themelit për të pandehurit e gjykuar për vitet 2020-2021



Sic shihet gjatë vitit 2021 prokurorët kanë marrë pjesë në gjykime themeli në 65 çështje më shumë se në vitin 2020.

Gjithashtu rezulton se gjatë vitit 2021 kanë përfunduar gjykimet e themelit për 130 çështje më shumë se viti 2020.

CËSHTJET NË GJYKIM TË MBARTURA PËR VITIN 2022:


Në fund të vitit 2021 janë mbartur për tu gjykuar për vitin 2022 gjithsej 454 çështje me 557 të pandehur prej të cilëve 82 të arrestuar.

Ndërkohë që në fund të vitit 2020 ishin mbartur për tu gjykuar në vitin 2021 gjithsej 519 çështje me 642 të pandehur prej të cilëve 96 të arrestuar.

➤ Treguesit krvesorë të punës së prokurorisë

Raporti i çështjeve të reja me të mbarturat dhe prurjet e tjera gjatë vitit 2021:

Pra në përqindje rezulton se nga tërësia e materialeve, duke i ndarë në procedime penale dhe materiale kallzuese, rezulton se 79 % përbëjnë procedime dhe 21 % materiale kallzuese (përfshihen mosfillimet, kallzimet që kanë mbetur në verifikim dhe ato të transferuara apo të bashkuara).



Puna e kryer në total gjatë vitit 2021 dhe materiale e procedime penale të mbetura për hetim gjatë për vitin 2022:


- Materiale të mosfilluara gjithsej 615;
- Materiale të mbartura për verifikim për vitin 2022 gjithsej 265;
- Materiale kaluar aktet për moskompetencë gjithsej 5;

- Procedime penale të përfunduara gjithsej 1971;
- Procedime penale të mbetura për hetim për vitin 2022 gjithsej 1414.

Kjo prokurori gjatë vitit 2021 ka përfunduar hetimet për 2585 materiale hetimore e procedime, ndërkohë që i kanë mbetur në hetim 1414 procedime penale dhe 265 materiale kallëzuese në verifikim.

Ndërkohë gjatë vitit 2020 puna e kryer në total dhe materiale e procedime penale të mbetura për hetim gjatë për vitin 2021 ishin :

- Materiale të mosfilluara gjithsej 751;
- Materiale të mbartura për verifikim për vitin 2020 gjithsej 104;
- Materiale kaluar aktet për moskompetencë gjithsej 5;
- Procedime penale të përfunduara gjithsej 2425 ;
- Procedime penale të mbetura për hetim për vitin 2021 gjithsej 1366.



Në lidhje me materialet hetimore të mbetura për vlerësim për në vitin 2022 rezultojnë se ato janë regjistruar në dyjavëshin e fundit të muajit dhjetor 2021 dhe kanë qenë brenda afatit 15 ditor për tu vlerësuar nga prokurët dhe për të vendosur nëse në lidhje me to do të vendoset mosfillimi apo regjistrimi i procedimit penal.


Gjithashtu, vlerësohet se një faktor që ndikon në mospërfundimin në kohë të çështjeve penale janë dispozitat procedurale penale, pasi prokurorit i duhet të përballet me gjyqtarin e seancës paraprake përpara vendosjes përfundimisht të dërgimit të çështjes për gjykim apo pushim dhe në këtë pjesë, duhet të përlllogaritur edhe koha e gjykatës për vendimmarrje, e cila mund të jetë edhe kthimi i akteve prokurorit për vazhdimin e hetimeve. Si dhe numri i pakët i gjyqëtarëve.

Pikërisht këta faktorë, megjithëse janë ndër faktorët që ndikojnë në evadimin në kohë të çështjeve, duhet të shërbejnë si një nxitës i mëtejshëm i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, për të treguar se mund të përballojnë punën në kushtet e një mbingarkese.

Raporti i përfundimit të çështjeve dhe atyre të mbetura në hetim gjatë vitit 2021:

Rezulton të jenë përfunduar 615 materiale kallzuese (615 vendime mosfillimi dhe 5 materiale kallëzuese përcjellë për kompetencë), 1971 proçedime penale (bashkë me transferimet për kompetencë dhe bashkimet e çështjeve).

Për vitin 2022 kanë ngelur në hetim 1414 proçedime penale dhe 265 materiale kallzuese në verifikim.




Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale

Gjatë vitit 2021 janë hetuar gjithsej 1368 persona nën hetim/të pandehur, prej të cilëve 251 të arrestuar.

Hetimi ka përfunduar për 1054 persona nën hetim/të pandehur prej të cilëve 175 të arrestuar.

Kanë mbetur në hetim për vitin 2022 gjithsej 314 persona nën hetim prej të cilëve 76 të arrestuar.



Ndërkohë gjatë vitit 2020 ishin hetuar gjithsej 1507 persona nën hetim/të pandehur, prej të cilëve 263 të arrestuar.

Gjatë vitit 2020 hetimi kishte përfunduar gjithsej 1269 persona nën hetim/të pandehur, prej të cilëve 173 të arrestuar si dhe kishin mbetur në hetim për vitin 2021 gjithsej 238 persona nën hetim prej të cilëve 90 të arrestuar.

Krahasuar me vitin 2020, gjatë vitit 2021 hetimi ka përfunduar për 215 persona nën hetim/të pandehur më pak, si dhe janë mbartur në hetim për vitin pasardhës gjithsej 76 persona nën hetim më pak.

Rezulton se në vitin 2021, 2 çështje penale kanë filluar kryesisht, janë paraqitur 31 kallëzime nga shtetasit, 2236 referime nga policia e shtetit, 64 nga nënpunës publik, 4 nga tatimet, 0 nga policia pyjore dhe 2 referime nga policia ushtarake, 0 referime nga OSHEE, 0 nga K.L.SH, etj.

➤ Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror

Arrestimet në flagrancë dhe ndalimet:

Gjatë vitit 2021 nga shërbimet e policisë gjyqësore janë arrestuar në flagrancë 509 persona, si dhe janë ndaluar 11 persona, ndërsa nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është urdhëruar ndalimi i 14 personave.

Gjatë vitit 2021 nga prokurori është urdhëruar lirim i menjehershëm për 1 person, ndërkohë për 535 kërkesa të prokurorit për vlefzim nga gjykata janë vlerësuar të ligjshme 534 kërkesa dhe 1 kërkesë është vlerësuar e paligjshme dhe është urdhëruar lirimi i menjehershëm për të arrestuarin L.F për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/4 të K.Penal

Të dhëna për arrestimet në flagrancë dhe ndalimet gjatë vitit 2021

Neni K.P	Arrestime në flagrancë	Ndalime nga opgj	Ndalime nga prokurori
76-79/ë	3	0	0
78/1	1	0	0
79/dh	1	0	0
79/ë	0	0	2
79/b	1	0	0
79/c	1	0	0
88	12	0	0
89	3	0	0
100/1	1	0	0
103/1	2	0	0
108/1	1	0	0
110/2	9	0	0

121/a	5	0	0
130/a	45	1	0
134	30	1	0
135	0	1	0
137	6	0	0
139	1	0	1
143	0	1	0
146	1	0	0
151	2	0	0
161	1	0	0
174	1	0	0
178/1	2	0	0
180/1	7	0	0
183	1	0	0
186/2	1	0	0
187	1	0	0
189	1	0	0
197	1	0	0
199/a	17	1	0
206/a/1	1	0	0
235,236,237	12	1	0
244/1	2	0	0
248	7	4	1
274/a/1	1	0	0
278	9	0	0
279	4	0	0
283	62	0	0
283/a/2	2	0	0
284	5	1	0
285/a/1	1	0	0
289/1	1	0	0
290	31	0	0
291	194	0	0
298	16	0	0
301	0	0	1
321/2	1	0	0
323	5	0	0

Sic shihet dhe nga të dhënat statistikore për të arrestuarit në flagrancë dhe të ndaluarit ,numrin më të madh e zënë personat e arrestuar për veprën penale të “Drejtimit i mjeteve në mënyrë të parregullt” të parashikuar nga neni 291 i K.Penal ,gjithsej 194 persona.

Vendin e dytë për të arrestuarit në flagrancë dhe të ndaluarit nga shërbimet e policisë gjyqësore e zënë personat e arrestuar për veprat penale në fushën e narkotikëve N.283- 284 të K.Penal, gjithsej 71 persona.

Paskëtyre veprave rezulton se janë arrestuar në flagrancë dhe ndaluar 46 persona për veprën penale të “Dhuna në familje”, e parashikuar nga neni 130/a i K.Penal, 31 persona për veprën penale të “Vjedhje” e parashikuar nga neni 134 i K.Penal, 16 persona për veprën penale të “Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit” e parashikuar nga neni 298 i K.Penal, si dhe 31 persona për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” të parashikuar nga neni 290 i K.Penal.

Gjatë vitit 2020 nga shërbimet e policisë gjyqësore janë arrestuar në flagrancë 510 persona, si dhe ishin ndaluar 6 persona, ndërsa nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ishte urdhëruar ndalimi i 8 personave.

Ndryshe nga viti 2020 vërehet se gjatë vitit 2021 nga shërbimet e policisë gjyqësore janë kryer 1 arrest më pak dhe janë ndaluar 5 persona më shumë, ndërsa nga prokurorët është urdhëruar ndalimi i 6 personave më shumë.

Masat e sigurimit personal

Gjatë vitit 2021 nga prokurorët janë kërkuar gjithsej 531 masa sigurimi shtrënguese dhe 4 masa sigurimi ndaluese.

Është kërkuar masa e sigurimit “arrest në burg” për 215 persona, ajo e “arrestit në shtëpi” për 11 persona, “arrest me afat” për 19 persona, “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” për 286 persona, si dhe masa sigurimi ndaluese për 4 persona.

Ndërkohë gjatë vitit 2020 nga gjykata janë dhënë gjithsej 530 masa sigurimi shtrënguese dhe 4 masa sigurimi ndaluese.

Është dhënë masa e sigurimit “arrest në burg” për 186 persona, ajo e “arrestit në shtëpi” për 12 persona, “arrest me afat” për 19 persona, “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” për 313 persona, si dhe masa sigurimi ndaluese për 7 persona.

Nga prokurorët e kësaj prokuroria, në lidhje me masat e sigurimit më të buta të dhëna nga gjykata, apo në lidhje me zëvendësimet e masave të sigurimit është ushtruar ankimi 16 raste, ndërsa nga Gjykata e Apelit vetëm në 1 rast është vendosur në favor të ankimit të prokurorit dhe për 33 raste masë sigurimi më të butë dhe 1 rast shfuqizim vendimi.

Krahasuar me vitin 2020 nga prokurorët gjatë vitit 2021 janë kërkuar 22 masa sigurimi “arrest me burg” më pak, 4 masa sigurimi “arrest në shtëpi” më pak, 38 masa sigurimi “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” më shumë, si dhe 1 masë sigurimi ndaluese më pak.

Krahasuar me vitin 2020 nga prokurorët gjatë vitit 2021 janë kërkuar 18 masa sigurimi “arrest me burg” më pak , 16 masa sigurimi “arrest në shtëpi” më pak, 36 masa sigurimi “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” më shumë, si dhe 1 masë sigurimi ndaluese më pak.

Masat e sigurimit viti 2021

Masa e sigurimit	Kërkesa e prokurorit	Vendimi gjykatëa
Masa shtrënguese	531	530
Arrest në burg	215	186
Arrest në shtëpi	11	12
Arrest me afat	19	19
Garanci pasurore	0	0
Detyrim për paraqitje...	286	313
Masa ndaluese	4	4

Të dhëna për masat e sigurimit për vepra penale gjatë vitit 2021

V.P sipas K.Penal	Kërkesa e prokurorit					Vendimi i gjykatës				
	Shtrënguese				Ndaluese	Masa shtrënguese				Ndaluese
	238	237	236	234		238	237	236	234	
76-79/ë	9	0	0	0	0	9	0	0	0	0
84	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
88	9	0	0	3	0	8	0	0	4	0
89,92	0	0	0	3	0	0	0	0	3	0
100-108/a	3	0	0	0	1	3	0	0	0	1
109/b/1	1	0	0	1	0	1	0	0	1	0
110/2	9	0	0	0	0	0	0	0	9	0
121/a	4	0	0	0	1	4	0	0	0	1
130/a	41	0	0	3	2	41	0	0	3	2
134-137	21	0	0	17	0	19	0	0	19	0
139	2	0	0	0	0	2	0	0	0	0
143	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
146	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
151	2	0	0	0	0	2	0	0	0	0
161	1	0	0	0	0	1		0	0	0
174	0	0	0	1	0	0	0	0	1	0
178	0	0	0	2	0	0	0	0	2	0
180	5	0		2	0	1	0	0	6	
186/2	0	0	0	1	0	0	0	0	1	0
187	0	0	0	1	0	0	0		1	0
189/1	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0

197	0	0	0	1	0	0	0	0	1	0
199/a	1	0	0	17	0	0	1	0	16	0
206/a/1	0	0	0	1	0	0	0	0	1	0
235-242	6	0	0	9	0	5	0	0	10	0
248	7	0	0	5	0	7	0	0	5	0
274/a	0	0	0	1	0	0	0	0	1	0
278-279	9	0	0	0	0	8	0	0	1	0
279	2	0	0	4	0	2	0	0	4	0
283-283/a	53	0	0	12	0	50	2	0	15	0
284	5	0	0	1	0	5	0	0	1	0
285/a	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
289	0	0	0	1	0	0	0	0	1	0
290	17	0	0	14	0	16	0	0	15	0
291	13	0	0	181	0	9	0	0	185	0
298	13	0	0	3	0	12	0	0	4	0
300-324/a	8	0	0	2	0	7	0	0	3	0

HETIMET PASURORE DHE MASAT E SIGURIMIT PASUROR:

-Sekuestrimet në kuadër të hetimit të procedimeve penale:

Në lidhje me çështjet në hetim ,gjatë vitit 2021, nuk ka patur raste që nga prokurorët e kësaj prokurorie të jetë kërkuar vendosja e vendosur masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive në bazë të nenit 270 e vijues të K.Pr.Penale.

-Hetimet pasurore, sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale sipas ligjit nr. 10192/2009 i ndryshuar “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimin te Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve te tjera, nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”;

Hetimet pasurore:

Pas ndryshimeve përkatëse në Kodin e Procedurës Penale,si dhe pas krijimit të Prokurorisë së Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), duke filluar nga fundi i vitit 2019 e në vazhdim dhe në vitin 2020, si kompetencë lëndore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka kaluar dhe hetimi pasuror,sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale sipas ligjit nr. 10192/2009 i ndryshuar “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimin te Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve te tjera, nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”.

Gjatë vitit 2021 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan janë regjistruar gjithsej 30 referime pasurore, dhe janë mbartur nga viti 2020 gjithësej 68 referime pasurore, nga ku gjatë vitit 2021 është vendosur mosfillimi për 24 referime pasurore.

Është shpallur moskompetenca për 1 referime pasurore, si dhe kanë mbetur për verifikime për vitin 2022 gjithsej 73 referime pasurore.

Sekuestrimet dhe konfiskimet

Gjatë vitit 2021 në kuadër të hetimeve pasurore sipas ligjit nr. 10192/2009 i ndryshuar “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve te tjera, nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”, rezulton se vetëm për një rast është kërkuar dhe është vendosur nga gjykata sekuestro e 3 pasurive të paluajtshme dhe 100% të kuotave të një shoqërie tregtare.

Në lidhje me sekuestrot e vendosura rezulton se deri në fund të vitit 2020 nuk është konkluduar nëse këto pasuri do të konfiskoheshin në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 10192/2009 i ndryshuar “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve te tjera, nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”

➤ Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë

1. Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë:

5/1/a) Gjatë vitit 2021, nga Prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan janë nxjerrë gjithsej 1230 urdhëra për ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë.

Në lidhje me urdhërat e ekzekutimit të nxjerra gjatë vitit 2021 rezulton se janë nxjerrë:


- 236 urdhëra për dënime me burgim;
- 69 urdhëra për dënime gjobë;
- 0 urdhëra për dënime plotësuese;
- 848 urdhëra për dënime alternative në zbatim të nenit 59 të K.Penal (pezullim ekzekutimi vendimi me burgim dhe vënie në provë);
- 77 urdhëra për dënime alternative në zbatim të nenit 63 të K.Penal (punë në interes publik);
- Si dhe mjaft urdhëra ekzekutimi në lidhje me urdhërime të tjera të gjykatës përsa i përket provave e shpenzimeve proceduriale.

Ndërkohë gjatë vitit 2020, nga Prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ishin nxjerrë gjithsej 1273 urdhëra për ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë dhe konkretisht:


- 433 urdhëra për dënime me burgim;
- 56 urdhëra për dënime gjobë;
- 3 urdhëra për dënime plotësuese;

- 713 urdhëra për dënime alternative në zbatim të nenit 59 të K.Penal(pezullim ekzekutimi vendimi me burgim dhe vënie në provë);
- 68 urdhëra për dënime alternative në zbatim të nenit 63 të K.Penal (punë në interes publik);
- Si dhe mjaft urdhra ekzekutimi në lidhje me urdhërime të tjera të gjykatës përsa i përket provave e shpenzimeve proceduriale.

Urdhëra ekzekutimi të nxjerra 2021




Urdhëra ekzekutimi të nxjerra 2020




5/1/b) Gjatë vitit 2021 janë ekzekutuar urdhëra ekzekutimi të vendimeve penale të formës së prerë të nxjerra gjatë vitit 2021, si dhe të mbartura pa u ekzekutuar nga vitet e mëparshme gjithsej 530 urdhëra ekzekutimi dhe konkretisht:

- 143 urdhëra për dënime me burgim;
 - 75 urdhëra për dënime gjobë;
 - 236 urdhëra për dënime alternative në zbatim të nenit 59 të K.Penal (pezullim ekzekutimi vendimi me burgim dhe vënie në provë);
 - 76 urdhëra për dënime alternative në zbatim të nenit 63 të K.Penal (punë në interes publik);
- Ndërkohë gjatë vitit 2020 ishin ekzekutuar urdhëra ekzekutimi të vendimeve penale të formës së prerë të nxjerra gjatë vitit 2020, si dhe të mbartura pa u ekzekutuar nga vitet e mëparshme gjithsej 966 urdhëra ekzekutimi dhe konkretisht:
- 93 urdhëra për dënime me burgim;
 - 59 urdhëra për dënime gjobë;
 - 200 urdhëra për dënime alternative në zbatim të nenit 59 të K.Penal(pezullim ekzekutimi vendimi me burgim dhe vënie në provë);
 - 0 urdhëra për dënime alternative në zbatim të nenit 59/a të K.Penal(qëndrim në shtëpi);
 - 31 urdhëra për dënime alternative në zbatim të nenit 63 të K.Penal (punë në interes publik);

Urdhëra të ekzekutuara 2021




Urdhëra të ekzekutuara 2020




5/1/c) Për vitin pasardhës 2022 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan kanë mbetur pa u ekzekutuar urdhëra ekzekutimi të nxjerra gjatë vitit 2021, si dhe në vitet e mëparshme gjithsej 256 urdhëra dhe konkretisht, 4 urdhëra për dënime me burgim të përjetshëm, 136 urdhëra për dënime me burgim dhe 69 urdhëra për dënime gjore;

Ndërkohë nga viti 2021 kishin mbetur pa u ekzekutuar urdhëra ekzekutimi të nxjerra gjatë vitit 2020, si dhe në vitet e mëparshme gjithsej 314 urdhëra dhe konkretisht 4 urdhëra për dënime me burgim të përjetshëm, 246 urdhëra për dënime me burgim, si dhe 87 urdhëra për dënime gjore;

Urdhëra të mbartur të pazezkuara 21'



Urdhëra të mbartur pazezkuara 20'



2.Gjykimet në fazën e ekzekutimit me të dënuarit:

Në territorin e Qarkut të Elbasanit janë ngritur dhe vazhdojnë funksionimin 3 institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale me Burgim :

- IEVP Elbasan, i vendosur në fshatin Bradashesh,të Njesisë Administrative Bradashesh,të Bashkisë Elbasan, i cili më së shumti shërben si institucion paraburgimi;
- IEVP Kosovë-Lushnje, i vendosur në fshatin Kosovë, të Bashkisë Belsh,i cili shërben si institucion burgimi i sigurisë së zakonshme;
- IEVP Peqin,i vendosur në qytetin e Peqinit, i cili shërben si institucion burgimi i sigurisë së zakonshme dhe i sigurisë së lartë.

Përveç këtyre institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale,në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan ndodhen dhe Dhomat e Paraburgimit ,të cilat shërbejnë për mbajtjen e të paraburgosurve të arrestuar në flagrancë apo të ndaluarve,deri në momentin e caktimit të masës së sigurimit nga gjykata,ose që shërbejnë për mbajtjen e të dënuarve të cilët kapen pas dhënies së dënimit me burgim dhe më pas transferohen në institucione të tjera të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim.

Duke qenë se në territorin e Qarkut Elbasan rezultojnë shumë institucione të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim,në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan janë zhvilluar shumë gjykime mbi bazën e kërkesës së të dënuarve me burgim në bazë të të drejtave që u njihen atyre në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale,si dhe me ligjet “Për ekzekutimin e vendimeve penale” dhe “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.

Prokurorët kanë marrë pjesë ne gjykimet administrative penale të zhvilluara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt: “*Lirim para kohe me kusht*“, sipas nenit 64 të Kodit Penal, për 47 të denuar dhe në perfundim të gjykimit kjo kërkesë është pranuar vetëm për 20 të dënuar:

Gjatë këtij viti nga prokurorët është marrë pjesë në gjykimin e kërkesave të dënuarve me objekt ***ndryshimi i llojit të sigurisë*** për 24 të dënuar të cilet vazhdonin të vuajne dënimin në Seksionin e Sigurisë së Lartë të I.E.V.P.Peqin,kërkesa të cilat janë rrëzuar nga gjykata.

Nga ana e 11 të dënuarve është kërkuar ***dënimi alternativ “Qëndrim në shtëpi”*** bazuar në nenin 59/a te Kodit Penal dhe nga gjykata janë rrëzuar kërkesat e tyre.

Gjatë këtij viti nga ana e 10 të dënuarëve është kërkuar ***njohja e dënimit të kryer jashtë shtetit***, para kohës së ekstradimit të tyre,kërkesa të cilat 9 janë pranuar nga gjykata.

Gjatë këtij viti për 35 të dënuar është bërë ***kërkesë për bashkimin e dënimeve*** dhe nga gjykata janë pranuar 34 kërkesa të tilla.

Gjatë këtij viti nuk janë gjykuar kërkesa të prokurorit për **shtyrje të afatit të regjimit të mbikqyerjes së vencantë të të dënuarve me burgim**, pas ndryshimit të bere në ligjin për të drejtat e të denurëve me burgim..

Gjatë këtij viti janë trajtuar 7 kërkesa të prokurorit apo të dënuarve për **shuarje dënimi** dhe janë pranuar 4 kërkesa. Për **përfitim nga amnistia** janë trajtuar 29 kërkesa të dënuarve dhe në tërësi nga gjykata janë pranuar 19 kërkesa.

Gjatë këtij viti janë trajtuar 1 kërkesa të për **disponimin e provave materiale në fazë ekzekutimi** dhe në tërësi nga gjykata është pranuar 1 kërkesë.

Gjatë këtij viti nga të dënuarit që vuajnë dënimin në I.E.V.P Peqin dhe Kosovë ka patur kërkesa dhe ankesa të cilat pasi janë shqyrtuar nga ana jonë dhe të dënuarve u është kthyer përgjigje ligjore. Gjithashtu korrespondencë të vazhdueshme gjatë vitit 2021 ka pasur edhe me Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës ,me IEVP-të dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

➤ Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, e shtrin kompetencën e vet në një hapësirë gjeografike dhe demografike të madhe në Qarkun e Elbasanit.

Njohja me këto të dhëna, duke e ndërthurrur me faktorë të tjerë, çon në kuptimin e rezultateve të punës sonë dhe të faktit përse disa vepra penale vihen re të kenë epërsi mbi disa të tjera.

Qarku i Elbasanit shtrihet në zonën qendrore të Shqipërisë dhe ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 3278 km² dhe një popullsi prej 270074 banorë sipas të dhënave të INSTAT për dt.01.01.2020.

Ky qark ka një shtrirje gjeografike të madhe dhe kufizohet nga shumë bashki si Tirana, Dibra, Pogradeci, Maliqi, Korca, Skrapari, Berati, Kuçova, Lushnja dhe Rrogozhina, si dhe me vijë kufitare me Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Qarku i Elbasan përbëhet nga 4 rrethe (Elbasan, Librazhd, Peqin dhe Gramsh), 7 bashki (Elbasan, Cërrik, Belsh, Peqin, Gramsh, Librazhd dhe Prrrenjas), si dhe nga 50 njësi administrative, në përbërje të të cilave janë 386 fshatra.



Aktualisht, bazuar ne ligjin nr. 115 të vitit 2014 “Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Qarku Elbasan, ka si qendër të tij, qytetin e Elbasanit.

Në procedimet penale të gjykuara gjatë vitit 2021 janë gjykuar **948** shtetas, Nga të dhënat statistikore rezulton se shtrirjen më të madhe të kriminalitetit e kanë qytetet Elbasan dhe më pas bashkitë përkatëse.

➤ *Kriminaliteti sipas përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre*

Sipas veprave penale të ndodhura dhe referimeve të policisë gjyqësore, konstatohet se sipas shtrirjes territoriale në Bashkinë Elbasan, në krahasim me bashkitë e tjera të Qarkut Elbasan, rezulton se në numër gjatë vitit 2021 janë më të përhapura veprat penale të “Vjedhje” (N.134 KP), “Drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt” (N.291 KP), “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” (N.290 KP), “Ndërtim i paligjshëm” (N.199/a K.P), veprat penale kundër shëndetit të kryera me dashje (N.89-90 KP), veprat penale kundër autoritetit të shtetit të kryera nga shtetasit (N.235-242 KP), “Dhuna në familje” (N.130/a KP), “Prodhin e shitje e narkotikëve” (N.283 i K.Penal) etj .

Përsa i përket veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” (N.284 i K.Penal) rezulton se kjo veper është më e përhapur në bashkitë Librazhd, Gramsh, Elbasan, Peqin, Prrenjas, Cërrik e Belsh ku karakteritike është fakti se bimët narkotike janë mbjellur në sipërfaqe toke shtetërore pranë kufijve ndarëse te qarkut Elbasan me qarqet e tjera, vende këto ku është shumë e vështirë që të shkohet dhe kontrollohet dhe për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore.

Përsa i përket veprës penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” (N.290 i KP) rezulton se një pjesë e konsiderueshme e këtyre veprave kanë ndodhur në akset rrugore nacionale “Elbasan-Peqin-Rrogozhinë”, “Elbasan-Librazhd-Prrenjas-Pogradec”, “Elbasan-Tiranë” , “Cërrik-Gramsh” dhe “Cërrik-Belsh”.

Përsa i përket veprës penale të “Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionet e ekzekutimit të vendimeve me burgim” (N.324/a KP) rezulton se pjesa më e madhe e tyre ka ndodhur në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale me Burgim në Peqin dhe Kosovë Belsh, ndërsa pjesa tjetër e tyre kanë ndodhur në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale me Burgim Elbasan.


Për të gjithë llojet e veprave penale të referuara gjatë vitit 2021 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan rezulton se pjesa më e madhe e tyre janë referime apo kallëzime penale për vepra penale të pretenduara të ndodhura në Bashkinë Elbasan, e cila realisht është dhe bashkia më e madhe e Qarkut të Elbasanit.

Konkretisht Bashkia Elbasan zë vendin e parë ndër Bashkitë e tjera të këtij qarku për referimet dhe kallëzimet për veprat penale kundër jetës të kryera me dashje ,veprave penale kundër shëndetit të kryera me dashje, “Shkaktim vetëvrasje” (N.99 KP), dhuna në familje, vjedhjet e ndryshme, mashtrimet, shkatërrimet e pronës të formave të ndryshme, veprave penale në lidhje me taksat dhe tatimet, ndërtime të paligjshme, veprat penale kundër autoritetit të shtetit të kryera nga shtetasit, prodhim dhe shitje e narkotikëve, ngjarjet automobilistike dhe drejtimet e mjeteve në mënyrë të parregullt, si dhe dhënia ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit.


➤ Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal (krime-kundërvajtje)

Më poshtë paraqitet analiza e strukturës së kriminalitetit për vitin 2021, sipas ndarjes në krime dhe kundravajtje penale që lidhen me procedimet penale të regjistruara të reja pranë organit të prokurorisë sipas veprave penale të parashikuara nga Kodi Penal.

Viti 2021



Viti 2020




III. Treguesit statistikore 2 vjecare te veprave penale sipas strukturës së Kodit Penal

- Në vitin 2021, për krime kundër jetës, me dashje janë regjistruar 31 procedime penale, ndërkohë që në vitin 2020 ishin regjistruar 34 procedime.
- Në vitin 2021 nuk kemi të regjistruar procedime për vepër penale kundër jetës të shkaktuar nga pakujdesia, ndërkohë që në vitin 2020 nuk kemi të regjistruar procedime për vepër penale kundër jetës të shkaktuar nga pakujdesia (por nw vitin 2020 wshtw hetuar njw cwshtje e mbartur nga viti 2019).
- Në vitin 2021, për vepra penale me dashje kundër shëndetit janë regjistruar 105 procedime penale të, ndërkohë që me vitin 2020 ishin regjistruar 96 çështje të tilla.
- Në vitin 2021 janë regjistruar 1 procedime penal për vepër penale kundër shëndetit me pakujdesi, ndërkohë që në vitin 2020 ishte regjistruar 5 procedim penal.
- Në vitin 2021, për vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës,apo shkaktim vetëvrasje janë regjistruar 41 procedime penale,ndërsa në vitin 2020 ishin regjistruar 60 procedime penale të tilla.
- Në vitin 2021, procedime penale për vepra penale me natyrë seksuale, janë regjistruar 14 procedime penale,ndërkohë që në vitin 2020 ishin regjistruar 7 të tilla.
- Në vitin 2021, për vepra penale kundër lirisë së personit, janë regjistruar 9 procedime, ndërsa në vitin 2020 ishin regjistruar 10 procedime.
- Në vitin 2021,për vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit janë regjistruar 32 procedime, ndërsa në vitin 2020 ishin regjistruar 27 procedime.
- Në vitin 2021,për vepra penale kundër fëmijëve, martesës, familjes janë regjistruar 111 procedime, ndërsa në vitin 2020 ishin regjistruar 137 procedime.
- Në vitin 2021 dhe 2020 nuk ka pasur të regjistruara procedime penale për vepra penale kundër lirisë së besimit;


- Në vitin 2021,për vepra penale në lidhje me vjedhjen e pasurisë janë regjistruar 410 procedime penale,ndërsa në vitin 2020 ishin regjistruar 608 procedime.
- Në vitin 2021,për veprat penale në lidhje me mashtrimet janë rregjistruar 26procedime,ndërsa në vitin 2020 ishin regjistruar 38 procedime.
- Në vitin 2021, vepra penale që lidhen me shkatërrimin e pronës janë rregjistruar 106 procedime, ndërsa në vitin 2020 ishin rregjistruar 110 procedime.
- Në vitin 2021 për veprat të kryera në shoqëritë tregtare janë rregjistruar 1 procedim penal, ndërkohë që në vitin 2020 ishin regjistruar 1 procedime.
- Në vitin 2021 për vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare është regjistruar 1 procedim penal,ndërsa në vitin 2020 është regjistruar 1 procedim penal
- Në vitin 2021, për krime në fushën e doganave janë rregjistruar 10 procedime penale,ndërsa në vitin 2020 ishin regjistruar 5 procedime.
- Në vitin 2021 për vepra penale në fushën e tatim taksave janë rregjistruar 27 procedime penale,ndërsa në vitin 2020 ishin rregjistruar 32 procedime.
- Në vitin 2021, për vepra penale në lidhje me falsifikimin e monedhave dhe letrave me vlerë janë regjistruar 9 procedime penale,ndërsa në vitin 2020 ishin regjistruar 7 procedime.
- Në vitin 2021 për vepra penale në lidhje me falsifikimi i dokumentave janë regjistruar 45 procedime penale, ndërsa në vitin 2020 ishin rregjistruar 34 procedime.
- Si në vitin 2021 ashtu edhe në vitin 2020, nuk ka pasur të rregjistruara vepra penale në fushën e falimentimit;
- Në vitin 2021, vepra penale në lidhje me zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit janë regjistruar 17 procedime penale,ndërsa në vitin 2020 ishin rregjistruar 9 procedime.
- Në vitin 2021 për vepra penale që çënojnë rregjimin juridik të tokës janë regjistruar 181 procedime penale,ndërsa në vitin 2020 ishin regjistruar 153 procedime.
- Në vitin 2021 për vepra penale kundër mjedisit ishin rregjistruar 29 procedime penale, ndërsa në vitin 2020 ishin rregjistruar 33 procedime.
- Në vitin 2021 për vepra penale për qëllime terroriste nuk ka pasur të rregjistruar ndonjë procedim penal, dhe në vitin 2020 nuk ka pasur të rregjistruar ndonjë procedim penal.
- Në vitin 2021 për vepra penale të kryera ndaj veprimtarisë shtetërore nga shtetasit janë regjistruar 50 procedime penale,ndërsa në vitin 2020 ishin rregjistruar 67 procedime.
- Në vitin 2021 për vepra penale të kryera ndaj veprimtarisë shtetërore nga punonjësit janë regjistruar 48 procedime penale,ndërsa në vitin 2020 ishin rregjistruar 50 procedime.
- Në vitin 2021 për vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike janë regjistruar 595 procedime penale,ndërsa në vitin 2020 ishin rregjistruar 540 procedime.
- Në vitin 2021 për vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërore janë regjistruar 19 procedime penale,ndërsa në vitin 2020 ishin regjistruar 30 procedime penale;
- Në vitin 2021 për vepra penale kundër drejtësisë janë regjistruar 46 procedime penale,ndërsa në vitin 2020 ishin regjistruar 51 procedime.

- Në vitin 2021 për vepra penale që çënojnë zgjedhjet e lira është regjistruar 4 procedim penal,ndërsa në vitin 2020 ishin regjistruar 1 procedime.


- **Procedime të rregjistruara të reja sipas seksioneve të Kodit Penal për vitet 2020–2021**



Viti 2021



Viti 2020



IV. Analiza e treguesve të efektivitetit të punës së prokurorisë

➤ Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe dënimin e të pandehurve

Në përfundim të gjykimeve të çështjeve penale gjatë vitit 2021 për 948 të pandehur të gjykuar nga prokurorët janë kërkuar :

- Dënime me gjobë për 90 të pandehur;
- Dënime me burgim për 297 të pandehur;
- Dënime alternative N.59 e 63 i K.Penal për 546 të pandehur;
- Pushim gjykimi për shkak vdekje të pandehuri ose për shkak të tërheqjes së ankimit për 14 të pandehur;
- Tërheqje aktesh për 1 çështje penale me 1 të pandehur;

Në përfundim të gjykimeve të çështjeve penale gjatë vitit 2021 për 948 të pandehur të gjykuar nga gjykata janë dhënë :

- Dënime me gjobë për 93 të pandehur;
- Dënime me burgim për 271 të pandehur;
- Dënime alternative N.59 e 63 i K.Penal për 563 të pandehur;
- Pushim gjykimi për shkak vdekje të pandehuri ose për shkak të tërheqjes së ankimit për 18 të pandehur.
- Pafajsi për 6 të pandehur në 5 çështje penale
- Kthim aktesh për 7 çështje penale me 7 të pandehur.

Në përfundim të gjykimeve të çështjeve penale gjatë vitit 2020 për 772 të pandehur të gjykuar nga prokurorët janë kërkuar :

- Dënime me gjobë për 83 të pandehur;
- Dënime me burgim për 209 të pandehur;
- Dënime alternative N.59 e 63 i K.Penal për 469 të pandehur;
- Pushim gjykimi për shkak vdekje të pandehuri ose për shkak të tërheqjes së ankimit për 6 të pandehur;
- Tërheqje akuze për 5 çështje penale;
- Tërheqje aktesh për 1 çështje penale me 1 të pandehur;

Në përfundim të gjykimeve të çështjeve penale gjatë vitit 2020 për 772 të pandehur të gjykuar nga gjykata janë dhënë :

- Dënime me gjobë për 77 të pandehur;
- Dënime me burgim për 183 të pandehur;
- Dënime alternative N.59 e 63 i K.Penal për 474 të pandehur;

- Pushim gjykimi për shkak vdekje të pandehuri ose për shkak të tërheqjes së ankimit për 8 të pandehur.
- Pafajsi për 24 të pandehur
- Kthim aktesh për 5 çështje penale me 5 të pandehur
- Pushim akuze për 1 çështje penale me 1 të pandehur.

Pafajsitë

Në lidhje me pafajsitë e dhëna gjatë vitit 2021 nga gjykata rezulton se:

- Është dhënë pafajsi për të pandehurin R.F të akuzuar për veprën penale “Vetëgjyqësi” të parashikuar nga neni 277 i K.Penal,në lidhje me procedimin penalNr.1182 viti 2019 për të pandehurin SH.K ,ndërkohë që nga prokurori i çështjes ishte kërkuar dënimi i këtij të pandehuri me 50000 lekë gjobë.Në lidhje me këtë pafajsi është ushtruar ankim nga prokurori i çështjes;

- Është dhënë pafajsi për të pandehurin A.E të akuzuar për veprën penale “Vetëgjyqësi” të parashikuar nga neni 277 i K.Penal,në lidhje me procedimin penal Nr.1450 viti 2018,ndërkohë që nga prokurori i çështjes ishte kërkuar dënimi i këtij të pandehuri me 50000 lekë gjobë.Në lidhje me këtë pafajsi është ushtruar ankim nga prokurori i çështjes;

- Është dhënë pafajsi për të pandehurin E.S të akuzuar për veprën penale “Dhunë në familje” të parashikuar nga neni 130/a i K.Penal,në lidhje me procedimin penal 771 të vitit 2020,ndërkohë që nga prokurori i çështjes ishte kërkuar dënimi i këtij të pandehuri me 3 muaj burgim dhe pezullim i ekzekutimit të dënimit me burgim (N.59 i K.Penal). Në lidhje me këtë pafajsi është ushtruar ankim nga prokurori i çështjes;

- Është dhënë pafajsi për të pandehurit J.Sh dhe LI.M të akuzuar për veprën penale “Shpërdorim detyre” të parashikuar nga neni 248 i K.Penal,në lidhje me procedimin penal 1502 të vitit 2019,ndërkohë që nga prokurori i çështjes ishte kërkuar dënimi me burg 9muaj për secilin të pandehur. Në lidhje me këto pafajsi është ushtruar ankim nga prokurori i çështjes,

- Është dhënë pafajsi për të pandehurin I.K të akuzuar për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike” të parashikuar nga neni 137/1 i K.Penal,në lidhje me procedimin penal 2394 të vitit 2019,ndërkohë që nga prokurori i çështjes ishte kërkuar dënimi i këtij të pandehuri me 2 muaj burg. Në lidhje me këtë pafajsi është ushtruar ankim nga prokuroria e çështjes;

Ankimimet:

Gjatë vitit 2021 nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, përveç ankimeve të sipërpërmendura për pafajsitë , është ushtruar ankim dhe për një pjesë të dënimeve të të pandehurve kur nga gjykata ishte dhënë lloj apo masë dënimi ndryshe nga sa kishte kërkuar prokurori.

Gjithsej gjatë vitit 2021 janë ankimuar 17 vendime të gjykatës në lidhje me dënimet,pushimet apo pafajsitë e dhëna për 26 të pandehur.

CËSHTJET NË GJYKIM TË MBARTURA PËR VITIN 2022:

Në fund të vitit 2021 ,janë mbartur për tu gjykuar për vitin 2022 gjithsej 454 çështje me 557 të pandehur prej të cilëve 82 të arrestuar.

Ndërkohë që në fund të vitit 2020 ishin mbartur për tu gjykuar në vitin 2021 gjithsej 519 çështje me 642 të pandehur prej të cilëve 96 të arrestuar.

➤ Të dhëna për gjykimet e posaçme

Në lidhje me çështjet penale për të cilat ka përfunduar gjykimi i themelit në shkallë të parë,përsa i përket llojit të gjykimimit me të cilin është proceduar në gjykim rezulton se:

- Gjatë vitit 2021 kanë përfunduar me procedurë gjykimi të drejtëpërdrejtë 1 çështje me 1 të pandehur.

Ndërkohë që gjatë vitit 2020 kishin përfunduar me procedurë gjykimi të drejtëpërdrejtë 4 çështje me 4 të pandehur .

Në krahasim me vitin 2020 ,gjatë vitit 2021 kanë përfunduar me gjykim të drejtëpërdrejtë 3 çështje më pak me 3 të pandehur më pak.

- Gjatë vitit 2021 kanë përfunduar me procedurë gjykimi të shkurtuar 721 çështje me 836 të pandehur .

- Ndërkohë që gjatë vitit 2020 kishin përfunduar me procedurë gjykimi të shkurtuar 547 çështje me 605 të pandehur .

Në krahasim me vitin 2020 ,gjatë vitit 2021 kanë përfunduar me gjykim të shkurtuar 174 çështje më shumë.

- Gjatë vitit 2021 kanë përfunduar me procedurë gjykimi të zakonshëm 90 çështje me 101 të pandehur.

Ndërkohë që gjatë vitit 2020 kishin përfunduar me procedurë gjykimi të zakonshëm 133 çështje me 154 të pandehur.

Në krahasim me vitin 2020 ,gjatë vitit 2021 kanë përfunduar me gjykim të zakonshëm 43 çështje më pak.

- Gjatë vitit 2021 kanë përfunduar me procedurë gjykimi pranim marrëveshje fajësie për 28 çështje me 30 të pandehur.

Ndërkohë që gjatë vitit 2020 kishin përfunduar me procedurë gjykimi marrëveshje fajësie 68 çështje me 68 të pandehur.


Në krahasim me vitin 2020 ,gjatë vitit 2021 kanë përfunduar me gjykim marrëveshje fajësie 40 çështje më pak.

- Gjatë vitit 2021 kanë përfunduar me procedurë gjykimi miratim urdhëri penal 10 çështje me 10 të pandehur.


Ndërkohë që gjatë vitit 2020 kanë përfunduar me procedurë gjykimi urdhëri penal 24 çështje me 27 të pandehur.

Në krahasim me vitin 2020 ,gjatë vitit 2021 kanë përfunduar me procedurë gjykimi miratim urdhëri penal 14 çështje më pak,me 17 të pandehur më pak.


Lloji i gjykimit për çështje viti 2020




Lloji i gjykimit për çështje viti 2021



Lloji i gjykimit për të pandehur viti 2020



Lloji i gjykimit për të pandehur viti 2021



➤ Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve

Në përfundim të gjykimeve të çështjeve penale gjatë vitit 2021 për 948 të pandehur të gjykuar nga prokurorët janë kërkuar :

- Dënime me gjobë për 90 të pandehur;
- Dënime me burgim për 297 të pandehur;
- Dënime alternative N.59 e 63 i K.Penal për 546 të pandehur;
- Pushim gjykimi për shkak vdekje të pandehuri ose për shkak të tërheqjes së ankimit për 14 të pandehur;
- Tërheqje aktesh për 1 çështje penale me 1 të pandehur;

Në përfundim të gjykimeve të çështjeve penale gjatë vitit 2021 për 948 të pandehur të gjykuar nga gjykata janë dhënë :

- Dënime me gjobë për 93 të pandehur;
- Dënime me burgim për 271 të pandehur;
- Dënime alternative N.59 e 63 i K.Penal për 563 të pandehur;
- Pushim gjykimi për shkak vdekje të pandehuri ose për shkak të tërheqjes së ankimit për 18 të pandehur.
- Pafajsi për 6 të pandehur në 5 çështje penale
- Kthim aktesh për 7 çështje penale me 7 të pandehur.


➤ Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit

Gjatë vitit 2021, sipas të dhënave statistikore , janë hetuar dhe gjykuar gjithsej 1977 persona nën hetim / të pandehur prej të cilëve:


- 40 të mitur 14-18 vjeç dhe 1937 të rritur;
- 1837 meshkuj dhe 100 femra;
- 9 shtetas të huaj dhe 1968 shtetas shqiptarë;
- 1291 me arësim deri në 9 klasë, 521 me arësim të mesëm dhe 165 me arësim të lartë;
- 3 punonjës shtetërorë dhe 1974 punonjës sektori privat apo të papunë;
- 1186 banues në qytet dhe 791 banues në fshat;
- 1 përsëritës së të njëjtës vepër penale, 237 përsëritës në vepra penale të ndryshme dhe 1739 të padënuar më parë;

Të mitur – të rritur


Gjinia




Arsimimi




Punesimi



Vendbanimi



Gjendja gjyqesore



Të pandehur persona juridikë:

Gjatë vitit 2021 janë hetuar, gjykuar apo janë mbartur në gjykim 5 persona juridikë dhe konkretisht:

- Gjatë vitit 2021 ka përfunduar gjykimi në ngarkim të subjektit juridik A..... sh.p.k,të akuzuar për veprat penale të akuzuar për veprat penale “Mospagimi i taksave dhe i tatimeve” të parashikuar nga nen1 181 të K.Penal, person juridik i pandehur ky për të cilin nga gjykata është dënuar me gjobë ashtu sic ka kërkuar dhe prokurori.
- Gjatë vitit 2021 ka përfunduar gjykimi në ngarkim të subjektit juridik C..... sh.p.k,të akuzuar për veprat penale të akuzuar për veprat penale “Mospagimi i taksave dhe i tatimeve” të parashikuar nga nen1 181 të K.Penal, person juridik i pandehur ky për të cilin nga gjykata është dënuar me gjobë ashtu sic ka kërkuar dhe prokurori.
- Gjatë vitit 2021 ka përfunduar gjykimi në ngarkim të subjektit juridik E..... sh.p.k,të akuzuar për veprat penale të akuzuar për veprat penale “Fallsifikim i dokumentave” dhe “Mashttrim” të parashikuar nga nenet 186/1 dhe 143/2 të K.Penal, person juridik i pandehur ky për të cilin nga gjykata është dënuar me gjobë ashtu sic ka kërkuar dhe prokurori.
- Gjatë vitit 2021 ka përfunduar gjykimi në ngarkim të subjektit juridik O..... sh.p.k,të akuzuar për veprat penale të akuzuar për veprat penale” “Fshehje e të ardhurave ” të parashikuar nga nenet 180 të K.Penal, person juridik i pandehur ky për të cilin nga gjykata është dënuar me gjobë ashtu sic ka kërkuar dhe prokurori.
- Gjatë vitit 2021 ka përfunduar gjykimi në ngarkim të subjektit juridik B..... sh.p.k,të akuzuar për veprat penale të akuzuar për veprat penale” “Fshehje e të ardhurave ” të parashikuar nga nenet 180 të K.Penal, person juridik i pandehur ky për të cilin nga gjykata është dënuar me gjobë ashtu sic ka kërkuar dhe prokurori.

➤ Të dhëna për të pandehurit e mitur

Personat autorë veprash penale dhe të pandehurit e mitur:

Në lidhje me të pandehurit e mitur rezulton re gjatë vitit 2021 janë referuar në Prokurorinë Pranë gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan 90 materiale hetimore, për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penale për 20 materiale, si dhe janë regjistruar gjithsej 71 procedime penale të reja me 62 të persona/pandehur, prej të cilëve 1 i arrestuar.

Nga të pandehurit e mitur 59 kanë qenë meshkuj dhe 3 femra.

Sipas grupmoshës 7 persona kanë qenë deri në 14 vjeç, 16 të grupmoshës 14-16 vjeç, si dhe 39 të grupmoshës 16-18 vjeç.

Në lidhje me veprat penale të kryera nga të miturit rezulton se të miturit më së shumti kanë kryer veprën penale të “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 i K.Penal, gjithsej 32 persona të mitur.

Paskësaj vepra penale më e përhapur e kryer nga të miturit është ajo e “Vjedhje” e parashikuar nga neni 134 i K.Penal, gjithsej 11 persona.

Përsa i përket veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe konkretisht “Prodhimi dhe shitje e narkotikëve” e parashikuar nga neni 283 i K.Penal rezulton se person nën hetim kanë qenë 2 të mitur.

Në lidhje me çështjet penale ku autorë janë të miturit rezulton se gjatë vitit 2021 është kërkuar janë pushuar 37 procedime penale nga të cilat 28 kanë qenë shmangie nga dënimi, konkretisht paralajmërim me shkrim dhe 9 janë pushuar për arsye të tjera, 5 janë pezulluar dhe një procedim është transferuar.

Është kërkuar dërgimi i çështjes për gjykim për 13 procedime me 15 të pandehur, ku nga gjykata janë pranuar 5 kërkesa për dërgim çështje në gjyq, 1 çështje është pushuar.

Nuk ka përfunduar gjykimi i ndonjë çështje penale me të pandehur të mitur.


Të dhëna për referime, mosfillime e procedime për persona/pandehur të mitur viti 2021

Referime	Mosfillime	Çështje të regjistruara	Persona nën hetim/pandehur	Arrestuar
90	20	71	62	1

Të dhëna për personat/pandehur të mitur gjatë vitit 2021

Moshë			Gjinia	
Deri 14 vjec	14-16 vjec	16-18 vjec	Meshkuj	Femra
7	16	39	59	3

Mënyra e përfundimit të çështjeve me persona/pandehur të mitur gjatë vitit 2021 dhe ato të mbetura në hetim



Të dhëna për personat/pandehur të mitur për vitin 2021 sipas veprave penale


Vepra penale sipas neneve	Persona/pandehur
N. 89	3
N. 109/b	1
N. 100/1	1
N. 117/2	2
N. 134	11
N. 197	1
N. 236	1
N. 273	1
N. 283	2
N. 291	32
N. 114/1	1
N. 76 - 22	1
N. 290	2
Totali	59

➤ Të dhëna për pasojat e veprave penale


Nga të dhënat statistikore gjatë vitit 2021 rezulton se kanë ardhur 200 pasoja nga veprat penale, në lidhje lidhje me jetën apo dëmtimet në shëndet ku:

- Ka patur 49 të vdekur, prej të cilëve 21 për N.290 të K.Penal, 22 për N.99 të K.Penal, 1 për N.96 të K.Penal, si dhe 10 për krime kundër jetës (N.76,78, 79,79/c të K.Penal);
- Ka patur 44 të plagosur rëndë, prej të cilëve 37 për N.290 të K.Penal, 7 për N.88 të K.Penal;
- Ka patur 107 të plagosur lehtë prej të cilëve 80 për N.89 të K.Penal;
- Ka patur dhe shumë pasoja të tjera dëmtime të lehta në shëndet, të cilat nuk janë pasqyruar në të dhënat statistikore.

Pasojat në jetë dhe dëmtime në shëndet



Pasojat në jetë (vdekje)



V. Të dhëna lidhur me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja

➤ Ekstradime, Letërporosi, Transferime procedimesh, Transferime te dënuarish, Shpalljet/Heqjet nga kërkimi ndërkombëtar

Nga prokurorët e kësaj prokurorie janë bërë 6 kërkesa për ekstradim për jashtë shtetit dhe nga gjykata është vendosur ekstradimi për 4 persona.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie janë bërë 2 kërkesa për ekstradim nga jashtë shtetit personash të dënuar dhe është ekzekutuar vetëm 2 kërkesë.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie janë bërë në gjykatë 48 kërkesa për ekzekutim të letërporosive të ardhura nga autoritet e huaja, si dhe nga gjykata është disponuar dhe janë ekzekutuar gjithsej 40 letërporosi, ndërsa për 8 letërporosi rezulton se ka qenë e pamundur që të ekzekutuar pavarësisht veprimeve të prokurorit dhe gjykatës.

Letërporosi të dërguara nga prokurorët e kësaj prokurorie, në drejtim të shteteve të huaja, rezulton të jenë 34 të tilla, kryesisht për veprat penale si më poshtë vijon:

- 3 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi vepra penale kundër jetës dhe personit;
- 11 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike;
- 20 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi krime kundër autoritetit të shtetit, si dhe janë ekzekutuar nga autoritet e huaja vetëm 5 kërkesa;

Kërkesa për njohje vendimesh penale të huaja rezulton të kenë qenë 2 ku nga gjykata është njohur vendimi i dënimit të dhënë nga autoritetet e huaja në 1 raste.

Nuk ka patur raste që nga prokurorët e kësaj prokurorie të jetë kërkuar njohja e vendimit penal të dhënë nga autoriteti gjyqësor shqiptar.

Gjithashtu bashkëpunimi me autoritet e huaja është shfaqur edhe në drejtim të transferimit të procedimeve penale prej tyre dhe të rregjistruara në prokurorinë tonë si dhe shpalljeve në kërkim ndërkombëtar.

VI. Të dhëna për ngarkesën e punës për çdo prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore

Gjatë vitit 2021, treguesit e përgjithshëm të volumit dhe cilesisë së punës së kryer nga prokurorët, duke përfshirë edhe çështjet e mbartura nga vitet e kaluara, paraqiten si më poshtë :

Prokurore	Mosfillim	Pezullim	Pushim	Kërkesë për pushim	Kërkesë për Gjykim	Transferuar	Bashkuar	Hetim dhe Vlerësim	Total
K. Ajazi	2	1	0	3	4	1	0	9	20
G. Habazaj	24	2	0	1	10	1	1	74	113
A.Shehu	3	10	1	5	19	0	0	0	38
E. Kokonozi	69	67	4	8	27	2	0	0	177
A.Ismailukaj	27	14	6	6	16	1	1	41	112
R. Berisha	81	73	4	13	57	1	4	80	313
Z. Lila	84	69	30	54	100	2	4	141	484
E. Bako	11	0	1	8	2	0	0	52	74
A.Berexha	26	61	15	67	24	2	0	77	272
Xh. Seferi	9	30	6	29	35	2	2	88	201
N. Hoxha	0	3	1	1	4	0	0	0	9
B.Mustafaraj	0	2	0	0	2	1	0	0	5
H. Mushi	29	99	3	15	65	0	4	376	591
B.Nina	71	78	8	55	78	2	2	0	294
P. Aliçka	25	4	10	43	56	1	2	79	220
E. Beqiri	7	8	1	8	16	0	6	56	102
P. Asllani	33	50	4	36	66	1	7	94	291
P. Stafa	42	15	6	16	56	1	5	35	176
E. Stafa	47	45	35	23	50	2	4	58	264
R. Suka	0	2	0	9	16	2	6	112	147
M. Turku	19	2	7	13	34	0	4	42	121
E.Tafari	6	2	4	18	19	1	0	0	50

Gjatë vitit 2021, treguesit e përgjithshëm të volumit dhe cilësisë së punës së kryer nga Oficerët e policisë gjyqësore, duke përfshirë edhe çështjet e mbartura nga vitet e kaluara, paraqiten si më poshtë :

OPGJ	Çështje	Pushuar + kërkesë pushim	Pezulluar	Kërkesë për dërgimin në gjykim
Altin Xhetani	81	33	11	37
Armanda Shahini	60	21	3	7
Anila Dusha	10	3	1	2
Juliana Beqiraj	64	23	1	5
Ermal Çela	14	4	0	6
Lorena Musai	64	19	4	14
Erion Karoli	16	0	0	0
Nevrus Ndrejoni	85	37	5	30
Rasim Guzi	99	14	5	47
Petrit Caku	62	14	3	17
Laureta Fusha	141	40	9	63
Xhaferr Muha	60	21	3	7
Fjoralba Memia	108	19	10	31

VII. Informacion mbi administrimin e Prokurorisë

Gjatë vitit 2021 personeli administrativ i kësaj prokurorie i ka kryer me korrektesë detyrat përkatëse, duke qënë një mbështetje e rëndësishme për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në përballimin e ngarkesës në punë dhe krijimin e raporteve korrekte me qytetarët, të cilëve u ofrohen shërbime administrative nga ana e Prokurorisë. Gjatë vitit 2021, buxheti financiar i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor është administruar me rigorozitet dhe si pasoje e disiplinës financiare dhe ndihmës gjithëvjetore nga Prokuroria e Përgjithshme për zëra të veçantë të tij, nga ana e kësaj Prokurorie janë likuaduar pothuajse të gjitha detyrimet ndaj subjekteve të tjerë, ato për shpenzimet procedurale, të pageses së mbikohës së punes etj. Megjithate, vlerësoj se ky buxhet duhet të rishikohet në të ardhmen për shtimin e tij në zëra të veçante për një mbarëvajtje më të mirë të punës, duke u nisur nga fakti që nga viti në vit shtohet ngarkesa e punës dhe për rrjedhojë dhe nevojat financiare. Në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë vlerësoj se marrëdhëniet me median dhe publikun kanë qënë korrekte. Nga ana e Prokurorisë është shprehur gatishmëria për të dhënë informacion subjekteve të interesuar në çdo rast që është gjykuar se nuk çënohet hetimi dhe veprimet procedurale përkatëse. Në respektim edhe të normave Kushtetuese është respektuar e drejta për informim e subjekteve të ndryshme. Në rast të refuzimit të kërkesave për informacione lidhur me çështje konkrete, ato janë argumentuar bazuar në normat procedurale penale mbi ruajtjen e sekretit hetimor. Lidhur me administrimin e dokumentacionit të Prokurorisë, konstatoj se jo vetëm regjistrat, por i gjithë dokumentacioni që administrohet në Prokurori mbahet dhe ruhet rregullisht. Lidhur me mbajtjen e regjistrave, në Prokurori ushtron veprimtarinë punonjësi i ngarkuar posaçërisht me detyrën e mbajtjes së tyre dhe deri më tani nuk konstatohen problematika. Gjithashtu ky punojës meret me përdorimin dhe hedhjen e materialeve në sistemin CAMS dhe nuk janë konstatuar problematika. Përgjatë vitit 2021, vlerësoj se kapacitetet infrastrukturore kanë qënë të mjaftueshme me qëllim realizimin e aktivitetit të Prokurorisë. Megjithatë, kjo çështje meriton një vëmendje të veçantë në varësi edhe të organikës së Prokurorisë apo nevojave për të kryer detyra të caktuara. Sa i përket sigurisë, kjo realizohet nëpërmjet shërbimeve private të ruajtjes fizike, për të cilat çdo vit organizohet procedura përkatëse e prokurimit në përputhje me ligjin për prokurimin publik. Nuk rezulton të ketë pasur problematika lidhur me sigurinë, megjithatë, ashtu siç jam shprehur edhe në raporte të viteve paraardhëse, nisur nga natyra e veprimtarisë së Prokurorisë, vlerësoj se do të ishte e përshtatshme që siguria të garantohej nga shërbimet e policisë të Drejtorisë së Policisë. Përgjatë vitit 2021 vlerësoj se është respektuar disiplina në punë dhe etika nga prokurorët, oficerët dhe punonjësit e administratës.

➤ Raporti financiar

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan gjatë vitit 2021 për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike-financiare janë çelur fondet si më poshtë:

Fondi 2021	Plan	Fakt	Realizimi
-------------------	-------------	-------------	------------------

Fondi i Pagave 600	118,042,000	117,297,925	99.36 %
Fondi i sigurimeve Shoq.Shëndt.	12,190,000	12,140,884	99.60 %
Fondi i shpenzimeve korrente	15,260,000	15,258,746	100 %
Fondi transferta korrente te brendshme	1,026,880	1,055,386	99,29 %
Fondi investimeve	0	0	0 %

Fondi i pagave ka një diferencë prej 744,078 lekë ose është realizuar në masën 99,36 %, kjo për shkak të largimit të disa prokurorëve nga procesi i vetingut dhe mosrealizimit të orëve të gadishmërisë nga të gjithë prokurorët.

Totali i pagesës së orëve të gadishmërisë për prokurorët është në shumën **9,032,362** lekë dhe totali i pagesës të mbikohës të punës për prokurorët është **620,480** lekë. (Vendimit Nr.191 datë 13.05.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ku totali i orëve të gadishmërisë dhe orëve jashtë kohës së punës është 200 orë).

Llogaritja e fondit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore është bërë sipas ligjeve në fuqi, ku sigurimin shoqëror llogaritet 9.5% mbi pagën maksimale në Republikën e Shqipërisë e cila është 132,312 lekë, kurse sigurimi shëndetsor dhe kontributi suplementar llogariten mbi pagën bruto.

Lidhur me realizimin e fondit të shpenzimeve korrente realizimi është 100%.

MATERIALE ZYRE DHE TË PËRGJITHSHME janë në shumën 737,752 lekë, ku përfshihen shpenzimet për kancelari, materiale pastrimi, dizifektimi, materiale të përgjithshme për funksionimin e zyrave, ku peshën më të madhe e zenë shpenzimet për kancelari në masën 57.2% të totalit. Në zërin materiale për funksionimin e pajiseve të zyrës. U bë përmirësimi i kushteve të tualeteve duke i pajisur me pajisje sanitare si mbajtëse për letër higjienike, për duart, për solucionin larës dhe kosha të ndryshëm për kushte sa me të mira higjienike.

SHËRBIME NGA TË TRETË janë në shumën 2,651,829 lekë, ku përfshihen shpenzimet për energji elektrike, ujë, shërbime telefonike, shërbime postare, shtypshkrime, etj. peshën më të madhe e zenë shpenzimet për energji elektrike në masën 60.2% të totalit.

SHPENZIME TRANSPORTI janë në shumën 293,693 lekë, ku përfshihen shpenzimet për karburant dhe vaj, pjesë këmbimi, goma dhe bateri, shpenzime për siguracionet e makinave dhe shpenzime të tjera transporti.

Prokuroria Elbasan ka në pronësi dy automjete, HYUNDAI me targë AA806NK dhe MAZDA me targë AA881IV, të cilave u janë bërë shërbimet periodike për ti mbajtur në gadishmëri.

SHPENZIME PËR MIRËMBAJTJE TË ZAKONSHME janë në shumën 577,044 lekë, ku përfshihen shpenzimet për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore, mirëmbajtjen e elektrike, të pajisjeve elektronike, shpenzimet për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit. Peshën më të madhe të shpenzimeve të këtij grupi e zenë shpenzimet për riparimin e pajisjeve elektrike, si fotokopje, printera për ti mbajtur në gadishmëri për një funksionim sa më normal të punës në sekretari.

SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE janë në shumën 10,998,430 lekë, ku përfshihen shpenzimet për honorare, shpenzime për taksat e institucioneve, shpenzime të tjera materiale dhe shërbime operative. Këto shpenzime zenë peshën më të madhe të shpenzimeve operative, në masën 71%.

Peshën më të madhë e ze zëri “Shpenzime honorare”, në shumën 10,846,250 lekë, ku përfshin pagesat e avokatëve, ekspertëve, psikologë, përkthyes,etj, në masën 66.2% të fondit total, si më poshtë:

-Akte eksperimentimi mjeko-ligjor	lekë	2,124,000
-Avokatë	lekë	1,019,600
-Përkthyes	lekë	173,610
-Ekspertë të ndryshëm	lekë	6,788,840
-Shpenzime Publike kadastrale	lekë	740,200

Në fund të vitit gjendja e fatura të palikuiduara për këtë zë është si më poshtë:

-Akte eksperimentimi mjeko-ligjor	lekë	310,500
-Avokatë	lekë	324,600
-Përkthyes	lekë	29,720
-Ekspertë të ndryshëm	lekë	1,477,000
-Shpenzime Publike kadastrale	lekë	0,00

Realizimi i fondeve është në masën 99,5 %.

Gjatë vitit 2021 nuk është çelur fond për investime me gjithë kërkesat e institucionit tonë për investime.

Nga ana e Prokurorisë të Përgjithshme u bë furnizimi me kamera të brendshme dhe të jashtme për të rritur sigurinë e ambienteve të prokurorisë, sepse ruajtja e ambienteve të jashtme bëhet nga Gjykata. Me donacionin e Bankës Credins u bë e mundur blerja e pajisjeve të tjera dhe u realizua vendosja e kamareve të brendshme dhe të jashtme.

Në projekt buxhet janë kërkuar nga ana e jonë janë kërkuar fonde për investime si më poshtë:

-Sistemi i ngrohjes dhe ftohjes (chiller)	lekë	4,000,000
-Hidroizolimi i tarracës	lekë	1,500,000
-Rrethim me kangjella	lekë	650,000
-Pajisje zyre	lekë	650,000

Janë kërkuar edhe pajisje elektronike si kompjutera, printera, skanera etj.

Gjatë vitit 2021 nga ana e prokurorisë së Përgjithshme janë ushtruar dy audite të brendshëm: -auditi i brendshëm i cili kontrolloi veprimtarinë ekonomiko-financiare gjatë viteve 2017-dhjetor 2020.

Gjatë kontrollit u lanë nëntë rekomandime të cilat u plotësuan dhe u zbatuan gjatë vitit 2021.

Rekomandimi Nr.1

Lidhur me lënien e gjurmëve të auditimit për të gjitha proceset e veprimtarisë që zhvillohen në prokurori, nga ana e jonë janë hartuar gjurmët “Gjurmët e auditimit për prokurimet me vlerë mbi 800,000 lekë pa tvsh”, “Gjurmët e auditimit për prokurimet me vlerë nën 800,000 lekë pa tvsh”, dhe “Gjurmët e auditimit për pagat e personelit”, të cilat janë miratuar nga Drejtuesi i Prokurorisë. Në vazhdimësi do të punohet për hartimin e gjurmëve të tjera të auditimit sipas veprimtarive që zhvillohen në Prokurorinë Elbasan. *(Bashkëlidhur gjurmët e auditimit të mësipërme).*

Rekomandimi Nr.2

Në vitin 2021 nuk është parashikuar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike dhe nuk do të zhvillohet procedura e prokurimit të programit për mirëmbajtjen e sistemit informatik kontabël.

Rekomandimi Nr.3

Lidhur këtë rekomandim nga ana e shefes të financës u hartua një informacioni me Nr.1490 datë 09.04.2021 duke argumentuar mosarkëtimin e këtyre gjobave për gjashtë debitorë në vlerën 310,000 (treqind e dhjetëmijë) lekë.

Me shkresën Nr.3288 datë 12.04.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë, i është kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm vlerësimi i parashkrimit të masave administrative. *(Bashkëlidhur shkresa Nr.3288.Prot. datë 12.04.2021).*

Rekomandimi Nr.4

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë u urdhërua komisioni i përcaktimit të normave limit të konsumit të karburantit për vitin 2021, (Urdhër Nr.4 datë 06.01.2021) të rishikohet edhe njëherë norma e konsumit të karburantit për dy automjetet që disponon prokuroria. Në autorizimin i cili firmosej nga kancelarja për lëvizjen e mjetit të transportit dhe punonjësit të prokurorisë, do të plotësohet sipas rekomandimit të auditit duke përcakuar edhe alysen e lëvisjes. Fleta e udhëtimit do të firmoset nga punonjsi udhëtues.

Rekomandimi Nr.5

Lidhur me pagesat për paaftësi të përkohshme në punë deri në 14 ditë të cilat paguhen nga institucioni i prokurorisë, nga viti 2017 deri 2020, u bë përlllogaritja këtyre raporteve mbi pagën

bruto vetëm për prokurorët, kurse për punonjësit e administratës raporti i paaftësisë ishte llogaritur mbi pagën bruto. *(Bashkëlidhur Urdhëri Nr.37 datë 15.04.2021.)*

Rekomandimi Nr.6

Me shkresën Nr.2911 datë 30.03.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë “Parashtim kërkesash dhe nevojash për strukturën organike të prokurorisë sipas rekomandimeve të auditit”, konkretisht për specialistin e arkivës dhe teknik mirëmbajtës, i jemi drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm për të reflektuar në përmirësimin e strukturës organike

(Bashkëlidhur shkresa Nr.2911 datë 30.03.2021)

Rekomandimi Nr.7

Lidhur me sistemin e ngrohje-ftohje i cili nuk funksionon nga ana e jonë janë bërë të gjitha përpjekjet për rregullimin e tij, por ka qënë e pamundur. Gjithashtu është informuar dhe Prokuroria e Përgjithshme lidhur me këtë shqetësim.

Me shkresën Nr.2912 datë 30.03.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë “Parashtrim mbi sistemin e ngrohje-ftohjes në prokurori”, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm janë pasqyruar të gjitha problematikat dhe përpjekjet tona për rregullimin e tij.

(Bashkëlidhur shkresa Nr.2912 datë 30.03.2021).

Rekomandimi Nr.8

Lidhur me këtë rekomandim nga ana e jonë në mënyrë të vazhdueshme me anë të shkresave si dhe në projekt buxhet është kërkuar shtesa organike për një punonjës mirëmbajtje.

Me shkresën Nr.2911 datë 30.03.2021, të Drejtuesit të prokurorisë, “Parashtrim kërkesash dhe nevojash për strukturën organike të prokurorisë sipas rekomandimeve të auditit”, i është kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm shtesë organike për këtë pozicion pune.

(Bashkëlidhur shkresa Nr.2911 datë 30.03.2021)

Rekomandimi Nr.9

Lidhur me këtë rekomandim nga ana e jonë do të kihet parasysh që drejtuesi i prokurorisë nuk do të jetë anëtar i komisionit të emërimeve dhe pranimit të punësimeve. Pranimi në shërbimin civil do të bëhet sipas një udhëzimi të brendshëm të hartuar në përputhje me procedurat ligjore. Lidhur me këtë rekomandim të auditit i është kërkuar mendim Prokurorit të Përgjithshëm, me shresën Nr.2941.Prot datë 31.03.2021, të Drejtuesit të Prokurorisë.

Rekomandimi Nr.10

Lidhur me këtë rekomandim nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë u ngrit komisioni për vlerësimin e automjetit MAZDA, me urdhër Nr.33 datë 08.04.2021.

Bashkëlidhur akt-vlerësimi i automjetit MAZDA, datë 15.04.2021.

Nisur nga këto rekomandime u përmirësua puna gjatë vitit 2021 dhe në vazhdim.

Auditimi i dytë ka të bëjë me kontrollin e shpenzimeve procedurale, ose me pagesat për avokatë, ekspertë, psikologë, përkthyes etj.

Kontrolli u bë i intërsishëm duke kontrolluar çdo pagesë të bërë nga ana e prokurorëve, në zbatim të Udhëzimit të Prokurorit të përgjithshëm Nr.8 datë 19.05.2020.

Gjatë kontrollit u sugjerua nga ana e jonë lidhur me pagesat e ekspertve, sidomos ekspetrëve kontabël dhe eksperimentime komplekse, pagesa e të cilëve e kalon shumën 40,000 lekë e vendosur si kufiri maksimal i pagesës të shpërblimit.

Nisur nga ky fakt në Udhëzimin e Prokurorit të përgjithshëm Nr.8 datë 19.05.2020, i ndryshuar, u vendos që për ekspertimet komplekse, kur shume kalon 40,000 lekë të merret miratimi i Sekretarit të Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme.

Gjatë vitit 2021 janë krijuar këto të ardhura:

-nga tarifat e taksave të pullave 95,360 lekë

-nga shpenzimet procedurale 100,840 lekë

Të ardhurat e krijuara janë derdhur në buxhetin e shtetit.

Prokuroria ka në total 57 punonjës dhe 1(një) punonjës me kontratë (sanitar)

Nga këto:

1	drejtues prokurorie
1	zv/drejtes
25	prokurorë
13	oficerë të policisë gjyqësore
1	kancelar
1	kryesekretar
1	shef finance
9	sekretare pranë prokurorit
1	specialist IT
1	koordinator
2	shoferë
1	ftues
1	portjer
1	sanitare

➤ Organizimi dhe Funksonimi i Prokurorisë

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë Elbasan janë marrë masa për një organizim dhe funksionim sa më eficient dhe për këtë qëllim me urdhërin Nr.8, datë 21.01.2021 është miratuar **“Rregullorjas për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”** në përputhje dhe në bazë të Urdhërit nr.164 datë 18.12.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm **“Për miratimin e rregulloreve standart të organizimit dhe funksionimit të të Prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apeleve të juridiksionit të përgjithshëm”**.

➤ Informacion mbi Regjistrat

Në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, lidhur me regjistrat fizik / elektronik, librat dhe sistemet të cilët janë në përdorim nga institucioni rezulton në total janë **69** regjistra në përdorim nga të cilët **48** janë fizikisht dhe **21** regjistra elektronikisht.

Me Urdhërin e Drejtuesit të Prokurorisë Nr.14, datë 25.02.2021 **“Për organizimin e brendshëm administrativ të punës në prokurori”** është krijuar Zyra e Regjistratit.

Në funksion të kësaj pike përmendim nxjerrjen e urdhërave:

Nr.11, datë 15.02.2021 Për krijimin e “Regjistratit të njoftimeve të viktimeve akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elementë të veprës penale” dhe “Regjistratit të çështjeve të tjera” në mbështetje të Udhëzimit e Përgjithshëm nr.15 datë 30.10.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm **“Për trajtimin e njoftimeve të viktimeve akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë element të veprës penale”**;

Nr.59, datë 12.07.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë “Për regjistrimin dhe qarkullimin e materialeve të para hetimore ose kallëzimeve penale në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”,

Gjithashtu është vendosur dhe mbajtja e Regjistratit Sekret me Urdhër Nr.116, datë 08.11.2021 **“Për një ndryshim në Urdhërin Nr. 25, datë 30.03.2020 “Mbi mënyrën e administrimit të regjistratit dhe të materialeve të klasifikuara “Sekret shtetëror” dhe në Urdhërin Nr.47, datë 23.09.2020 “Mbi shpërndarjen e bazës materiale”**.

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë marrë masa për të ushtruar kontroll në mbajtjen e e regjistrave dhe për këtë qëllim është nxjerr Urdhër Nr.101, datë 11.10.2021 **“Për kontrollin e regjistrave dhe librave në prokurori”** bazuar në urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm **“Për mbajtjen e regjistrave”**.

Nga kontrolli rezulton se regjistrat janë si më poshtë vijon:

➤ Alketa Kurmaku – Kancelare

1. Regjistër “Sekrete Hetimore” – *Fizikisht*

2. Regjistër i Përgjimeve – *Fizikisht*
3. Regjistër Kërkesa – Përgjigje – *Fizikisht*

➤ Lindita Shopi - Kryetare e degës Buxhet – Financë

1. Libri i pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor - *Fizikisht*
2. Libri i magazines - *Fizikisht*
3. Librat e arkës të pullave dhe shpenzimeve procedurale - *Fizikisht*
4. Regjistër i pagesave për avokatët dhe ekspertët – *Elektronikisht*
5. Regjistër i shpenzimeve procedurale – *Elektronikisht*

➤ **Zyra e Protokollit**

- Elida Kasa - Kryesekretare

1. Protokollit i hyrjeve dhe daljeve të materialeve hetimore - *Fizikisht*
2. Protokollit i hyrjeve dhe daljeve të shkresave dhe vendimeve të ndryshme - *Fizikisht*
3. Protokollit i dosjeve që shkojnë në gjykatë: kërkesë për pushim, kërkesë për gjykim - *Fizikisht*
4. Libër i dorëzimit të shkresave dhe materialeve me firmë - *Fizikisht*
5. Regjistër i korespondencës së Informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” - *Fizikisht*
6. Libër i dorëzimit të Informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” - *Fizikisht*
7. Regjistri i shumfishimit të dokumentave të klasifikuar “Sekret Shtetëror” - *Fizikisht*
8. Libri i qarkullimit të brëndshëm të klasifikuar “Sekret Shtetëror” - *Fizikisht*
9. Regjistri i regjistrave të Informacionit “Sekret Shtetëror” – *Fizikisht*

- Xhoana Koçi

1. Regjistër për dosje të deleguara, pezulluara, për hetim, për kompetencë, parashkrime - *Fizikisht*
2. Regjistër i Komunikimit të Vendimeve - *Fizikisht*
3. Regjistër i Hetimit Pasuror - *Fizikisht*
4. Regjistër për Vendimet e Gjykatës - *Fizikisht*
5. Regjistër për shpërndarjen e materialeve – *Fizikisht*

➤ **Zyra e Regjistrimit**

- Zamira Zykollari

1. Regjistrat e procedimeve penale nga viti 2015 e në vazhdim (çregjistrimi i dosjeve, materialeve procedurale) – *Fizikisht*
2. Regjistrat e procedimeve penale nga viti 2015 e në vazhdim (çregjistrimi i dosjeve, materialeve procedurale - *Elektronikisht*
3. Regjistri i të miturve – *Fizikisht*
4. Regjistri i Hetimeve Pasurore – *Fizikisht*

5. Regjistri i Hetimeve Pasurore – *Elektronikisht*
6. Regjistri i Procedimeve Pasurore – *Fizikisht*
7. Regjistri i Procedimeve Pasurore - *Elektronikisht*
8. Regjistri i Njoftimeve të Viktimeve Abuzuese Nr. 59 – *Fizikisht*

- Fjoralba Salla

1. Regjistri i njoftimit/ kallëzimit të veprave penale, mosfillimit dhe Arrestet – *Fizikisht*
2. Regjistri i njoftimit/ kallëzimit të veprave penale, mosfillimit dhe Arrestet - *Elektronikisht*
3. Regjistri i procedimeve Penale (për vitin 2022) – *Fizikisht*
4. Regjistri i procedimeve Penale (për vitin 2022) - *Elektronikisht*
5. Libër i Komunikimeve të Brëndshme – *Fizikisht*

- Rozalina Terziu

1. Regjistri i shpërndarjes së postës – *Fizikisht*
2. Regjistri i njoftimeve të Gjykatës – *Fizikisht*
3. Regjistri i Ekzekutimeve – *Fizikisht*
4. Regjistri i Ekzekutimeve - *Elektronikisht*
5. Regjistri për Letërporositë – *Fizikisht*
6. Regjistri për Ekstradimet – *Fizikisht*
7. Regjistri për Gjykime të tjera – *Fizikisht*
8. Regjistër për Njohje Ekzekutim i Vendimeve Penale – *Fizikisht*
9. Regjistër për Njohje Ekzekutim i Vendimeve Penale - *Elektronikisht*
10. Regjistri i Urdhërave të Kërkimit Ndërkombëtar – *Fizikisht*
11. Regjistri i Urdhërave të Kërkimit Ndërkombëtar – *Elektronikisht*

➤ Etleva Ballkoçi – Sekretare pranë Drejtuesit

1. Regjistri i Qarkullimit të Brëndshëm të Korespondencës Procedurale - *Fizikisht*
2. Regjistër i Shpërndarjes së Akteve të Drejtuesit - *Fizikisht*
3. Regjistër “Protokoll i Brëndshëm i Drejtuesit” – “Urdhëra – Udhëzime” - *Fizikisht*
4. Protokoll i mbledhjeve - *Fizikisht*

➤ Anita Hoxha – Zyra Arshivës

1. Regjistër i provave material – *Fizikisht*
2. Regjistër i shpërndarjes së vërtetimeve – *Fizikisht*
3. Regjistër i provave materiale – *Elektronikisht*
4. Regjistër i arkivimit të praktikave të ekzekutimeve – *Elektronikisht*
5. Regjistër i dosjeve të arkivës nga viti 2002 deri në vitin 2015 - *Elektronikisht*
6. Regjistër i dosjeve të vjetra nga viti 1990 deri në vitin 2001 - *Elektronikisht*
7. Regjistër i dosjeve të Librazhdit - *Elektronikisht*
8. Regjistër i parashkrimeve - *Elektronikisht*

9. Regjistër i dosjeve nga viti 2016 e në vazhdim - *Elektronikisht*

➤ Dionis Durbaku - Specialist IT

1. Evidencë inventarizimi të pajisjeve elektronike si: skaner, fotokopje, kompjutera, printera, etj. – *Elektronikisht*
2. Regjistër lidhur me telefonatat hyrëse në Telefonin VOIP zyra e informacionit si numër kontakti për popullin në Prokurorinë Elbasan – *Fizikisht*

➤ Armida Halili - Koordinatorë për Subjektte me Status të Posaçëm

1. Database me të dhëna për rastet e të miturve, dhunës në familje etj – *Elektronikisht*

➤ Zhaneta Pashaj – Sekretare pranë Prokurorit

1. Regjistër lidhur me marrjen dhe dorëzimin e materialeve (dosjeve penale të përfunduara për lidhje dhe sistemim) materialeve kallëzuese, arresteve – *Fizikisht*

➤ Pamela Hoxha - Sekretare pranë Prokurorit

1. Regjistër lidhur me marrjen dhe dorëzimin e materialeve (dosjeve penale të përfunduara për lidhje dhe sistemim) materialeve kallëzuese, arresteve – *Fizikisht*

➤ Klajva Xheka - Sekretare pranë Prokurorit

1. Regjistër lidhur me marrjen dhe dorëzimin e materialeve (dosjeve penale të përfunduara për lidhje dhe sistemim) materialeve kallëzuese, arresteve – *Fizikisht*

➤ Migena Feimi – Arkiviste

1. Regjistër i dosjeve të Gramshit nga viti 1997 – 2007 - *Elektronikisht*

➤ Armand Canaku – Ftuesi

1. Regjistër poste – *Fizikisht*

➤ Nosi Prendi

1. Regjistër Hyrje – dalje e qytetarëve – *Fizikisht*

➤ **Sistemet që menaxhohen:**

1. Sistemi CAMS – Alketa Kurmaku, Fjoralba Salla, Zamira Zykollari
2. Sistemi Presto – Alketa Kurmaku
3. Sistemi i Drejtësisë Penale për të Mitur – Armida Halili

➤ **Sistemet me të drejtë akses:**

1. TIMS – Prokurorë dhe Oficerë të Policisë Gjyqësore
2. ASHK – Prokurorë dhe Oficerë të Policisë Gjyqësore, Dionis Durbaku
3. E – Albania – Prokurorë dhe Oficerë të Policisë Gjyqësore
4. Sistemi i Certifikatave të Gjendjes Gjyqësore – Prokurorë dhe Oficerë të Policisë Gjyqësore

➤ Inspektime të krvera nga institucione në prokurori

1. Kontrolli i veprimtarisë së policisë gjyqësore.

Ky kontroll ka filluar me urdhërin nr.61, datë 02.06.2021 të Prokurorit të Përgjithshëm për kontrollin e veprimtarisë së policisë gjyqësore në seksionin e policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Grupi i kontrollit është paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan në muajin qershor 2021. Nga ana jonë, i është dorëzuar grupit të kontrollit, ngarkesa në punë e cdo oficeri të policisë gjyqësore të seksionit, ngarkesë kjo e nxjerrë nga dy burime : (1) të dhënat e Zyrës së Regjistrimit dhe (2) vetë oficerët. Po ashtu, i janë krijuar grupit të kontrollit facilitetet infrastrukturore për ushtrimin e detyrave të tyre.

Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan janë transportuar dhe dorëzuar për inspektim pranë Grupit të Kontrollit në Prokurorinë e Përgjithshme, dosjet e oficerëve me shkresat si vijon :

1. Me shkresën nr.5982, dt.21.06.2021.
2. Me shkresën nr.5983, dt.21.06.2021.
3. Me shkresën nr.5984, dt.21.06.2021.
4. Me shkresën nr.6968, dt.22.07.2021.
5. Me shkresën nr.6969, dt.22.07.2021.
6. Me shkresën nr.7860, dt.09.09.2021.
7. Me shkresën nr.7861, dt.09.09.2021.
8. Me shkresën nr.7862, dt.09.09.2021.
9. Me shkresën nr.8103, dt.16.09.2021.
10. Me shkresën nr.8564, dt.30.09.2021.
11. Me shkresën nr.9023, dt.11.10.2021.
12. Me shkresën nr.10137, dt.09.11.2021.
13. Me shkresën nr.10200, dt.10.11.2021.
14. Me shkresën nr.10876, dt.03.12.2021.

15. Me shkresën nr.11157, dt.10.12.2021.

Fashikujt e çështjeve penale të cilët ndodheshin të administruar në arshivën e prokurorisë i janë dërguar të gjitha dhe për të gjithë oficerët, grupit të kontrollit në Prokurorinë e Përgjithshme Tiranë sipas grafikut të punës të ndërtuar prej tyre.

Fashikujt e tjerë, të cilët rezultojnë në ngarkesën e oficerëve dhe për të cilat oficerët kishin përgatitur relacionet përfundimtare, por që administrohen/administroheshin fizikisht nga prokurorët, janë dorëzuar dhe do të dorëzohen pranë grupit të kontrollit në dinamikë, sa herë që dorëzohen nga prokurorët për arshivim pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

Nga ana jonë është vepruar në mënyrë të tillë që janë mbledhur disa fashikuj bashkë dhe janë dërguar njëherazi pranë Prokurorisë së Përgjithshme pasi e kemi pasur të pamundur të sjellim cdo fashikull të vecantë në Tiranë, për arsye se : (1) sjell kosto shtesë dhe harxhim karburanti tej mundësive tona dhe (2) në cdo rast punonjësit e prokurorisë që transportojnë fashikujt shoqërohen edhe nga një punonjës i policisë së shtetit për arsye sigurie sepse disa fashikuj që dorëzohem janë ekzemplar unik në origjinal.

I gjithë procesi i transportit dhe dorëzimit, si dhe i ri-martjes së fashikujve nga Prokuroria e Përgjithshme, është kryer me mjetet, bazën materiale dhe burimet njerëzore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, në zbatim të detyrimeve ligjore.

Ky proces kontrolli nuk është përmbyllur gjatë vitit 2021 dhe vijon në vitin pasues.

2.Inspektimi tematik nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.12 datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm”.

Ky inspektim ka filluar me vendimin nr.37, datë 01.06.2021 Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për inspektimin “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.12 datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Elbasan.

Në përgjigje të shkresës së ILD me nr.2808 prot., dt.16.06.2021 ku janë kërkuar të dhëna në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.12 datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe në zbatim të vendimit nr.37 dt.01.06.2021 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm me objekt : “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm Nr.12 datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve me prokurorëve dhe Drejtuesve të Prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar”, përsa i përket periudhës kohore 01.10.2020-31.03.2021 kemi informuar ILD më shkresën tonë nr.5925 prot., dt.18.06.2021, duke dërguar informacionin dhe aktet e kërkuara nga ILD.

Me shkresën nr.35 prot., dt.06.01.2021 me lëndë “Dërgim informacioni në lidhje me praktikën tuaj nr.1914 prot., dt.30.12.2020 “Kërkesë për informacion”, drejtuar Drejtorisë së Koordinimit

Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme është dërguar informacioni i kërkuar midis të tjerash në lidhje me masat e marra për zbatimin e Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr.12 datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarsisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, nga Drejtuesi i Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Nuk kemi ndonjë njoftim për rezultatet e këtij inspektimi.

3.Inspektim nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar në Prokurorinë e Përgjithshme dhe strukturat në varësi të saj mbi zbatimin e ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror” (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Ky inspektim ka filluar me kërkesë të DSIK për kontrollin në Prokurorinë e Përgjithshme dhe strukturat në varësi të saj mbi zbatimin e ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror” (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Grupi i inspektimit është paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan në muajin tetor 2021.

Në përfundim të këtij inspektimi DSIK ka përcjellë më datë 24.11.2021 Raportin e Inspektimit. Në këtë raport janë dhënë rekomandime të përgjithshme për t’u ndjekur dhe plotësuar në vijim nga Prokuroria e Përgjithshme dhe prokuroritë e inspektuara. Rekomandimet e këtij raporti janë përcjellë me shkresën dt.06.12.2021 të Prokurorit të Përgjithshëm. Në përputhje me diskutimet e bëra gjatë inspektimit në prokurori të grupit të kontrollit, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë urdhëri nr.116, datë 08.11.2021 “Për një ndryshim në Urdhërin Nr. 25, datë 30.03.2020 “Mbi mënyrën e administrimit të regjistrit dhe të materialeve të klasifikuara “Sekret shtetëror” dhe në Urdhërin Nr.47, datë 23.09.2020 “Mbi shpërndarjen e bazës materiale”.

4.Inspektim financiar (audit i brendshëm) nga Prokuroria e Përgjithshme me objekt mbi kontrollin e shpenzimeve procedurale, ose me pagesat për avokatë, ekspertë, psikologë, përkthyes etj.

Ky audit është kërkuar nga Prokuroria e Përgjithshme (Njesia e Auditimit të Brendshëm).

Grupi i kontrollit u paraqit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Kontrolli u bë i imtësishëm duke kontrolluar çdo pagesë të bërë nga ana e prokurorëve, në zbatim të Udhëzimit të Prokurorit të përgjithshëm Nr.8 datë 19.05.2020. Gjatë kontrollit është sugjeruar nga ana jonë, lidhur me pagesat e ekspertve, sidomos kontabël, pagesa e të cilëve e kalon shumën 40,000 lekë, e vendosur si kufiri maksimal i pagesës të shpërblimit.

Nisur nga ky fakt në Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm Nr.8 datë 19.05.2020, i ndryshuar, u vendos që për ekspertimet komplekse, kur shuma kalon 40,000 lekë të merret miratimi i Sekretarit të Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme.

Nuk na është njoftuar asnjë raport lidhur me këtë audit.

5. Inspektim financiar (audit i brendshëm) nga Prokuroria e Përgjithshme me objekt mbi kontrollin e menaxhimit financiar për periudhën 01.01.2017 deri më datë 31.10.2020.

Ky audit është kërkuar nga Prokuroria e Përgjithshme (Njesia e Auditimit të Brendshëm).

Grupi i kontrollit u paraqit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, disa herë gjatë periudhës së auditimit.

Në lidhje me këtë audit është sjellë Raporti mbi auditimin e kombinuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan me nr.1781/4 prot., dt.26.03.2021 si dhe shkresa nr.1781/4 ex.20 prot., dt.26.03.2021.

Në tërësi ky raport jep rekomandime për disa rregullime që duhet të plotësohen prej Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Në vijim të këtij raporti, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë, është nxjerrë urdhëri nr.37, dt.15.04.2021 mbi përlllogaritjen e paaftësisë së përkohshme në punë për punonjësit si dhe urdhëri nr.33, datë 08.04.2021 për ngritjen e komisionit të vlerësimit të automjetit, si dhe janë dërguar shkrësat përkatëse pranë Prokurorit të Përgjithshëm me nr.2911 prot., dt.30.03.2021, nr.2912 prot., dt.30.03.2021, nr.2941 prot., dt.31.03.2021, nr.3288 prot., dt.12.04.2021. Për këto kërkesa tonat, në zbatim të rekomandimeve të auditit, nuk kemi marrë përgjatë vitit 2021 asnjë përgjigje nga Prokuroria e Përgjithshme.

Për të gjitha kontrollet dhe inspektime e mësipërme, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, janë respektuar të gjitha detyrimet ligjore për krijimin e kushteve të nevojshme infrastrukturore për kryerjen e inspektimeve, për vendosjen në dispozicion të bazës materiale dhe njerëzore të prokurorisë sonë, me qëllim lehtësimin e kryerjes së tyre.

➤ Kërkesa drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme :

Përgjatë vitit 2021 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka parashtruar një numër të konsiderueshëm kërkesash pranë Prokurorisë së Përgjithshme, në funksion të mirëadministrimit të prokurorisë dhe mbarëvajtjes së punës në këtë organ.

1. Kërkesa që lidhen me sigurinë në institucion ;

Me shkresën nr.379 prot., datë 15.01.2021 dhe nr.2910 prot., dt.30.03.2021 janë kërkuar disa rregullime dhe investime për çështje të sigurisë në institucion dhe konkretisht të shikohet mundësia e planifikimit të investimeve për rritjen e sigurisë së jashtme dhe brendshme fizike të godinës së prokurorisë (*sipas projekteve dhe preventivave të depozituara nga ana jonë dhe kërkesave për investime në buxhet*) si dhe një rregullim të ri përsa i takon mënyrës së ruajtjes dhe kontrollit të qëndrueshëm fizik të institucionit.

1. Është e nevojshme vendosja e kamerave të sigurisë për mbulimin e pjesës së jashtme të godinës së institucionit pasi kjo pjesë është tërësisht e pa mbuluar me kamera sigurie (mesatarisht do të ishin të nevojshme 4 kamera). Bëjmë me dije se godina e prokurorisë ka

dy hyrje dhe një sipërfaqe parkimi në pjesën anësore si dhe një hyrje në pjesën e pasme të godinës, ku këto ambiente janë të pa mbuluara me kamera.

2. Janë të nevojshme mesatarisht 9 kamera për të mbuluar ambientet e brendshme të godinës dhe konkretisht në garazhin nëntokë (hyrjen e ashensorit, derën e magazinës së kancelarive dhe dhomës së arkivës qëndrore), tre katet e shkallëve nga hyrja e pasme (emergjencës), tre katet e zyrave të prokurorëve dhe kati i parë i zyrave të sekretarisë.
3. Është i nevojshëm sigurimi me kangjella i të gjitha dritareve dhe derës së oborrit të pasëm që i përkasin katit të parë të institucionit, si dhe sigurimi me dyer xhami të blinduar për derën kryesore dhe atë anësore të katit të parë të institucionit.
4. Është i nevojshëm përmirësimi i rrethimit të jashtëm anësor të prokurorisë me një sistemim të kangjellave dhe përforcim të sigurisë së tyre, më konkretisht duke vendosur një brez të sigurtë dhe të lartë metalik mbi mur.
5. Është i nevojshëm vendosja e një pajisje elektronike që siguron dhe komandon derën që lidh institucionin tonë me gjykatën.
6. Është e nevojshme në mënyrë urgjente të procedohet me ndryshimin e situatës kontraktore për garantimin e sigurisë fizike në institucion duke siguruar ruajtje 24 orë me SHRSF pasi sigurimi aktual me SHRSF të kontraktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan është jo eficient për institucionin tonë dhe nuk jep asnjë element sigurie fizike. Propozojmë që organi i prokurorisë të ketë një sigurim të posaçëm me SHRSF.

Gjatë vitit 2021 nuk ka gjetur zgjidhje asnjë prej këtyre çështjeve të shtruara nga ana jonë, me përjashtim të një kalimi kapital nga Prokuroria e Përgjithshme për në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan të 13 copë kamerave të jashtme dhe të brendshme të sigurisë (në gjendje të përdorur), ku pajisjet e tjera shtesë për funksionimin e tyre (si HDD, NVR, patch pannel etj), me vlerë 840 euro, janë siguruar si rrjedhojë e një donacioni nga Banka Credins (dokumentuar në kontratën e lidhur për këtë qëllim). Po ashtu, nga Prokuroria e Përgjithshme është sjellë më kalim kapital edhe një kondicioner 12 btu.

2.Kërkesa që lidhen me pagesat e ekspertëve, përcjellë me shkresën nr.392 prot., datë 18.01.2021 ;

Në punën e përditshme të prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, përsa i përket kryerjes së ekspertimeve të llojeve të ndryshme, konstatohet se janë hasur disa problematika, të cilat janë bërë në disa raste edhe pengesë për hetimin në kohë të çështjeve penale.

Konstatohet se zbatimi i Udhëzimit të Përgjithshëm Nr.8 dt.19.05.2020 “Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” është shumë i vështirë për arsye të faktit se hasen pengesa në gjetjen e ekspertëve dhe në dakortësisë me ta për shkak të pagesës që përcakton ky udhëzim. Konkretisht duke ju referuar Udhëzimit nr.4 datë 12.12.2012 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor” i ndryshuar, ku përcaktohet se dhe pagesa maksimale e ekspertëve nuk mund të jetë më shumë se 40.000 lekë, në këtë vlerë dhe masë shpërblimi është

shumë e vështirë gjetja e ekspertëve që marrin përsipër detyrën për ekspertime kryesisht komplekse.

Kështu, në lidhje me veprën penale të “Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë penale” të parashikuar nga neni 287 të K.Penal apo hetimeve pasurore në kuadër të zbatimit të ligjit Nr. 10192, datë 03/12/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, nga ekspertët nuk merren përsipër kryerja e akteve të ekspertimit për shkak të volumit të madh të akteve mbi bazën e të cilave do të kryhen ekspertimet e ndryshme, duke nxjerrë pengesë masën e pagesës për ekspertimet që do të kryhen (konsiderohet shumë e ulët në raport me punën që duhet të kryhet në kuadër të ekspertimit).

Kur nga ekspertët është marrë përsipër kryerja e ekspertimeve të ndryshme dhe vlera e kërkuar nga ekspertët për pagesaën e punës së tyre ishte mjaft e lartë, nga drejtuesit e prokurorisë ndër vite është urdhëruar edhe pagesa e këtyre ekspertëve në një masë më të ulët se sa ajo e kërkuar prej tyre apo vlera e përcaktuar në marrëveshjet përkatëse me prokurorët e çështjeve, por për një pjesë të rasteve nga vetë ekspertët është kërkuar në Gjykatë vlera e plotë e pagesës për ekspertimet e kryera, duke u paditur në këtë rast Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Kemi bërë të ditur se kemi qënë të paditur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës nga eksperti kontabël Luan Muça, i cili ka kryer një ekspertim në lidhje me procedimin penal nr.674 të vitit 2015, ku gjatë hetimit me marrëveshjen e dt.27.02.2019 të arritur ndërmjet ekspertit dhe prokurorit të çështjes ishte rënë dakort që eksperti të paguhej në masën 540.000 lekë së bashku me TVSH-në. Pas përfundimit të aktit të ekspertimit nga eksperti është hartuar fatura nr.38 dt.19.06.2019 për kryerjen e pagesës prej 540.000 lekë. Nga ish-Drejtuesja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është urdhëruar pagimi i këtij eksperti në vlerën e 96.000. Nga eksperti Luan Muça është kërkuar me padi në Gjykatë jo vetëm pagimi i plotë i faturës prej 540000 lekë, por edhe dëmi i shkaktuar, interesa bankare, për shkak të vonesave në likuidim, si dëmi moral në vlerën e 500000 lekëve.

Gjithashtu problematikë e lindur është edhe fakti se për çështje penale komplekse nga prokurorët është urdhëruar kryerja e ekspertimeve të ndryshme dhe vlera e pagesës së kërkuar nga ekspertët që kanë hartuar aktet e ekspertimit është shumë e lartë. Konkretisht me vendimin dt.16.11.2020 prokurori i çështjes B.Mustafaraj ka vendosur të shpërblejë ekspertin (proc.1859/2016) në masën 885.600 lekë dhe me vendimin 15.07.2020 prokurorja e çështjes ka urdhëruar shpërblimin e dy ekspertëve në masën 240.000 lekë secili (proc.895/1, viti 2019). Në këto rrethana duke qënë se vlera e shpërblimit e urdhëruar nga prokurori i çështjes është shumë herë më e lartë se vlera e përcaktuar në Udhëzimin nr.8/2020 fillimisht nuk ka filluar procedura e likuidimit të këtyre ekspertëve.

Në këto rrethana parashtrojmë këto situata problematike, duke kërkuar njëkohësisht edhe vlerësimin e mundësisë së rishikimit të kuadrit aktual ligjor dhe nënligjor për sa i takon pagesës së ekspertëve në mënyrë që të lehtësohen veprimet hetimore në këtë drejtim.

Në lidhje me këtë kërkesë nuk kemi marrë përgjigje apo zgjidhje gjatë vitit 2021.

3.Kërkesa që lidhen me çështje të administrimit dhe funksionimit financiar të prokurorisë, përcjellë me shkresën nr.11631 prot., datë 23.12.2021 ;

Kemi parashtruar disa situata dhe kërkesa që kanë të bëjnë me mënyrën e menaxhimit financiar të prokurorisë, ku në vlerësimin tonë është e nevojshme ndërhyrja e Prokurorit të Përgjithshëm me udhëzim të përgjithshëm normues në funksion të mirëadministrimit të institucionit dhe përcaktimit të rregullave të qarta mbi veprimtarinë financiare.

Nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, me shkresën nr.256/2 prot., datë 10.02.2021 është caktuar Kancelari i Prokurorisë në funksionin e nëpunësit autorizues të nivelit të dytë dhe për rrjedhojë në Degën e Thesarit, në të cilën kalojnë likuidimet financiare që lidhen me veprimtarinë e prokurorisë, njihet Kancelari si subjekt që autorizon veprimtarinë financiare të prokurorisë.

Me shkresën nr.3715/1 prot., dt.16.03.2021 Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka konfirmuar nëpunës autorizues të nivelit të dytë kancelarët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Korçë, me argumentin se prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë janë institucione në varësi direkte të Prokurorisë së Përgjithshme.

Në kushtet kur, nga njëra anë ligji përcakton Drejtuesin e Prokurorisë si person përgjegjës për mbarëvajtjen e punës dhe garantimin e funksioneve administrative në prokurori, ku përfshihet edhe administrimi financiar dhe material i institucionit dhe nga ana tjetër, kancelari i prokurorisë përcaktohet të kryejë funksionin e nëpunësit autorizues të nivelit të dytë, veprimtari të cilën e kryen nën autoritetin e Drejtuesit të Prokurorisë, kemi kërkuar ndërhyrjen normuese të Prokurorit të Përgjithshëm me udhëzim të përgjithshëm, ku natyrisht kemi parashtruar edhe çështjet konkrete që duhet të zgjidhen.

Në lidhje me këtë kërkesë nuk kemi marrë përgjigje apo zgjidhje gjatë vitit 2021.

4.Kërkesa që lidhen me nevojën për të ndërhyrë në udhëzimet e përgjithshme nr.2 dhe nr.3 të vitit 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm, përcjellë me shkresat nr.11622 prot., datë 23.12.2021, nr.5569 prot., dt.14.06.2021 dhe nr.5096 prot., dt.01.06.2021;

Në punën tonë të përditshme në lidhje me zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm me nr.2 datë 29.12.2016 “Për organizimin dhe koordinimin e punës në prokurori”, nr.3, datë 29.12.2021 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori” dhe nr.12 datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” të ndryshuar, janë hasur disa problematika të cilat nuk gjejnë zgjidhje të qartë në këto akte normative të Prokurorit të Përgjithshëm (të cilat janë parashtruar detajisht në shkresën e sipërcituar), apo në ligjet përkatëse që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e organit të prokurorisë ku konkretisht:

Sistemi CAMS i menaxhimit të çështjeve të prokurorisë nuk e parashikon dhe nuk e mundëson hedhjen në short elektronik të çështjeve/kërkesave të ndryshme nga materialet hetimore penale (kallëzime/referime/procedime penale). Në këtë kuptim, edhe ndarja e çështjeve të ndryshme nga materialet penale, nuk është e mundur t’i nënshtrohet shortimit elektronik për shkak të këtij sistemi elektronik (softëare) me të cilin ne operojmë. Udhëzimet e përgjithshme nr.2/2016 dhe nr.3/2016

të Prokurorit të Përgjithshëm nuk parashikojnë asnjë normë rregulluese mbi mënyrën apo procedurën e shpërndarjes së çështjeve të ndryshme nga materialet hetimore penale. Ekzistojnë praktika të ndryshme në prokurori të ndryshme të juridiksionit të përgjithshëm për situatat e sipërcituara.

Në lidhje me këtë kërkesë nuk kemi marrë përgjigje apo zgjidhje gjatë vitit 2021.

5.Kërkesa që lidhen me funksionimin e sistemit të kondicionimit në prokurori.

Në lidhje me problematikën për pajisjen e sistemit të kondicionimit ngrohje-ftohje (chiller) bëjmë me dije :

Godina e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është marrë në dorëzim në dhjetor të vitit 2017.

Në fillim të muajve të verës të vitit 2020 në sistemin e ftohjes janë konstatuar disa problematika që kanë pasur të bëjnë me mosfunksionimin e aparaturës Chiller të instaluar nga subjekti ndërtues (nënkontraktor). Kjo pajisje ka shfaqur problematika funksionuese edhe më parë por për shkak të masave kundër pandemisë dhe bllokimit të lëvizjes nuk kanë qënë të konstatuara.

Pas disa komunikimeve të vazhdueshme me këtë subjekt (edhe komunikime shkresore) nga ana e tij, pa asnjë detyrim financiar, është sjellë një grup pune që ka konstatuar pajisjen dhe ka evidentuar probleme në të.

Në vijim, me afrimin e periudhës së dimrit (rreth muajit nëntor 2020), ka rezultuar se pajisja Chiller nuk ka funksionuar fare përse i takon procesit të ngrohjes në institucion. Nga disa verifikime dhe të dhëna paraprake të marra nga specialistë të fushës ka rezultuar se pajisja në fjalë kishte dalë nga funksionimi.

Në vijim të komunikimeve të vazhdueshme mes nesh dhe institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme është dërguar një grup specialistësh për verifikim në vend dhe ka rezultuar e njëjta problematikë.

Në muajin dhjetor 2020, Drejtuesi i Prokurorisë, në mungesë të një specialisti të brendshëm mirëmbajtje në këtë institucion ka kërkuar nga Bashkia Elbasan, vendosjen në dispozicion të një grupi ekspertësh të jashtëm, pa kundërshpërbllim monetar, për të kryer një verifikim profesional të pajisjes dhe dhënien e një mendimi teknik mbi të.

Nga mendimi i përpiluar me shkrim prej këtyre specialistëve të jashtëm, me profesion inxhinierë, depozituar 13.01.2021 kanë rezultuar në mënyrë të përmbledhur këto të dhëna:

1. Pajisja ka dalë jashtë funksionit.
2. Sugjerohet vendosja e një pajisje të re.
3. Kapaciteti i pajisjes aktuale (kË) nuk i përgjigjet kapacitetit si në ftohje ashtu edhe në ngrohje të pajisjes së parashikuar në projekt dhe preventiv (nuk janë inkorporuar elementët e preventivit).
4. Është ndryshuar zëri i preventivit nga chiller për ftohje dhe kaldajë për ngrohje në chiller për ngrohje-ftohje.
5. Kapacitetet (kË) e pajisjes nuk i përgjigjen kapacitetit të nevojshëm për ngrohje-ftohje që kërkon godina në tërësi.

Në këto rrethana, me shkresën nr.381 prot., dt.15.01.2021 drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm kemi parashtruar kërkesën si vijon :

Është e nevojshme dhe urgjente të merren masa për një kontroll nga ana e PP të situatës së pajisjes aktuale të ftohje-ngrohjes në prokurori për të verifikuar dhe vlerësuar pajisjen aktuale pasi mendojmë se është e nevojshme që të kryhet një investim me objekt vendosje të një pajisje të re në institucion me kapacitetet e nevojshme të projektuara (*mendimi i specialistëve të jashtëm të marrë nga ana jonë është që pajisja aktuale nuk ka mundësi riparimi megjithatë për të arritur në një konkluzion të tillë kërkojmë edhe mendimin e një grupi verifikimi me specialistë të caktuar prej PP*).

Sipas specialistëve tanë nëse do të instalohet një pajisje e re, e cila mund të ketë peshë deri në 2 ton, për kapacitetin që kërkon godina për ftohje-ngrohje, është e nevojshme të merret mendimi i projektuesit pasi pajisja është programuar të vendoset në taracën e godinës dhe është e tillë që për shkak të procesit të punës jo vetëm që ka peshë por krijon edhe vibrime.

Në vijim të shkresës nr.381 prot., dt.15.01.2021 ku janë përshkruar disa problematika në lidhje me funksionimin e pajisjes së ftohje-ngrohjes (kondicionimit) në godinën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, kemi parashtruar me shkresën nr.429 prot., dt.18.01.2021 drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm situatën si vijon :

Konkluzionet e specialistëve të jashtëm të caktuar nga ana jonë dhe të parashtruara në shkresën e sipërcituar cojnë në përfundimin se pajisja aktuale ka nevojë të zëvendësohet me një pajisje të re. Kryesor në këtë konkluzion është fakti se pajisja aktuale e instaluar nga subjekti ndërtues në kuadër të ndërtimit të godinës së re të Prokurorisë Elbasan nuk i përgjigjet kapacitetit të parashikuar në projekt dhe preventiv.

Në këto rrethana, kemi shprehur mendimin se në rastin konkret ekzistojnë kushtet që e gjithë kjo problematikë të verifikohet në kuadër të një çështje penale.

Ndodhur në rrethanat kur Prokuroria Elbasan ka qënë pjesë e procedurave projektimit, prokurimit, ndërtimit, marrjes në dorëzim dhe përfutuese e investimit por edhe palë e dëmtuar (*nëse hetimi provon konkluzionet e specialistëve të jashtëm*), me qëllim për të qënë objektiv, korrekt në zbatimin e ligjit si dhe për të respektuar standartet e një procesi të rregullt ligjor, Drejtuesi i Prokurorisë ka dërguar informacionin si më sipër me qëllim që nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme të përcaktohet një prokurori kompetente për fillimin e një hetimi penal për problematikën e hasur në këtë pajisje duke filluar nga procedurat e investimit, supervizimit, kolaudimit dhe deri në verifikimin e gjendjes aktuale të pajisjes së instaluar për të verifikuar faktin nëse kjo pajisje i përgjigjet apo jo parametrave të projektuara, prokuruar, supervizuara dhe kolauduara.

Me shkresën nr.93/2 prot., dt.03.02.2021 Prokuroria e Përgjithshme ka bërë me dije se praktika jonë e sipërcituar i ka kaluar për vlerësime dhe veprime të mëtejshme Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Me shkresën nr.2286 prot., dt.11.03.2021 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka depozituar në cilësinë e viktimës nga vepra penale një padi civile në procesin penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë duke kërkuar : “Legjitimimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan si paditës civil në procesin penal që është duke u zhvilluar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe detyrimin e paleve të

paditura të zëvendësojnë me shpenzimet e veta dëmin e shkaktuar si pasojë e mosrespektimit të kushteve të Kontratës nr.18469, datë.19.11.2015, në objektin e ndërtuar prej tyre”.

Rezulton të jetë ngritur nga Drejtuesi i Prokurorisë një komision i posaçëm me specialistë të fushës të cilët kanë përcaktuar difektin dhe arsyet e mosfunksionimit të pajisjes. Në lidhje me gjetjen e personave përgjegjës, kjo çështje është objekt i një hetimi penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe i përket këtij organi të nxjerrë personat përgjegjës (nëse do të ketë vend për përgjegjësi të cdo lloji). Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është viktimë nga vepra penale në këtë proces, që ka iniciuar procesin dhe është në pritje të rezultateve të hetimit penal si përsa i takon shkakut të mosfunksionimit, arsyes së difektit, ashtu edhe përsa i takon personave përgjegjës.

Me shkresën nr.2912 prot., dt.30.03.2021 i kemi parashtruar Prokurorisë së Përgjithshme të gjithë situatën si më sipër (edhe në zbatim të raport-auditit të kombinuar).

E gjithë praktika jonë është bazuar në shkresat :

1. Shkresa nr.381 prot., dt.15.01.2021 Prokuroria Rrethit Elbasan, drejtuar PP.
2. Shkresa nr.429 prot., dt.18.01.2021 Prokuroria Rrethit Elbasan, drejtuar PP.
3. Shkresa nr.93/2 prot., dt.03.02.2021 Prokuroria e Përgjithshme.
4. Disa mendime teknike rreth sistemit të kondicionimit nr.361 prot., dt.13.01.2021.
5. Shkresa nr.2286 prot., dt.11.03.2021 Prokuroria Rrethit Elbasan dhe padia civile në procesin penal, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
6. Shkresa nr.9223 prot., dt.25.09.2020 Prokuroria Rrethit Elbasan, drejtuar shoqërive ndërtuese, supervizuese dhe kolauduese.
7. Shkresa nr.12177 prot., dt.15.12.2020 Prokuroria Rrethit Elbasan, drejtuar Bashkisë Elbasan.
8. Shkresa nr.2912 prot., dt.30.03.2021 Prokuroria Rrethit Elbasan, drejtuar PP.
9. Shkresa nr.9342/1, datë 14.07.2021 e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe bashkëlidhur akti i ekspertimit teknik dt.30.06.2021.

Në lidhje me këtë kërkesë nuk kemi marrë përgjigje apo zgjidhje gjatë vitit 2021.

6.Kërkesa që lidhen me rekomandimet e raport-auditit të kombinuar.

Në vijim dhe përmbushje të rekomandimeve të lëna në Raportin e Auditimit të Kombinuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan me nr.1781/4 prot., dt.26.03.2021 të Njesisë së Auditit të Brendshëm të Prokurorisë së Përgjithshme dhe shkresës nr.1781/4/ex20 prot., dt.26.03.2021 të Prokurorit të Përgjithshëm, kemi parashtruar si vijon :

6.1 Për strukturën organike me shkresën nr.2911 prot., dt.30.03.2021 :

1. Është e nevojshme përcaktimi në strukturën administrative një pozicion pune “specialist i arkivimit” me qëllim administrimin e arkivës së prokurorisë. Aktualisht ky sektor mbulohet

nga një “sekretare”. Nevojat për administrimin e arkivës sipas kritereve ligjore, parashikimi i rregullores së brendshme të “Shërbimit të arkivimit në prokurori” dhe nisur nga volumi shumë i madh i punës në këtë sektor, propozojmë që të shtohet në organikë një pozicion pune administrative “specialist i arkivimit” dhe në pamundësi për të shtuar organikën me këtë specialist të bëhet një ndryshim i strukturës organike të pozicionit të punës nga sekretare në specialist arkive.

2. Është e nevojshme përcaktimi në strukturën administrative një pozicion pune “teknik mirëmbajtës” me qëllim administrimin dhe përkujdesjen për mirëmbajtjen e infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme të godinës së prokurorisë dhe pajisjeve, të tilla si punime apo riparime të përdtishme elektrike, hidraulike, ndërtimi etj. Aktualisht ky sektor është pa mbulim. Nevojat për mirëmbajtjen e zakonshme të godinës janë të mëdhaja për shkak se ky institucion ndodhet në një godinë prej 4 katesh dhe më një numër të konsiderueshëm punonjësish. Për këtë arsye propozojmë që të shtohet në organikë një pozicion pune administrative “teknik mirëmbajtës”.

Jemi të mendimit që nuk mund të operohet me detyra shtesë për punonjësit aktual të prokurorisë që kanë njohuri profesionale për mirëmbajtjen e godinës dhe pajisjeve, sepse së pari në strukturën aktuale nuk ka asnjë punonjës të kualifikuar ose certifikuar profesionalisht për punë mirëmbajtje godine dhe pajisjesh dhe së dyti për arsye të nevojës për të garantuar jetën dhe shëndetin e punonjësve, tekniku i mirëmbajtjes duhet të ketë njohuri mbi rregullat e sigurisë teknike në punë. Punonjësve aktual të shërbimeve mbështetëse nuk mund t’i caktohen detyrat e teknikut të mirëmbajtjes pasi puna me rrjetin elektrik, hidraulik, punë në ndërtim etj, krijojnë premisa për dëmtim të shëndetit dhe jetës dhe kjo është një përgjegjësi që nuk mund ta marrë Drejtuesi i Prokurorisë si punëdhënës. Në këto rrethana, shtimi i organikës me pozicionin teknik mirëmbajtje është shumë emergjent dhe kërkon ndërhyrjen tuaj të menjëhershme. Me shkresën tonë nr.380 prot., dt.15.01.2021 janë parashtruar edhe më parë nevojat për shtesa në organikë sipas përcaktimeve të sipërcituara.

Në lidhje me këtë kërkesë nuk kemi marrë përgjigje apo zgjidhje gjatë vitit 2021.

6.2 Për disa gjoba administrative të pavjelura, me shkresën nr.3288 prot., dt.12.04.2021:

Kryetarja e Degës së Buxhet/Financës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka depozituar pranë Drejtuesit të Prokurorisë informacionin me nr.1490, datë 09.04.2021.

Nga ky informacion por edhe nga vështrimi i akteve të administruara nga ana jonë rezultojnë këto të dhëna :

Rezulton të mbartura në bilancin e prokurorisë prej vitit 2003 disa gjoba administrative të pavjelura, ku persona ndaj të cilëve janë marrë këto masa janë punonjës dhe ish-punonjës të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me funksione të ndryshme.

Në raportin përfundimtar të kontrollit “Mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare në Prokurorinë Elbasan” për vitin 2002 si dhe për prokurime të kryera në vitet 2000, 2001, 2002 të kryer nga Sektori i Auditimit në PP, kanë rezultuar mangësi dhe shkelje dhe si pasojë janë marrë këto masa administrative, gjoha për punonjësit e prokurorisë, për shkelje të Ligjit nr.7971, datë 26.07.1995 për “Për Prokurimin Publik” si më poshtë ;

Durim Bedini	50.000 lekë,
Pranvera Stafa	50.000 lekë,
Agim Bengu	50.000 lekë,
Illirjan Gërdani	50.000 lekë,
Pandi Tërpini	50.0000 lekë,
Dritan Gripshi	50.000 lekë,
Binas Nina	50.000 lekë,
Petref Asllani	5.000 lekë,
Illirjan Gërdani	5.000 lekë,
Luan Kaloçi	50.000 lekë,
Alket Mersini	50.000 lekë,
Dhurata Tafani	55.000 lekë,
Zamira Zykollari	5.000 lekë,

Lidhur me zbatimin e kësaj detyre të lënë nga kontrolli, është nxjerrë urdhëri nr. 1633, datë 09.09.2004 i Drejtuesit të Prokurorisë, për arkëtimin e gjobave të personave të sipërcituar.

Referuar dokumentacionit, rezulton se janë arkëtuar gjobat nga personat;

Durim Bedini	50.000 lekë,
Pranvera Stafa	50.000 lekë,
Dritan Gripshi	50.000 lekë,
Binas Nina	50.000 lekë,
Petref Asllani	5.000 lekë,
Zamira Zykollari	5.000 lekë

Punonjësi Xhemil Fejza me detyrë shofer është ngarkuar të shpërblejë dëmin në shumën 200.000 lekë nga mosdorëzimi i mjetit tip “Benz” me targë El 0439 A.

Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është shqyrtuar kërkesëpadia me objekt “Shpërblim dëmi në shumën 200.000 leke”, me palë paditëse prokuroria Elbasan dhe të paditur punonjësi Xhemil Fejza. Me vendimin nr 575 datë 05.04.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është pranuar pjesërisht kërkesëpadia dhe është vendosur “detyrimi i të paditurit Xhemil Fejza, për të dëmshpërblyer Prokurorinë Elbasan në shumën 33.930 lekë”. Ky detyrim është arkëtuar plotësisht nga ky punonjës.

Nuk janë arkëtuar detyrimet për këto punonjës;

1. Agim Bengu 50.000 leke,

2. Ilirjan Gërdani 55.000 lekë,
3. Pandi Tërpini 50.000 leke,
4. Dhurata Tafani 55.000 leke (dërguar shkresa nr 847 datë 16.05.2006 Prokurorisë për Krimet e Rënda Tiane), për arkëtim.
5. Luan Kaloci 50.000 lekë (dërguar shkresa nr 845 datë 16.05.2006 Prokurorisë së Apelit Tiranë), për arkëtim.
6. Alket Mersini 50.000 lekë (dërguar shkresa nr 846 datë 16.05.2006, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës), për arkëtim.

Lidhur me arkëtimin e gjobave për punonjesit e administratës (Agim Bengu, Pandi Terpini, Ilirjan Gërdani) i është kërkuar Sekretarit të Përgjithshëm nga ish Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Elbasan, me shkresën nr.1044 prot., datë 06.06.2006, një mundësi për anulimin e këtyre gjobave. Po ashtu dhe në shkresën nr 133 datë 19.01.2007 është vënë në dijeni dhe auditi pranë prokurorisë së Përgjithshme për një mundësi rishikimi.

Theksojmë se masat e mësipërme administrative janë marrë nga ish Prokurori i Përgjithshëm Z.Theodhori Sollaku, dërguar me shkresën nr.890 prot., dt.07.04.2003.

Baza ligjore e marrjes së masës administrative të gjobës ka qënë neni 46 i ligjit nr.7971, dt.26.07.1995 dhe neni 72 i ligjit nr.7661, dt.19.02.1996 si dhe ligji nr.6942, dt.25.12.1984 dhe Udhëzimi nr.3/1996 (të ndryshuara).

Rezultoni se aktualisht ligjet e sipërcituara janë shfuqizuar dhe konkretisht :

Ligji nr.7971/1995 është shfuqizuar me ligjin nr.9643/2006. Fushën e veprimit të ligjit nr.7661/1996 e mbulon ligji aktual nr.25/2008.

Referuar ligjeve nr.7971/1995 dhe 7661/1996 rezultoni se për çështjet e masave administrative të marra referonte në ligjin nr.7697/1993 “Për kundërvajtjet administrative”. Neni 23 i këtij ligji parashikonte si afat parashkrimi 1 vit nga data e dhënies së masës administrative të gjobës.

Rezultoni se ligji nr.7697/1993 është shfuqizuar dhe aktualisht është në fuqi ligji nr.10279/2010.

Neni 46 i këtij ligji parashikon se :

“Me përjashtim të rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe, dënimi administrativ, i nxjerrë nga organi i administratës publike, i cili nuk ekzekutohet me kalimin e dy viteve nga data e nxjerrjes së vendimit për kundërvajtjen administrative, parashkruhet. Në këtë rast, organi administrativ, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative, me vendim konstaton parashkrimin. Në vendimin, ku konstatohet parashkrimi i dënimit administrativ, listohen edhe arsyet që kanë çuar në këtë përfundim”.

Në informacionin drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë, Kryetarja e Degës së Buxhet/Financës ka bërë me dije se :

- Për debitorët e larguar nga institucioni ynë, gjobat janë përcjellë në institucionet brenda sistemit të prokurorisë në të cilat kanë shkuar në punë këta persona.
- Për debitorët e tjerë nuk është proceduar me vjeljen e detyrimit pasi ata kanë qënë punonjës të administratës me pagë të ulët dhe me probleme financiaro-ekonomike familjare.
- Sugjerohet të aplikohet mundësia ligjore e parashkrimit të masave administrative.

Në këtë situatë jemi të mendimit që :

1. Prokurori i Përgjithshëm duhet të vlerësojë parashkrimin e masave administrative. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, organi që ka nxjerrë urdhërin e masës administrative duhet të konstatojë parashkrimin e saj. Masa administrative është marrë nga ish Prokurori i Përgjithshëm dhe për këtë arsye parashkrimi duhet të konstatohet, në përputhje me ligjin, nga Prokurori i Përgjithshëm ose nëpunësi i autorizuar prej tij.

Në lidhje me këtë kërkesë nuk kemi marrë përgjigje apo zgjidhje gjatë vitit 2021.

6.3 Për çështjen e punësimit të punonjësve administrativ, me shkresën nr.2941 prot., dt.31.03.2021 :

Në mungesë të akteve normative të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm për rregullimin e procedurave përkatëse, në lidhje me rekomandimin në Raportin e Auditimit, me qëllim nxjerrjen nga Drejtuesi i Prokurorisë të udhëzimit të brendshëm sipas rekomandimit të grupit të kontrollit dhe në funksion të shmangies së një udhëzimi potencialisht të cënueshëm në aspektin e ligjshmërisë, kemi kërkuar që Prokurori i Përgjithshëm të përcaktojë norma të qarta për disa çështje ende të pazgjidhura me akte nënligjore dhe që kanë të bëjnë me përcaktimin e punonjësve administrativ të prokurorisë që përfshihen brenda kuadrit të shërbimit civil si dhe të rregullave të qarta mbi rekrutimin, transferimin, lëvizjet paralele, largimin nga detyra etj, të punonjësve administrativ të prokurorisë.

Në lidhje me këtë kërkesë nuk kemi marrë përgjigje apo zgjidhje gjatë vitit 2021.

7.Projekte/preventive/kërkesa për investim.

Me shkresën nr.2636 prot., dt.24.03.2021 – preventiv për investim në hidroizolim.

Me shkresën nr.1791 prot., dt.24.02.2021 – studim për investim në sistemin e kondicionimit të prokurorisë.

Me shkresën nr.11781 prot., dt.30.12.2021 – relacion teknik mbi investim në strukturën mbajtëse të taracës.

Me shkresën nr.11813 prot., dt.31.12.2021 – relacion teknik mbi strukturën mbajtëse të taracës.

Në lidhje me këto kërkesa nuk kemi marrë investim gjatë vitit 2021.

➤ Kërkesa të tjera

• Kërkesa për fillim procedimi disiplinor :

Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, është vënë në dijeni me shkrim nga disa oficerë të policisë gjyqësore dhe prokurorë të kësaj prokurorie mbi disa problematika të konstatuar gjatë ndjekjes dhe hetimit të çështjeve të ndryshme penale të hetuara më parë nga

prokurore **A.Xh.** Kështu, disa prokurorë dhe oficerë kanë raportuar me shkrim problematikat e hasura në çështje penale në hetim pas lënies së tyre nga prokurore A.Xh, të cilës me **vendimin nr.188 datë 30.07.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i ishte miratuar leje e papaguar.**

Kjo prokurore ka dorëzuar një numër të konsiderueshem çështjes penale në hetim dhe gjykim. Ky numër i madh çështjesh të dorëzuara nuk justifikohet me ngarkesën e përgjithshme të kësaj prokurore dhe numrin e çështjeve të përfunduara prej saj në shtatë muajt e parë të vitit 2020, gjatë të cilave ajo ka përfunduar një numër të vogël çështjesh, gjithsej 17 (shtatëmbëdhjetë), ndërsa për 3 (tre) çështje është shpallur moskompetenca. Më konkretisht sipas të dhënave të raportuara nga Kancelarja e Prokurorisë :7 (shtatë) çështje janë dërguar në Gjykatë me kërkesë për dërgimin në gjyq; 4 (katër) çështje janë dërguar në Gjykatë me kërkesë për pushim; 1 (një) çështje me vendim për pushim; 5 (pesë) çështje janë pezulluar.

Hetimi i çështjeve penale të dorëzuara nga prokurore A.Xh ka vazhduar nga prokurorë të tjerë, sipas procedurës së shortimit dhe zëvendësimit të prokurorit.

Referuar informacioneve verbale dhe të shkruara të prokurorëve apo oficerëve të policisë gjyqësore, në një sërë çështjesh penale të dorëzuara nga prokurore A.Xh, janë vërejtur problematika të ndryshme, që kryesisht konsistojnë në zvarritje të hetimeve dhe mungesë të kontrollit nga ana e prokurores, megjithëse faktet e hetuara në to nuk paraqesin ndonjë kompleksitet të veçantë për të justifikuar zgjatjen e hetimeve nga 2 (dy) vjet e më tepër. Shumë çështje penale janë dorëzuar nga prokurorja me hetime të përfunduara, në fazat e fundit të çështjeve penale dhe nga ana e saj nuk është ndërmarrë asnjë veprim për përfundimin e tyre.

Me shkresën nr.2106 prot., dt.04.03.2021 Drejtuesi i Prokurorisë i ka përcjellë informacionet e administruara pranë Prokurorisë së Përgjithshme, e cila sipas njoftimeve të hapura këtë rast e ka përcjellë për inspektim disiplinor pranë ILD, në zbatim të ligjeve nr.96/2016 dhe 97/2016.

Me shkresën nr.11188 prot., dt.13.12.2021, Drejtuesi i Prokurorisë në mbështetje të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Policisë Gjyqësore, miratuar me vendimin nr.11/1, dt.01.11.2019 të Komisionit të Policisë Gjyqësore si dhe në Rregulloren nr.10, datë 21.04.2019 për procedimin disiplinor të oficerëve të policisë gjyqësore, i ka kërkuar Komisionit të Policisë Gjyqësore fillimin e procedimit disiplinor oficerit të policisë gjyqësore **Y.Z.**, për shkelje të rënda dhe të përsëritura në ushtrimin e funksioneve të oficerit të policisë gjyqësore me qëllim dhënien e masës disiplinore sipas ligjit për shkelje të kryera në detyrë.

Me shkresën nr.1800 prot., dt.30.12.2021, Drejtuesi i Prokurorisë në mbështetje të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Policisë Gjyqësore, miratuar me vendimin nr.11/1, dt.01.11.2019 të Komisionit të Policisë Gjyqësore si dhe në Rregulloren nr.10, datë 21.04.2019 për procedimin disiplinor të oficerëve të policisë gjyqësore, i ka kërkuar Komisionit të Policisë Gjyqësore fillimin e procedimit disiplinor oficerit të policisë gjyqësore

O.M, për shkelje të rënda dhe të përsëritura në ushtrimin e funksioneve të oficerit të policisë gjyqësore me qëllim dhënien e masës disiplinore sipas ligjit për shkelje të kryera në detyrë.

- **Mbrojtja fizike e prokurorëve :**

Gjatë vitit 2021 me vendimet përkatëse të Komisionit të Mbrojtjes së Prokurorëve pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka vijuar mbrojtja fizike e filluar gjatë vitit 2020 për një prokuror, si dhe është caktuar mbrojtja fizike e një prokurori tjetër. Mbrojtja e prokurorëve është caktuar nga ky komision në zbatim të detyrimeve ligjore, në përputhje me informacionet e administruara nga agjensitë ligjzbatuese dhe thelbësisht për shkaqe që lidhen vetëm me detyrën.

- **Propozimet për shpërblim :**

Gjatë vitit 2021 Drejtuesi i Prokurorisë ka parashtruar pranë Prokurorit të Përgjithshëm propozimet për shpërblime financiare për merita profesionale për 3 oficerë të policisë gjyqësore të SPTMSHI pranë Prokurorisë së Përgjithshme (shkresa nr.938 prot., dt.02.02.2021) si dhe për dy prokurorë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan (shkresat nr.8675 prot., dt.01.10.2021 dhe nr.11144 prot., dt.10.12.2021). Nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm me urdhërin nr.107, datë 06.10.2021 është akorduar shpërblim financiar për një prokurorë.

Drejtuesi i Prokurorit me urdhërin nr.119, datë 08.11.2021, në mbështetje të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr.88/2019 "Për buxhetin e vitit 2021", VKM nr.929, datë 17.11.2020 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të vecantë", ndryshuar me VKM nr.493, datë 06.07.2021, pika 7, Kodin e Punës neni 157/2, i ka akorduar një ndihmë financiare familjes së kolegesë së ndjerë, ndihmë financiare për sëmundje të rëndë për dy prokurorë dhe një oficer të policisë gjyqësore si dhe një punonjëse të administratës për rast vdekje Brenda familjes (urdhëri nr.20, datë 09.03.2021, urdhëri nr.57, datë 05.07.2021, urdhëri nr.90, datë 21.09.2021, urdhëri nr.113, datë 02.11.2021).

➤ Veprime të tjera të krvera në insitucion

- **Praktika profesionale të kryera në prokurori :**

Gjatë vitit 2021 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan kanë kryer praktikat profesionale 1 kandidate për prokurorë dhe 6 kandidatë për oficerë të policisë gjyqësore.

Me vendimin nr.228, datë 13.07.2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është caktuar për të kryer praktikën profesionale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan si pjesë programit të trajnimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, kandidate për prokurorë **Alisa Spahia**. Prokuror mentor për këtë kandidate magjistrate është caktuar prokurori Arbër Berexha.

Referuar shkresës nr.1506/152/ex20, dt.02.02.2021 të Prokurorit të Përgjithshëm, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, janë caktuar për të kryer praktikën profesionale disa kandidatë për oficerë të policisë gjyqësore.

Me urdhërin nr.9, datë 05.02.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë janë caktuar prokurorëve përgjegjës dhe kryerjen e trajnimit praktik profesional si pjesë e trajnimit fillestar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan të personave të përzgjedhur si oficerë të policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë dhe konkretisht : prokurori Ritvan Suka përgjegjës për trajtimin praktik të **Skerdilajd Qinami**, prokurori Alfred Shehu përgjegjës për trajtimin praktik të **Fatjon Fana**, prokurore Ermira Tafani përgjegjëse për trajtimin praktik të **Oltion Ahmeti** dhe prokurori Arbër Berexha përgjegjës për trajtimin praktik të **Ermal Cela**. Me shkresën nr.6572 prot., dt.09.07.2021 janë përcjellë në Komisionin e Policisë Gjyqësore akt vlerësimet e Drejtuesit të Prokurorisë për kandidatët për opgj Skerdilajd Qinami, Ermal Cela, Fatjon Fana dhe Oltion Ahmeti.

Referuar shkresës nr.1284/162, dt.22.11.2021 të Prokurorit të Përgjithshëm, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, janë caktuar për të kryer praktikën profesionale disa kandidatë për oficerë të policisë gjyqësore.

Me urdhërin nr.123, datë 25.11.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë janë caktuar prokurorëve përgjegjës dhe kryerjen e trajnimit praktik profesional si pjesë e trajnimit fillestar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan të personave të përzgjedhur si oficerë të policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë dhe konkretisht : prokurori Artur Ismailukaj përgjegjës për trajtimin praktik të **Idajet Cela** dhe prokurori Ervin Beqiri përgjegjës për trajtimin praktik të **Armino Visha**.

Për të gjithë praktikantët stazhierë janë krijuar të gjitha lehtësirat e nevojshme në mjete dhe bazë materiale si dhe është siguruar pjesëmarrja e tyre në veprime hetimore/procedurale sipas ligjit.

- **Procesi i rivlerësimit kalimtar të prokurorëve :**

Në zbatim të ligjit nr.84/2016 të gjithë prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan po i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar.

Përgjatë vitit 2021, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka marrë këto vendime për prokurorë të prokurorisë sonë :

2. Me vendimin nr.388, datë 20.05.2021 KPK ka konfirmuar në detyrë prokurorin Alfred Shehu. Vendimi ka marrë formë të prerë më datë 09.07.2021.
3. Me vendimin nr.409, datë 30.06.2021 KPK ka konfirmuar në detyrë prokurorin Kreshnik Ajazi. Vendimi ka marrë formë të prerë më datë 10.09.2021.
4. Me vendimin nr.480, datë 06.12.2021 KPK ka ndërprerë procesin e rivlerësimit për prokuroren Armanda Xhaferri. Vendimi ka marrë formë të prerë më datë 24.12.2021.

5. Me vendimin nr.482, datë 07.12.2021 KPK ka ndërprerë procesin e rivlerësimit për prokuroren Ermira Tafani. Vendimi ka marrë formë të prerë më datë 28.12.2021.
6. Me vendimin nr.489, datë 16.12.2021 KPK ka shkarkuar nga detyra prokurorin Binas Nina. Vendimi nuk ka marrë formë të prerë.

Me urdhërin nr.7, dt.21.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë janë organizuar seksionet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Në këtë urdhër është përcaktuar kompetenca lëndore e çdo seksioni si dhe janë specifikuar prokurorët si dhe oficerët e policies gjyqësore pjesëmarrës në çdo seksion. Po ashtu, janë përcaktuar edhe prokurorët e ngarkuar me detyrën e Drejtuesit të Seksionit.

➤ Organizim i brendshëm

Prokurorët :

Me vendimin nr.55, dt.12.03.2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prokurori **Bledar Mustafaraj** është komanduar me detyrë në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë. Periudha e komandimit do të jetë dy vjet dhe fillon nga data 19.03.2021.

Me vendimin nr.75, dt.29.03.2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prokurori **Neritan Hoxha** është caktuar përkohësisht me detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec. Periudha e caktimit të përkohshëm do të jetë 1 (një) vit dhe fillon nga data 01.04.2021. Po ashtu, me vendimin Nr.76, datë 29.03.2021 prokurori Neritan Hoxha është caktuar përkohësisht me detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec për periudhën 01.04.2021-30.06.2021.

Me vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me nr.139, dt.27.04.2021, prokurori **Artur Ismailukaj** nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë është caktuar në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Ky vendim hyn në fuqi më datë 04.05.2021.

Me vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me nr.149, dt.27.04.2021, prokurori **Gentian Habazaj** nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat është caktuar në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Ky vendim hyn në fuqi më datë 26.05.2021.

Me vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me nr.138, dt.27.04.2021, prokurori **Ervin Beqiri** nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë është caktuar në pozicionin e

prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Ky vendim hyn në fuqi më datë 26.06.2021.

Me vendimin nr.306, dt.23.09.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prokurori **Alfred Shehu** është transferuar përkohësisht me pëlqimin e tij me detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë. Periudha e caktimit të përkohshëm do të jetë 27.09.2021-26.09.2022. Po ashtu, me vendimin nr.307, datë 23.09.2021 prokurori Alfred Shehu është caktuar përkohësisht me detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë për periudhën 27.09.2021-26.12.2021. Me vendimin nr.388, dt.13.12.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prokurori Alfred Shehu është emëruar prokuror në Prokurorinë e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Me vendimin nr.358, dt.16.11.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është vendosur mbarimi i statusit të magjistratit për prokuroren **Ermira Tafani** për shkak dorëheqje. Sipas këtij vendimi, dorëheqja i jep efektet më datë 30.11.2021.

Me vendimin nr.357, dt.16.11.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është vendosur mbarimi i statusit të magjistratit për prokuroren **Armanda Xhaferri** për shkak dorëheqje. Sipas këtij vendimi, dorëheqja i jep efektet më datë 30.11.2021.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr.489, dt.16.12.2021 ka vendosur të shkarkojë prokurorin **Binas Nina** nga detyra e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH.

Më datë 28.10.2021, si pasojë e një sëmundje të rëndë është ndarë nga jeta prokurore **Erida Kokonozi (Lamka)**.

Oficerët e policisë gjyqësore :

Me vendimin nr.21, datë 13.03.2021 të Komisionit të Policisë Gjyqësore rezulton se **Artor Muja** me detyrë oficer i policisë gjyqësore në seksionin e policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është transferuar në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore në seksionin e policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

Me vendimin nr.22, datë 13.03.2021 të Komisionit të Policisë Gjyqësore sipas së cilit rezulton se **Ermal Çela** me detyrë oficer i policisë gjyqësore në seksionin e policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër është transferuar në detyrën e oficerit

të policisë gjyqësore në seksionin e policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Me vendimin nr.29, datë 28.05.2021 të Komisionit të Policisë Gjyqësore rezulton se **Anila Dusha** me detyrë oficer i policisë gjyqësore në seksionin e policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë është transferuar në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore në seksionin e policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Me vendimin nr.35, datë 08.07.2021 të Komisionit të Policisë Gjyqësore rezulton se **Fatmira Vata** me detyrë oficer i policisë gjyqësore në seksionin e policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është transferuar në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore në seksionin e policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

Me vendimin nr.39, datë 30.07.2021 të Komisionit të Policisë Gjyqësore rezulton se **Erion Karoli** me detyrë oficer i policisë gjyqësore në seksionin e policisë gjyqësore në SPAK është caktuar në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore në seksionin e policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Stafi administrativ :

Gjatë vitit 2021 janë punësuar 2 sekretare si rrjedhojë e procedurës së plotë të punësimit në pozicionin administrativ të sekretares pranë prokurorëve. Sekretare **Marie Peci** është larguar me dorëheqjen nga detyra (arsye largimi jashtë vendit) dhe në vend të saj është punësuar sekretare **Klajva Xheka**. Sekretar **Illirjan Gërdani** është larguar nga detyra për shkak të daljes në pension invaliditeti me vendim të KMCAP Elbasan. Në vend të tij, është punësuar sekretare **Pamela Hoxha**.

Në referim të shkresave nr.198/6 prot., dt.29.01.2020 dhe nr.876 prot., dt.12.06.2020 të Prokurorisë së Përgjithshme, struktura organike e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Elbasan, është si vijon :

7.

PROKURORËT		
Nr.	Emër, mbiemër	Funksioni
1	Kreshnik Ajazi	Drejtues i Prokurorisë
2	Gentian Habazaj	Zv.Drejtues i Prokurorisë
3	Ritvan Suka	Drejtues Seksioni
4	Pranvera Stafa	Drejtues Seksioni
5	Artur Ismailukaj	Drejtues Seksioni
6	Elveta Stafa	Prokuror
7	Petref Asllani	Prokuror
8	Rajmonda Berisha	Prokuror

9	Mustafa Turku	Prokuror
10	Zena Lila	Prokuror
11	Hektor Mushi	Prokuror
12	Arbër Berexha	Prokuror
13	Edlira Bako	Prokuror
14	Xhelian Seferi	Prokuror
15	Platin Aliçka	Prokuror
16	Ervin Beqiri	Prokuror
17	<i>Binas Nina</i>	<i>Prokuror (shkarkuar KPK)</i>
18	<i>Neritan Hoxha</i>	<i>Prokuror (çp Prokuroria Pogradec)</i>
19	<i>Bledar Mustafaraj</i>	<i>Prokuror (komanduar MD)</i>
20	<i>vakant</i>	<i>Prokuror</i>
21	<i>vakant</i>	<i>Prokuror</i>
22	<i>vakant</i>	<i>Prokuror</i>
23	<i>vakant</i>	<i>Prokuror</i>
24	<i>vakant</i>	<i>Prokuror</i>
25	<i>vakant</i>	<i>Prokuror</i>

SEKSIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr.	Emër, mbiemër	Funksioni
1	Xhaferr Muha	Oficer i policisë gjyqësore
2	Petrit Caku	Oficer i policisë gjyqësore
3	Altin Xhetani	Oficer i policisë gjyqësore
4	Armanda Shahini	Oficer i policisë gjyqësore
5	Laureta Fusha	Oficer i policisë gjyqësore
6	Rasim Guzi	Oficer i policisë gjyqësore
7	Lorena Musai	Oficer i policisë gjyqësore
8	Erjon Karoli	Oficer i policisë gjyqësore
9	Juliana Beqiraj	Oficer i policisë gjyqësore
10	Nevruz Ndrejçoni	Oficer i policisë gjyqësore
11	Fjoralba Memia	Oficer i policisë gjyqësore
12	Ermal Çela	Oficer i policisë gjyqësore
13	Anila Dusha	Oficer i policisë gjyqësore

ADMINISTRATA

Nr.	Emër, mbiemër	Funksioni
1	Alketa Kurmaku	Kancelare
2	Lindita Shopi	Kryetar Dege Buxhet/Finance
3	Elida Kasa	Kryesekretare
4	Dionis Durbaku	Specialist IT
5	Armida Halili	Koordinatorë për të miturit
6	Anita Hoxha	Sekretar

7	Etleva Ballkoçi	Sekretar
8	Rozalina Terziu	Sekretar
9	Zhaneta Pashaj	Sekretar
10	Fjoralba Salla	Sekretar
11	Xhoana Koçi	Sekretar
12	Zamira Zykollari	Sekretar
13	Pamela Hoxha	Sekretar
14	Klajva Xheka	Sekretar
15	Agim Bengu	Shofer
16	Xhemil Fejza	Shofer
17	Armand Çanaku	Ftues
18	Rudina Pema	Sanitare
19	Nosi Prendi	Punonjës shërbimi
20	Antoneta Shabani	Sanitare (<i>me kohë të pjesshme</i>)

Pra në përfundim të vitit 2021 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ushtrojnë faktikisht detyrën 16 prokurorë nga 25 që parashikon struktura organike. Përgjatë vitit 2021, për arsye të ndryshme dhe të sipërcituara, janë larguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan 7 prokurorë dhe konkretisht B.Mustafaraj, N.Hoxha, A.Shehu, E.Tafani, A.Xhaferri, B.Nina dhe E.Kokonozi dhe janë afruar 3 prokurorë A.Ismailukaj, G.Habazaj dhe E.Beqiri.

Përsa i takon seksionit të policisë gjyqësore rezulton se numri i oficerëve të policisë gjyqësore ka qënë i plotësuar me 13 oficerë, aq sa parashikon dhe struktura organike.

Po ashtu, edhe stafi administrativ ka qënë i plotësuar sipas parashikimeve në strukturën organike.

Në zbatim të Urdhërit Nr.25/219 të Prokurorit të Përgjithshëm, për çdo prokuror të larguar nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë urdhër për procedurën e dorëzimit të dokumentacionit, bazës materiale, si dhe urdhëra për trajtim materiale për të proceduar me short dhe vendime zëvendësim prokurori.

➤ Procedura e emërimit të Zëvendës Drejtuesit

Në emërimin e Zëvendës Drejtuesit të Prokurorisë është respektuar dhe ndjekur procedura në bazë të Urdhërit nr.101, dt.12.06.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm, duke bërë shpalljen e vendeve vakante, konkurrimi midis drejtuesve të seksioneve dhe thirrja e mbledhjes së prokurorëve.

Me Urdhërin Nr.12, datë 22.02.2021 “ Për emërimin e Zëvendës Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” është emëruar në këtë funksion **Z.Alfred Shehu**.

Për shkak të transferimit të Z. Alfred Shehu në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë me Urdhërin Nr.104, datë 11.10.2021 “ Për emërimin e Zëvendës Drejtuesit në

Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” është emëruar në këtë funksion **Z.Gentian Habazaj**, i cili u votua me shumicën e votave në mbledhjen e prokurorëve.

VIII. Informacion për marrëdhëniet me publikun dhe mediat

Ligji nr.97/2016 ‘Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në RSH’, parashikon krijimin e një pozicioni të veçantë në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, i cili do të ketë si rol kryesor marrëdhëniet me median dhe publikun.

Neni 61 i ligjit parashikon që *“Shërbimet për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtarinë e prokurorisë, si dhe për çështje të veçanta, duke zbatuar kërkesat ligjore për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjes së hetimit. Shërbimet e marrëdhënies me publikun kryhen nën drejtimin e prokurorit të caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe mbikëqyren prej tij. Shërbimet e marrëdhënies me publikun kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, duke kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë.”*

Në zbatim të këtij detyrimi ligjor drejtuesi i prokurorisë ka caktuar prokurorin për marrëdhënien me publikun dhe median. Nga data 18.11.2021 me urdhrin nr. 115 është caktuar prokurore si prokurore e marrëdhënies me publikun dhe median prokurore Edlira Bako.

Po ashtu është i caktuar edhe Kordinatori për të drejtën e informimit znj.Alketa Kurmaku.

Gjatë vitit 2021 rezultojnë të jenë regjistruar gjithsej 14 kërkesa në kuadër të së drejtës së informimit nga përfaqësues të medias dhe subjekte të tjera. Konkretisht :

12 kërkesa nga gazetarë ,

1 kerkese nga vezhgues i komisionit zgjedhor

1 kërkesë nga përfaqësues shoqate

Për të gjitha kërkesat është dhënë përgjigje dhe informacion sipas parashikimeve dhe afateve ligjore duke u publikuar edhe në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve në rubrikën programi i transparencës në [Ëeb site_in zyrtar të prokurorisë së rrethit Elbasan: https://www.pp.gov.al/Elbasan/Programi_i_Transparences_16594](http://www.pp.gov.al/Elbasan/Programi_i_Transparences_16594).

Ky web site zyrtar i prokurorisë tonë përditësohet në vijimësi me informacione dhe të dhëna duke reflektuar edhe rekomandimet e Komisionerit në kuadër të programit të transparencës .

Nuk rezultojnë asnjë ankesë nga Komisioneri në këtë drejtim për institucionin tonë.

IX. Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021. Rekomandime

Nga analiza në tërësi e elementëve që u përmendën më lart, paraqesim përfundimet dhe rekomandimet që mendojmë se i do i shërbejnë punës së mëtejshme të Administratës, Investimeve, Prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan:

- Rekomandojmë që Prokurori i Përgjithshëm të kryejë plotësimin e administratës me punonjës në pozicionin arshivist, punonjës mirëmbajtje dhe sekretar pranë prokurorëve.
- Rekomandojmë që Komisioni i Policisë Gjyqësore, lëvizjet e oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan t'i realizojë në kuadër të një analize strukturore në plan të gjërë dhe afat mesëm, duke kuadruar nevojat reale të prokurorisë, ngarkesën në punë dhe eficensën e policisë gjyqësore. Transferimet për dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, si në aspektin sasior ashtu edhe nominalisht, duhet të jenë rrjedhojë e një koordinimi mes Komisionit të Policisë Gjyqësore, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Cdo ndryshim mekanik dhe momental, duke evituar analizën strukturore dhe pa ruajtur drejtpeshimin mes nevojës dhe efikasitetit, do të ishte jo efektiv.
- Përfundimi më i rëndësishëm i analizës së mësipërme është konstatimi i faktit të rritjes së ngarkesës efektive të Prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan përgjatë vitit 2021. Për këtë shkak është i nevojshëm që nga KLP të kryhet plotësimi i organikës me prokurorë.
- Referuar statistikës dhe nevojave duhet të ulet në organikë numri i oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe konkretisht të ngritjes së një grupi pune mes Komisionit të Policisë Gjyqësore, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe Prokurorisë së Përgjithshme me qëllim saktësimin e numrit të oficerëve që duhet të punojnë në prokurorinë tonë.

Rekomandojmë që Prokurori i Përgjithshëm :

a.Të sigurojë investimet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan sipas kërkesave, projekteve dhe preventivave të depozituara nga ana jonë dhe konkretisht :

- Është shumë i domosdoshëm investimi në sistemin e kondicionimit të prokurorisë pasi në periodha të caktuara të vitit dhe si rrjedhojë e kushteve atmosferike puna në prokurori është realisht e pamundur.
- Në sistemin e sigurisë fizike të godinës së prokurorisë.
- Rishikim i kuadrit kontraktor për garantimin e ruajtjes së prokurorisë me SHRSF pas orarit zyrtar të punës dhe në ditët e pushimit zyrtar.

b.Marrjen e masave të nevojshme për fillimin e procesit të sistemimit të arkivës së prokurorisë, e cila është e tejmbushur, duke përcaktuar rregulla të qarta mbi mënyrën e administrimit të dokumentacionit arkivor në përputhje me aktet ligjore dhe rregullat teknike dhe shkencore për mbajtjen e këtij dokumentacioni apo edhe për transferimin ose asgjësimin e tij.

c.Është e nevojshme të azhurnohen aktet nënligjore më natyrë të brendshme me qëllim njehsimin e praktikave më të mira në prokurori përsa i takon shpërndarjes së çështjeve dhe aplikimit të shortit, më fokus përditësimin e Udhëzimit të Përgjithshëm nr.3, viti 2016 “Mbi shpërndarjen e çështjeve në prokurori”.

d.Është e nevojshme të qartësohen me udhëzim të posaçëm kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtuesit të prokurorisë dhe kancelarit në drejtimin dhe administrimin financiar të prokurorisë, duke marrë në konsideratë parashikimet e ligjeve nr.97/2016, nr.9936/2008 dhe nr.10296/2010 dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

e.Në përputhje me detyrimet e përcaktuara në ligjet nr.97/2016, 115/2016, 152/2013 dhe VKM nr.187/2017 dhe nr.919/2020, duhet të përpilohen aktet nënligjore për përcaktimin e punonjësve administrativ të prokurorisë që përfshihen brenda kuadrit të shërbimit civil, në mënyrë që të normohen procedurat e rekrutimit, transferimit, lëvizjes paralele, masave disiplinore, largimit nga detyra etj të këtyre punonjësve.

Nga ana tjetër kjo do të ndihmonte në realizimin e objektivave të mëposhtme

- Përfundimi në një afat sa më të shkurtër i procedimeve penale të mbartura nga viti 2021 dhe vitet e kaluara.
- Vazhdimi i ndjekjes me përparësi të procedimeve penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, abuzimit me detyrën nga nëpunësit shtetërorë, në fushën e veprave penale kundër jetës së personit dhe moralit, pasurisë, rendit dhe sigurisë etj.
- Intensifikimi i përpjekjeve nga prokurorët për të bërë të mundur rritjen e treguesve të zbulueshmërisë së veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe marrjen në përgjegjësi penale të subjekteve përkatëse, si pastrimin e produkteve të veprës penale, vjedhjet etj, të cilat janë më të ndjeshme për shoqërinë tonë.
- Rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit ndaj policisë gjyqësore, në seksionin dhe shërbimet e policisë gjyqësore.
- Përmirësimi i organizimit, drejtimit dhe kontrollit të punës brenda organit, me qëllim për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave për rritjen e cilësisë së punës.
- Respektimi nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore i detyrimeve të ligjit procedural penal, urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm dhe atyre të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- Rritjen e ndërgjegjësimin të prokurorëve për zbatimin e detyrimeve që ata kanë sipas Udhëzimit të Përgjithshëm Nr.12 datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi

rregullimin e marrëdhënieve me prokurorëve dhe Drejtuesve të Prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar”.

- Konsolidimin në një nivel të qëndrueshëm bashkëpunimi mes policisë dhe prokurorisë jo vetëm si mjet efikas në parandalimin e ngjarjeve kriminale, por është edhe mesazh për forcimin e besimit të publikut.
- Hetimi me intesitet i ngjarjeve të rënda kriminale dhe rezultatet konkrete për autorët e tyre, shpërndarja dhe trafikimi i narkotikëve si dhe format e krimit ekonomik që sjellin pasoja në financat publike dhe ato të qytetarëve duhet të jenë në vëmendjen tonë, sigurisht pa lënë pas dore ndjekjen efektive penale për të gjitha krimet e tjera.
- Mbështetja e punës sonë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan është një tregues efektiv i rezultateve të punës dhe suksesit të prokurorisë, mbështetje e cila vjen rrjedhojë e ushtrimit me profesionalizëm të detyrave nga ana e prokurorëve por edhe ndërtimit të marrëdhënieve korrekte mbi bazë ligjshmërie me gjyqtarët.
- Britja e profesionalizimit të prokurorëve në hetimin paraprak, në marrjen e vendimeve përfundimtare, në paraqitjen e kërkesave para gjyqtarit të seancës paraprake dhe në mbrojtjen e akuzës në gjykim si dhe ruajtjen e etikës dhe disiplinës në punë.

DREJTUESI I PROKURORISË

Kreshnik AJAZI

